

# GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI  
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA  
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7572 E enjte 28 Qershor 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion **i** Ditës

**H**eqja e gjyqtarëve apo prokurorëve me kurikul "korrupsioni" nuk është revolucion dhe as mund të quhet i tillë, sa kohë sistemi gëlon nga ligje apo ...  
Vijon në faqen 20

Nga SOKOL HAZIZA

**Sistemi apo vetingu**



Opinion **i** Ditës

**N**gritja e Murit të Berlinit zhgënjoi dhe tronditi thellë jo vetëm berlinezët në të dyja anët e tij, por edhe gjithë Perëndimin; u duk sikur do të shuante ...  
Vijon në faqen 21

Nga JORGJI KOTE

**700 fjalë që tronditën muret**



Të arrestuarit "kyçin" gojën në prokurori

## Hetim në 4 shtete për 3.4 milionë euro. Dyshimi, ka të implikuar të tjerë

Alfred dhe Elvis Vladi, në kërkim ndërkombëtar. Taulant Balla, kallëzim penal për Lulzim Bashën

INA ALLKANJARI

Në kuadër të zhvillimit të hetimeve për kapjen dhe sekuestrimin e 3.4 milionë euro në portin e Durrësit mesditën e së dielës, 4 të arrestuarit e kësaj çështjeje kanë dalë ditën e djeshme para prokurorëve. Konkretisht Agim Çeka ...  
Në faqen 8

## RAMA RREFEN TELEFONATAT ME MERKEL E MACRON: S'KA KUSHTE TE REJA

# NEGOCIATAT, SHBA-BE: PERMBUSHNI REFORMAT

Kryeministri: Opozita, mallkim që na ka ndjekur pas. Lulzim Basha: BE refuzoi Ramën, do ta rrëzojmë. Meta, thirrje partive: Bashkëpunoni me përgjegjësi



(Në foto) Kryeministri Edi Rama dje gjatë një konference

Në faqet 2-5

"AUDITIM NGA KLSH"

**Universitetet publike, blerje luks, zero investim për studim shkencor**  
Në faqen 11

DOSJA E PLOTE

**Trafik heroine, prokuroria: 131 vite burg për 9 të akuzuarit**  
Në faqen 9

KESHILLAT E MJEKUT

**Ylli Merja: Si ta luftoni debulesën dhe këputjen me bimë mjekësore**  
Në faqen 10

KATEGORIE

**Profesionet e lira, Tatimet: Ja afatet për dorëzimin e listëpagesave**  
Në faqen 7

INTERVISTA



**Turistët elitare, gjithmonë e më shumë në "Prestige Resort": Është nga më të mirët**  
Në faqet 14-15

Përçahen aktorët, Liçaj: S'jemi lodra. Trebicka: Pakti s'bëhet me fotografi

## Letra e 65 artistëve: Duam teatër të ri

Veliaj takon përfaqësuesit e protestuesve: Gjetëm një marrëveshje

Nga FATMIRA NIKOLLI

**K**ur ka vullnet, ka Krrugëzgjidhje! Mirënjohje nga zemra aktorëve, regjisorëve, arkitektëve, inxhinierëve e sidomos sindikatave e protestuesve! Falë kontributit të secilit kemi një marrëveshje më të mirë



dhe jemi sot gati të nisim negociatat për një Teatër të ri Kombëtar! Ka qenë ky postimi që ka bërë dje në "Twitter" kreu i Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj pas një takimi me Arben Derhem, Alfred Trebickën, Altin Bashën, përfaqësues të grupit ...  
Në faqet 18-19

# NEGOCIATAT REAGIMET

Kreu i PD, ambasadorëve: Keni dhënë dëshmi të rreme, jeni njësh me propagandën e Ramës

Valentina Madani

## Shtyrja e negociatave, Basha: Refuzim ndaj Ramës, do ta rrëzojmë

"Klika e tij e inkriminuar sundon mbi shqiptarët"

Kreu i opozitës, Lulzim Basha e konsideroi dje një lajm të hidhur për shqiptarët moshapjen e negociatave, duke bërë përgjegjës direkt kryeministrin Edi Rama për refuzimin, por me garancinë se shqiptarët do ta rrëzojnë atë për t'i hapur rrugën anëtarësimit në BE. Vendimi i Luksemburgut, për Bashën, mbylli sërish dyert e Unionit për Shqipërinë, duke mos i hapur negociatat. Ndaj, Lulzim Basha zgjodhi dje një konferencë për shtyp për të thënë se s'ka as datë për çeljen e tyre. "Shqipërisë nuk i janë hapur negociatat me BE-në. Nuk ka as vendim as datë për hapjen e negociatave. Këshilli Europian nuk do ta shqyrtojë fare nesër (sot) çështjen e hapjes së negociatave dhe e ka shtyrë këtë vendimmarrje të paktën për një vit, për në qershor 2019", theksoi z.Basha. Mesazhin e BE-së e lexon jo vetëm ndryshe nga kryeministri Rama, por edhe nga ambasadorët e huaj. "Unë nuk komentoj deklaratat e diplomatëve, por dështimi i sotëm është edhe i atyre, që u bënë njësh me Edi Ramën dhe s'e panë krimin e drogën. Kjo është fatura e gënjeshtrove dhe mashtrimeve të atyre që i bënë", tha kreu i opozitës. Moshapjen e negociatave e sheh si refuzim të qeverisë dhe lidhjeve që thotë se ajo ka me krimin e korrupsionin. "Është refuzim personal ndaj Edi Ramës dhe klikës së inkriminuar që sundojnë mbi shqiptarët. Është refuzim i Saimir Tahirit, Fatmir Xhafajt, Taulant Ballës, Damian Gjinkurit, Arben Ahmetajt, Vangjush Dakos, Qazim Sejdit, Elvis Rroshit dhe kopolës politikë të PS, pothuajse e gjitha e lidhur me krimin dhe me drogën", theksoi z.Basha. Sipas tij, nuk ka gjasë që negociatat të hapen as në qershorin e vitit 2019. "Sjellja e Ramës edhe pas refuzimit për hapjen e negociatave duke mashtruar pa turp shqiptarët tregon qartë se Edi Rama nuk ka për të përbushur asnjë nga kushtet për t'i hapur negociatat as në vitin 2019. Zgjedhja e tij nuk është Europa, por krimi, korrupsioni dhe droga", theksoi z.Lulzim Basha. Në kushtet e një vendimmarrje refuzuese nga BE thotë se vendit i duhet një kthesë, ndonëse tregohet hermetik për aksionin opozitar: "Në javët e muajt e ardhshëm ne do të na duhet të reflektojmë thellë për



Kreu i opozitës, Lulzim Basha

### GARANCIA

"Pas reve ka dritë, ne e dimë se ka vetëm një rrugë për të marrë vendin në zemër të Evropës, të përballimi me të vërtetën, është qeveria e Ramës ajo që na mban larg Evropës. Në emër të PD-së i siguroj shqiptarët se opozita do të bëjë gjithçka për të çliruar nga kjo e keqe e madhe që të realizojmë bashkë anëtarësimin e vendit në BE", tha z.Basha.

### DEKLARATAT



#### DISKUTIMI

"Shqipërisë nuk i janë hapur negociatat me BE. Nuk ka as vendim, as datë për hapjen e tyre. KE nuk do ta shqyrtojë sot çështjen e hapjes së negociatave".



#### DIPLOMATËT

"Dështimi është edhe i atyre që dhanë dëshmi të rreme, u bënë njësh me propagandën e Ramës, nuk panë drogën, nuk panë krimin, nuk panë korrupsionin. Në Europë nuk hyhet me mashtrime".



#### AKSIONI

"Në muajt e ardhshëm ne do të na duhet të reflektojmë thellë për të ndryshuar thellësisht politikën dhe qeverisjen, për t'i rikthyer në mënyrë të sigurt perspektivës europiane".

### "Të çlirojmë vendin sa më shpejt nga narkoshteti"

## Vendimi i Luksemburgut, Berisha: Ndëshkim fatal për piktorin dështak

Ish-kryeministri Sali Berisha e konsideroi dje vendimin e Luksemburgut, ku ministrat e Jashtëm të vendeve të BE shtynë me një vit hapjen e negociatave të Shqipërisë si ndëshkim fatal për kryeministrin. Sipas tij, "ky vendim i Këshilli të Ministrave për moshapjen e negociatave as tani, as në vjeshtë apo dhjetor të këtij viti, por vetëm pas një viti e gjysmë, pra në fund të vitit 2019, dhe vetëm në rast se janë plotësuar 13 kushtet, është vërtet ndëshkimi më i rëndë për klikën e Edvin Krista Ramës në pushtet. Ata që besuan se Edi Rama do të plotësonte 6 kushtet dhe se tani pas dështimit



Ish-kryeministri Sali Berisha

të plotësojë ai do mund të plotësojë 13 kushtet, kanë humbur çdo lidhje me realitetin, vlerat dhe standardet e BE dhe janë shndërruar në skllëvër të interesave të tyre më të ngushta dhe kockave

që u hedh për të lëpirë piktorin dështak", deklaroi z.Berisha. Por sipas tij, ky vendim është thirrja më e fuqishme për çdo shqiptar për të çliruar vendin sa më shpejt nga

të ndryshuar thellësisht politikën dhe qeverisjen, për t'i rikthyer në mënyrë të sigurt perspektivës europiane", u shpreh kreu i PD-së. Sipas Bashës, e vetmja rrugë drejt Europës është përballja me të vërtetën. Kreu i PD-së nuk preferoi të komentonte deklaratat e Ambasadës së SHBA-ve dhe ambasadores së BE-së, Vlahutin, lidhur me shtyrjen e negociatave për në qershor të 2019-ës. Por,

Basha nënvizoi se në atë që e cilësoi një dëshitim, janë përgjegjës edhe dëshmitarët e rremë që nuk panë drogën, krimin dhe korrupsionin në vendin tonë. Sipas tij, ata kanë bërë dëshmi të rreme në raportimet e tyre në institucionet e BE-së. "Nuk komentoj fare deklaratat e diplomatëve në Tiranë. Nuk i komentoj fare. Dështimi i sotëm është dëshitim edhe i atyre që dhanë dëshmi të

rreme, u bënë njësh me propagandën e Edi Ramës, nuk panë drogën, nuk panë krimin, nuk panë korrupsionin. Por siç e kemi thënë, në Europë nuk hyhet me mashtrime, nuk hyhet me gënjeshtër, nuk hyhet me fasada dhe ky është realiteti me të cilin përballimi sot. Kjo është fatura e gënjeshtrove, e mashtrimeve, pavarësisht se nga vinë dhe kush i bën", deklaroi z.Basha.



Parlamenti Evropian

### PALOKA: RAMA I SËMURË, DUHET MBYLLUR NË SPITAL PSIKIATRIK

Nënkryetari i PD-së, deputeti Edi Paloka e cilëson kryeministrin Edi Rama të sëmurë, duke i hequr përgjegjësitë për të "vërtetat e vendit". "Ndoshta kryeministri ynë është thjesht i sëmurë? Ndoshta nuk duhet dërguar atje ku shumica e shqiptarëve urojnë çdo ditë. Mbase thjesht duhet mbyllur në spital psikiatrik? Mbase... Prisi kur të dalë ndonjë nga këto ditë e të thotë që Italia do fitojë kampionatin botëror. Në fakt, Italia i ka shanset se do ketë kampionate të tjera, kurse kryeministri ynë nuk ka asnjë shans. Nuk bëhet më...", tha z.Paloka.

### SHTYRJA E NEGOCIATAVE, MEDIU: PËRGJEGJËSI ËSHTË VETËM RAMA

Kreu i PR-së reagoi dje në lidhje me shtyrjen e hapjes së negociatave të Shqipërisë me Bashkimin Evropian. Mediu shkruan në 'FB' se është një lajm i keq për shqiptarët dhe kjo ka ardhur si pasojë e krimin dhe korrupsionit. "Moshapja e negociatave është një lajm shumë i keq për shqiptarët. Kushtet e vendosura për Shqipërinë, sidomos korrupsioni dhe krimi i organizuar tregojnë qartësisht jo vetëm refuzimin, por edhe sa larg është qeveria 'Rama', ai vetë nga Europa. Shitja e disfatës si sukses është sa e pamoralshme, aq edhe sfiduese karshi shqiptarëve dhe BE-së. Ka vetëm një përgjegjës, Rama dhe qeverisja jo vetëm antishqiptare, por edhe antikombëtare", shprehet z.Mediu.





**LIBRAT**

"Askush s'do e besonte, nëse do vazhdoja të bëja dhe 2 vëllime të librit 'Kurban'. Me dy tituj: 'Europë mu bëfsh kurban' dhe 'Europë t'u bëfsha kurban', tha dje Rama, duke kritikuar qëndrimet që ka mbajtur këto ditë opozita e vendit për hapjen e negociatave.



**Shoqata 'Çamëria' kërkesë qeverisë: Status "Varrezë Monumentale" për Kllogjerin**

Në ditën e gjenocidit grek ndaj shqiptarëve të Çamërisë, shoqata "Çamëria" i ka bërë kërkesë Këshillit të Ministrave që t'i japë statusin "Varrezë Monumentale e Shqiptarëve të Çamërisë", varrezave të Kllogjerit në Konispol. Në këtë vend ndodhen eshtrat e më shumë se 2900 shqiptarëve të Çamërisë, të cilët 74 vite më parë u larguan me dhunë nga trojet e tyre në Çamëri. Në kërkesën drejtuar qeverisë shoqata "Çamëria" shpreh se është shoqata e parë pluraliste e themeluar në janar të vitit 1991, si përfaqësuesja e vetme legjitime e të gjithë shqiptarëve të Çamërisë, pavarësisht bindjeve politike të tyre. Ajo është krijuar për mbajtjen gjallë të çështjes came, forcimin e ndjenjës së përkatësisë e bashkësisë mes vetë shqiptarëve të Çamërisë dhe kombit shqiptar pas dëbimit në gjenocidin e ushtruar nga forcat parashtetërore dhe shtetërore greke. Shoqata "Çamëria" me ndihmën e qeverisë shqiptare ka ndërtuar Varrezat Monumentale të Shqiptarëve të Çamërisë në fshatin Kllogjer të Sarandës, për të përkujtuar mbi tre mijë shqiptarë të Çamërisë që humbën jetën nga gjenocidi i shovinizmit grek, me datë kulmore përkujtimore datën 27 qershor. Kjo datë është shpallur ditë përkujtimore nga Kuvendi i Shqipërisë, me anë të ligjit nr. 7893, datë 30.6.1994 "Për shpalljen e 27 qershorit në kalendarin kombëtar &quot;Dita e gjenocidit ndaj shqiptarëve të Çamërisë nga shovinizmi grek" dhe ngritjen e një memoriali në Konispol". Bazuar në këto fakte, kjo shoqatë i bën qeverisë këtë kërkesë.

Negociatat më 2019-ën, kryeministri flet para ministrave e deputetëve: Më pranë BE-së

**Rama: Nuk ka kushte të reja, por një datë për çeljen e negociatave**

*"Opozita, një mallkim që na ka ndjekur mbrapa"*

Darina Tanushi

Kryeministri Edi Rama deklaroi dje gjatë një takimi me ministrat dhe deputetët e grupit parlamentar të PS-së, se Shqipëria është një hap më pranë Bashkimit Europian dhe se tashmë është hapur drita jeshile për datën se kur do të çelen negociatat. Gjatë takimit të zgjeruar në Qendrën e Hapjes për Dialog (COD), në Kryeministri, një ditë pas vendimit të ministrave të Jashtëm të vendeve të BE-së, në Luksemburg kryeministri Rama u shpreh: "E dhimbshme, por fatkeqësisht e vërtetë që tek- sa ne merrnim telefonatat e urimeve nga miqtë europianë dhe nga mediet serioze europiane lajmëronin vendimin e Këshillit Europian për hapjen e rrugës së negociatave me Shqipërinë e Maqedonisë, opozita jonë esadiste me mediet e rreshtuara pranë saj hidhnin gurët e vulgaritetit të tyre proverbial, për t'u prishur shqiptarëve fundit dhe të shumëpritur pas përpjekjes së shumëllojshme e shumëfish të gjithë kësaj kohe". Rama tha se është falenderues ndaj Merkel dhe Macron për mbështetjen ndaj Shqipërisë. "Jam ndjerë shumë mirë se Shqipëria ka gjetur dhe ka bërë disa miq shumë të mirë dhe të vërtetë të cilët nuk u mjaftuan vetëm me fjalë të mira por luftuan me këmbëngulje për të mos e lënë anijen tonë pa një datë ancorimi. Që nga Merkel e cila ma bëri të qartë që në takimin në Berlin se do të jenë muaj të vështirë, po ajo do të ishte në krah. Macron ma tha troç se për të ishte tejet e vështirë të thoshte po për një datë, por më premtoi se në respekt të reformave të qeverisë sonë, do të mendohej për një zgjidhje", u shpreh Rama. "U shly data, u shly data sepse Europa refuzoi narkoqeverinë. Çfarë vulgariteti, çfarë ligësie ndaj vendit të përbashkët, çfarë pabesie ndaj atyre shqiptarëve që e duan Europën njësoj si gjithë të tjerët dhe u kanë besuar këtyre nipërve të Esat Pashë Toptanit votën dhe përfaqësimin e tyre në Kuvendin e Shqipërisë. Po si mund të shtyhet një datë kur nuk është vënë? Si mund të pranojë Këshilli i shteteve anëtare të vendosë një datë për çeljen e negociatave brenda 12 muajsh me një vend të zhytur në krim, drogë, korrupsion dhe të ndezë dritën jeshile për të nisur përgatitjet e procesit të negociatave me një narkoqeveri? Si mund të flitet kështu kaq ligësisht dhe poshtërsisht për vendin tënd dhe si mund të keqtrajtohen brutalisht vetë zgjedhësit e tu sikur të ishin një kope qorrash", - tha Rama, duke iu drejtuar opozitës. "Si mund të shtyhet



Kryeministri Edi Rama

**DAMIAN GJIKNURI**

"Ky është një proces që nuk varej nga Shqipëria, por që varet nga Evropa. Në kompleksitet, Evropa është një organizëm që ka debate brenda saj, ka shtete që për shkaqe të brendshme janë kundër zgjerimit. Prandaj ajo që u arrit dje është një sukses, pasi politikat e brendshme të disa shteteve mund ta vinin në pikëpyetje të gjithë integrimin e Shqipërisë", tha ministri i Energjetikës.

**VIZITA E MACRON**

"Ma tha troç qysh në takimin e parë në Paris se për të ishte tejet e vështirë një datë, për arsye të qarta, të mirëkuptueshme që nuk lidhen me Shqipërinë. Por më premtoi ama se në respekt të reformave mbresëlënëse të qeverisë sonë, do të mendohej mbi mundësinë e një zgjidhjeje pozitive. Dhe kam kënaqësinë të shtoj këtu, nëse diçka e paparashikueshme nuk do të ndodhë këtë vjeshtë Shqipërinë do ta vizitojë për herë të parë një President i Francës", u shpreh Rama.

**Kreu i qeverisë: Shqipëria nuk do të pranojë kurrë kampe refugjatësh**

Në intervistën e dhënë për "Bild", Rama thekson se Shqipëria do të jetë gjithmonë e gatshme të japë kontributin e duhur për të lehtësuar barrën europiane, por jo të mbajë barrën e të gjithëve. "Planet e BE-së për ndërtimin e kampeve të refugjatëve në vende të treta morën një përgjigje të vendosur nga Shqipëria që, ashtu si Libia, kundërshton ndërtimin e kampeve të tilla për llogari të BE-së. Ne nuk do të pranojmë kurrë kampe të tilla refugjatësh. Kjo sepse nënkupton faktin se njerëz të dëshpëruar po hidhen diku si të ish- in mbetje toksike, që askush nuk i do", u shpreh Rama.

me një vend të zhytur në krim, drogë, korrupsion dhe të ndezë dritën jeshile për të nisur përgatitjet e procesit të negociatave me një narkoqeveri? Si mund të flitet kështu kaq ligësisht dhe poshtërsisht për vendin tënd dhe si mund të keqtrajtohen brutalisht vetë zgjedhësit e tu sikur të ishin një kope qorrash", - tha Rama, duke iu drejtuar opozitës. "Si mund të shtyhet

një datë që nuk është vënë? Si mund të pranojë Këshilli i shteteve anëtare të BE-së të vendosë një datë për çeljen e negociatave brenda 12 muajsh me një vend të zhytur në krim, në drogë në korrupsion dhe të ndezë dritën jeshile për të nisur përgatitjet e procesit të negociatave me një narkoqeveri? Si mund të flitet kështu kaq ligësisht dhe poshtërsisht për vendin tënd? Si

mund të keqtrajtohen brutalisht zgjedhësit e tu, si të ishin një kope qorrash, që duhen hedhur në luftë për hesapin e ngushtë të një grushti njerëzish pa fë pa atdhe, pa din pa iman?", theksoi kryeministri. "E vërteta është se nuk ka kushte të reja për të marrë datën e negociatave, por ka një datë për çeljen e negociatave si një afat drejt të cilit si Shqipëria edhe Maqedonia janë të kushtëzuara me vijimin e reformave tani të ndërmarra dhe me thellimin e zbatimit që tani ka nisur. Asgjë më normale sesa kjo nuk mund të kishte dhe nuk mund të ketë në një proces si ky i anëtarësimit europian ku gjithçka, jo sot, jo deri në datën e hapjes së negociatave, por deri në datën e hapjes së fundit përpara firmës së anëtarësimit është e lidhur me përmbytje kushtesh për të qenë një shtet i denjë anëtar i BE", sqaroi ai. "Na është dashur të kryejmë një numër rekord komunikimesh me nivele të larta në shtetë anëtare. Kemi parë e dëgjuar edhe gjëra që askush nuk do t'i besonte dhe më besoni, nëse do shkruaja vazhdimin e "Kurbanit", me këtë temë mund të dilnin dy vOLUME me titujt: "Europë mu bëfsh Kurban" dhe "Europë t'u bëfsha Kurban". Por, asnjë kulminacion befalusë në këto vOLUME nuk do ta kapërcente kulmin e kulmeve të kësaj historie, qoftë për ne qoftë për miqtë tanë europianë që na pësnin: Si ka mundësi që opozita juaj ta dojë me kaq pasion bllokimin e Shqipërisë dhe mos çeljen e negociatave?!", ngriti pyetjen Rama. "Ja që për dreqin e Shqipërisë dhe shqiptarëve jo vetëm ka mundësi, por kjo është mundësi e vetme që kjo opozitë ka në frymë Esat Pashën, në gërmë ka Sali Efendiun dhe në fytyrë ka Babale Velium. Tamam si një mallkim që na ka ndjekur nga prapa, rrugë më rrugë, korridor më korridor, derë më derë, biseda në bisedë, nga telefonata në telefonatë, por që në fund të fundit ka ndihmuar të kuptohen edhe më mirë hallet tona të brendshme, të vlerësohen arritjet tona dhe të merret vesh edhe më qartë nevojja e Shqipërisë për ta mbështetur vazhdimin e reformave me një kalendar të qartë veprimi dhe me një datë në kalendar qeveror të tonë reformiste, e cila Evropën nuk e ka çarçaf në gojë për flamur në veprim", u shpreh Rama.

## NEGOCIATAT ME BE REAGIMET

Presidenti reagon pas konkluzioneve të Këshillit për Çështjet e Përgjithshme

# Meta, thirrje partive: Duhet përgjegjësi dhe bashkëpunim

"Provimi i qershorit të ardhshëm do të jetë shumë i vështirë"

Darina Tanushi

Presidenti i Republikës, Ilir Meta deklaroi dje se "konkluzionet e djeshme të Këshillit për Çështjet e Përgjithshme mbi negociatat e anëtarësimit të Shqipërisë me Bashkimin Evropian duhen mirëpritur me realizëm dhe përgjegjshmëri". Në një reagim të tij, Presidenti Meta u shpreh: "Ne të gjithë duhet ta vlerësojmë dhe çojmë vullnetin pozitiv me të cilin si Komisioni Evropian, ashtu edhe të gjitha vendet anëtare, e mirëpresin procesin e integritimit të Shqipërisë dhe të gjithë rajonit në BE". Sipas tij, "kjo qasje duhet të na nxisë për një lexim të drejtë dhe realist të sfidave serioze që kemi përpara, veçanërisht në fushën e sundimit të ligjit. Një vit kalon shpejt, ashtu si nga dje kaloi një ditë. Provimi ynë i qershorit të ardhshëm do të jetë shumë i vështirë e kërkuet, pasi edhe vetë Bashkimi Evropian do të ketë provimin e tij zgjedhor në të njëjtën kohë. Ndaj, i ftaj të gjithë për përqendrim, përgjegjësi dhe bashkëpunim", deklaroi Presidenti Meta. Një ditë më parë, Këshilli i Çështjeve të Përgjithshme të BE-së doli në përfundim që "t'i përgjigjet pozitivisht progresit të bërë nga Shqipëria dhe përcakton rrugën drejt hapjes së negociatave të anëtarësimit në qershor 2019". Në deklaratën e përkthyer nga vetë misioni i BE-së në Tiranë thuhet: "Këshilli nënvizon nevojën kritike që Shqipëria ta konsolidojë më tej progresin e bërë në reformën gjyqësore, në veçanti përmes vetingut, si dhe të japë rezultate të mëtejshme të prekshme në luftën kundër korrupsionit në të gjitha nivelet, si dhe në luftën kundër krimit të organizuar, në veçanti për kultivimin dhe trafikimin e drogave, duke ruajtur dhe thelluar vullnetin aktual të reformës". Në deklaratën përfundimtare të mbledhjes së Këshillit të Çështjeve të Përgjithshme thuhet se ai "mirëpret progresin e qëndrueshëm të Shqipërisë në ndjekjen e refor-



Presidenti i Republikës, Ilir Meta

### RAPORTI

Një ditë më parë, Këshilli i Çështjeve të Përgjithshme të BE-së doli në përfundim që "t'i përgjigjet pozitivisht progresit të bërë nga Shqipëria dhe përcakton rrugën drejt hapjes së negociatave të anëtarësimit në qershor 2019". Këshilli kërkon avancimin e mëtejshëm të procesit të rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Ministri i Jashtëm sqaron se vendet e BE ndoqën precedentin e Malit të Zi e Serbisë

## Bushati: Në vjeshtë nis puna përgatitore, s'ka kushte shtesë

Ministri për Evropën e Punët e Jashtëm, Ditmir Bushati, u shpreh dje se ajo që vendet e BE-së vendosën për Shqipërinë e Maqedoninë i ngjan precedentit që vendosën me Malin e Zi dhe Serbinë, ku nisja e bisedimeve për anëtarësim nuk filloi menjëherë, por u përcaktua një afat kohor. Ministri i Jashtëm pohoi se Shqipërisë nuk i janë vendosur kushte shtesë për të plotësuar deri vitin e ardhshëm. "Nuk ka asnjë kusht shtesë. Edhe rekomandimi që ka bërë Komisioni Evropian në prill në themel ka rekomandimin pozitiv për nisjen e bisedimeve dhe vijimin e kursit të reformave dhe thellësinë e tyre. E njëjta gjë është reflektuar edhe në konkluzionet e ministrave", tha Bushati. I pyetur se a është automatike hapja e negociatave në qershorin 2019 apo Shqipërisë do t'i duhet të



kalojë përmes një vlerësimi tjetër, Bushati sqaroi për "TCH": "Në vjeshtë nis 'screening', puna përgatitore. Besoj se në vjeshtë duhet t'i kemi më të qarta edhe hapat që duhet të ndërmerim së bashku me Komisionin Evropian dhe vendet anëtare në këtë proces. E sigurt është që kursi i reformave duhet të thellohet, të konsolidohet", thotë Bushati. Deri në qershor të 2019-ës, Shqipërisë i është njohur e drejta të nisë paraprakisht së bashku me Brukselin, procesin e analizës së kapitujve për të cilat do të negociojë në të ardhmen, i njohur me termin

"screening". Bushati shpjegon përse kjo është thelbësore. "Screening është esenca e hapjes së negociatave", tha ministri. Në lidhje me opozitën që i kërkon dorëheqjen, ministri i Jashtëm u përgjigj me një buzëqeshje. Sipas Bushatit, afatet e vendosura nga Këshilli i Çështjeve të Brendshme janë më tepër në funksion të dinamikës së brendshme që përjeton BE-ja ose vendet të ndryshme të BE-së. Në një postim në "FB", kryediploti shqiptar shkruan se "vendet anëtare skicojnë rrugën e paktyshme drejt anëtarësimit, kuadrin kohor dhe hapat e instrumentet e ndërveprimit të Shqipërisë me Komisionin Evropian, ndërsa opozita në Tiranë nxin". Bushati thekson se kursesi nuk do të besojë se partia, e cila kërkon të qeverisë vendin është mëzëritur nga vendimi i mirë për shqiptarët e jo për qeverinë.

riut, duke përfshirë të drejtat e personave që u përkasin pakicave dhe të drejtat e pronësisë". Këshilli kërkon avancimin e mëtejshëm të procesit të rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve,

në veçanti duke plotësuar të gjithë dojeve me përparësi, si dhe duke finalizuar ngritjen e strukturave të pavarura gjyqësore, sip parashihet nga reforma kushtetuese; përfundimin e ngritjes së or-

ganëve të specializuara, përkatesisht Struktura Speciale kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK), Byroja Kombëtare e Hetimeve (NBI) dhe gjykata si dhe forcimin e prece-



### SHKURTE

## Luan Rama: Kryeministri të dorëhiqet, qeveria të nisë dialogun me opozitën

LSI i kërkon kryeministrit Edi Rama të japë dorëheqjen për të mos mbajtur peng interesat e Shqipërisë dhe procesin e integritimit. Nënkryetari i LSI-së tha dje në një konferencë për shtyp, se Rama me arrancën e tij po bën përpjekje për të paraqitur vendimin e Këshillit të Europës si fitore dhe ditë feste për Shqipërinë, ndërkohë që është përpjekja e radhës për t'u tallur dhe fyer shqiptarët. "Përpjekje djallëzore për të fshehur të gjithë këtë dështim, pas akuzave të ashtuquajtur esadizem nuk është gjë tjetër vetëm shprehje e arrogancës dhe papërgjegjshmërisë politike për t'ia fatuarur koston e qeverisë së kimit opozitës. T'i japësh opozitës meritën e ndikimit kaq të madh në vendimmarrjen e ministrave të Jashtëm të BE-së do të thotë të fyesh dhe tallësh Këshillin e Europës", u shpreh Rama. "LSI apelon me forcë domosdoshmërinë e institucionalizimit të dialogut politik dhe çeljen e një procesi për plotësimin e reformave të kërkuara, ndërkohë Rama "duhet të japë dorëheqjen e të largohet një herë e më parë dhe të mos mbajë peng interesat e Shqipërisë dhe procesin e integritimit. Shqiptarët janë i vetmi popull që nuk e meriton qeverinë që ka", - u shpreh Luan Rama nga selia e LSI-së.

## Sekretari i Përgjithshëm i KiE: Impresionuese, reforma në drejtësi

Ministrja e Drejtësisë, Etilda Gjonaj ka marrë vlerësime pozitive dhe mbështetje të plotë për zbatimin e reformës në drejtësi dhe forcimin e shtetit të së drejtës gjatë takimeve zyrtare që ka zhvilluar në Strasburg me zyrtarët e lartë të Këshillit të Europës. Ministrja Gjonaj është takuar me sekretarin e përgjithshëm të Këshillit të Europës, z.Thorbjorn Jagland. Impresionuese, e ka konsideruar reformën në drejtësi, Jagland. "I kam ndjekur me vëmendje zhvillimet në Shqipëri dhe mund të them se reforma është impresionuese", ka thënë sekretari i Përgjithshëm i KiE, Çështja e pronave, zbatimi i rekomandimeve të mekanizmeve monitorues të Këshillit të Europës dhe rezultatet e suksesshme të raportit të Greco për Shqipërinë ishin çështjet kryesore që u diskutuan në takim. Pjesë e axhendës së vizitës së ministres Gjonaj ishte edhe takimi me presidenten e sapozgjedhur të Asamblesë Parlamentare, Liliane Maury Pasquier. Presidentja ka përgëzuar ministrin Gjonaj për punën e bërë deri tani me Reformën në Drejtësi. Ajo siguroi se do të raportojë mbi progresin dhe konfirmoi se në shtator do të vizitojnë Shqipërinë reporterët e Asamblesë Parlamentare për të raportuar mbi arritjet konkrete të Shqipërisë.

dentëve të hetimeve proaktive, ndjekjeve penale dhe dënimeve të formës së prerë në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, duke përfshirë edhe në nivele të lartë.





**ROMANA VLAHUTIN**

"Do të dëgjoni më tepër nga ambasadori i ardhshëm, por ky është kalendari. Nuk mund të flas për diçka që do të ndodhë një vit më pas, por ky është një kalendar i qartë dhe në botën e BE-së ka një angazhim për këtë datë. Pra, kalendari është i qartë", tha ambasadorja Vlahutin.



**DONALD LU**

"Shqipëria ka bërë përparim domethënës dhe tani nevojitet të rrisë përpjekjet për të përfunduar reformat kyçe. Ne e nxisim Shqipërinë që të rrisë ritmin në reformën në drejtësi, luftën kundër korrupsionit dhe kundër krimit të organizuar", thuhet në deklaratën e Ambasadës së SHBA-ve.

Ambasadori Lu: Përgëzime Shqipërinë, rrisni ritmin e luftës ndaj krimin e korrupsionit

# Shtyrja e negociatave, SHBA-BE: Shqipëria të përmbyllë reformat

Vlahutin: Shqipëria mori 3 mesazhe pozitive nga BE

Negociatat, Fleckenstein: Ju mbështes deri sa të jemi bashkë në BE

Eurodeputeti dhe njëherazi raportuesi për Shqipërinë në PE, Knut Fleckenstein përshëndeti dje dritën jeshile që dhanë ministrat e Punëve të Jashtme të vendeve anëtare të BE-së për hapjen e negociatave për Shqipërinë dhe Maqedoninë në 2019-ën. "Urime Shqipërisë dhe Maqedonisë! Progres i vlerësuar! Hapja e negociatave u vendos. Përfundimi nga Këshilli i Çështjeve të Përgjithshme inkurajon qartësisht të dyja qeveritë dhe parlamentet për të vazhduar me procesin e reformave. Keni mbështetjen time deri sa të jemi bashkë në BE!", shkruan Fleckenstein në "Twitter".

Negociatat për Shqipërinë, zbardhen prapaskenat e kompromisit

Pas tri ditësh negociata intensive në Luksemburg e Brusel, BE vendosi të çelë negociatat me Shqipërinë dhe Maqedoninë në qershor të vitit të ardhshëm. 25 shtetet e rreshtuara në krah të Shqipërisë e të Maqedonisë nisën të studiojnë opsionin e një deklaratë të përbashkët politike dhe kancelarja Merkel mbledhi grupin e saj parlamentar, të cilin i komunikoi dështimin e negociatave me Francën e me Holandën, duke lënë të kuptohet se në këto kushte, presidenti Tusk nuk mund ta vendostë këtë çështje në axhendën e 28 qershorit, si pikë diskutimi mes liderëve. Në të njëjtën kohë, kryeministri Rama dhe ministri Bushati mësohet se kanë zhvilluar të martën një seri bisedash telefonike me Berlinin, Parisin dhe Hagën dhe kanë qenë në komunikim të pandërprerë me Italinë, Greqinë e disa vende të tjera në krah të Shqipërisë. Mes precedentit të krijuar nga Këshilli Europian me Malin e Zi, ku data është dhënë 6 muaj nga vendimmarrja e këshillit me disa kushte për t'u plotësuar dhe precedentit që do të krijohej nga Franca dhe Holanda në këtë rast, ku këshilli nuk do të vendoste asnjë datë por thjesht do të rreshtonte kushte për t'u plotësuar në vazhdim, deri pasdrekën e të martës u krijua ideja se përfundimi do të ishte nul, as datë, as kushte, po as diskutim në Këshillin Europian, çka do ta shtynte në kalendat greke procesin. Zgjidhja e kompromisit erdhi në minutën e fundit, kur Franca ka hedhur papritur në tryezë një tekst të ri, me një afat gjashtë muaj më të gjatë se sa precedenti malazez, por me pranimin e vënies në lëvizje të mekanizmit përgatitor, që zakonisht zbatohet jo përpara, por pas datës së përcaktuar.

Valentina Madani

Selitë diplomatike më të rëndësishme në Tiranë, delegacioni i BE-së dhe Ambasada e SHBA-ve përgëzuan djehapjen e negociatave për Shqipërinë në 2019-ën, por përfaqësuesit e tyre apelojnë për përmbylljen e reformave kyçe. Për ambasadorin e Bashkimit Europian në Tiranë, Romana Vlahutin, Shqipëria mori 3 mesazhe pozitive që lidhen me njohjen e progresit, datën e hapjes së negociatave dhe nisjen e menjëhershme të punës. "Shqipëria ka marrë tri gjëra shumë të rëndësishme pozitive. E para, njohja e rekomandimeve dhe e gjithë punës dhe reformave që janë bërë në Shqipëri. E dyta, një kalendar i qartë, një datë shumë të qartë për konferencën ndërqeveritare dhe kjo është shumë e rëndësishme. Së treti, Këshilli i Përgjithshëm ka pranuar që komisioni të nisë punën përgatitore. Kjo punë përgatitore është mjaft e madhe", tha Romana Vlahutin. Ambasadorja e Bashkimit Europian në Tiranë përmendi se kalendari i vendosur nga ministrat e Jashtëm të BE-së është për hapjen e negociatave në muajin qershor të vitit 2019, nëse gjithçka shkon sipas parashikimeve. Në përgjigje të interesit të gazetarëve, nëse në qershor të vitit të ardhshëm do të hapen negociatat, apo nëse do të merret vendimi për hapjen e negociatave në një datë tjetër, Vlahutin tha: "Po,



po, ky është kalendari. Dhe kjo është ajo çfarë do të dëgjoni nga ambasadori i ardhshëm i BE-së në Tiranë, por ky është qëllimi. Nuk mund t'ju them për këtë një vit përpara,

por ky është kalendari. Në botën e BE-së kjo tregon se ka një angazhim për këtë datë. Pra, kalendari është shumë i qartë, por në ditët në vijim kur të kemi të gjitha de-

tajet, do t'i ndajmë me ju". Ambasadorja u shfaq e lumtur për vendimin e ministrave të Jashtëm të BE-së. "Megjithatë, unë mund t'ju them se për veten, për delegacionin për të gjithë kolegët që po punojnë fort për Shqipërinë në Bruksel jemi të lumtur. Sepse na jep mundësinë që të lëvizim me një ritëm më të shpejtë dhe të fillojmë përgatitjet. Kjo punë përgatitore është mjaft e madhe dhe kërkon kohën e saj. Kur bëhet fjalë për elementet dhe detajet, në momentin që t'i marr vesh, do t'i ndaj edhe me ju. Por është një punë që do të kryhet nga ana e BE-së dhe nga ana e Shqipërisë", theksoi zj. Vlahutin. Edhe ambasada e SHBA-ve përgëzoi Shqipërinë pas vendimit të ministrave të Jashtëm të BE-së për të hapur negociatat me Shqipërinë dhe Maqedoninë në verën e vitit 2019, nëse plotësohen disa kushte të paracaktuara. Në një deklaratë për media, Ambasada e SHBA-ve në Tiranë tha se Shqipëria ka bërë përparim domethënës dhe se tani nevojitet të rrisë përpjekjet për të përfunduar reformat kyçe. "Përgëzime Shqipërinë për vendimin pozitiv në lidhje me hapjen e bisedimeve për anëtarësim në BE. Shqipëria ka bërë përparim domethënës dhe tani nevojitet të rrisë përpjekjet për të përfunduar reformat kyçe. Ne e nxisim Shqipërinë që të rrisë ritmin në reformën në drejtësi, luftën kundër korrupsionit dhe kundër krimin të organizuar", thuhet në deklaratën e Ambasadës së SHBA-ve në Tiranë.

## Kukan: I besoj angazhimit të Shqipërisë për reformat

Eurodeputeti Eduard Kukan beson se Shqipëria dhe Maqedonia kanë avancuar me axhendën e integritimit në BE, ndaj është shpresëplotë se këto dy vende janë të angazhuara në kryerjen e reformave. "Dua të përgëzoj të dyja vendet për përparimin e bërë në axhendën e integritimit në BE. Ato meritojnë një mesazh të qartë për fillimin e negociatave të pranimit. Një vit u është dhënë vendet të vijnë në tryezën e negociatave, që pasqyrojnë diskutimin e brendshëm të këshillit mbi procesin e zgjerimit të BE. Unë mbështes plotësisht Shqipërinë dhe Maqedoninë në këtë proces dhe i besoj angazhimit të tyre në axhendën e reformave. Pres që të punoj me partnerët tanë gjatë muajve të ardhshëm dhe jam gati të eci me ta në rrugën drejt negociatave të pranimit", tha z.Kukan.

**REPUBLIKA E SHQIPËRISE**  
Zyra përmbarrimore "Best 2010"

**SHPALLJE ANKANDI**

Më datë 3 korrik 2018 nga ora 08.00-ora 16.00 tek kjo zyre përmbarrimore do zhvillohet ankandi për shitjen e pasurisë së shqiptare "Komfort" shp.

Apartamentiçka që do të shetlet rrodhet në ZK 8310, Rr'Dritan Hoxha", Tiranë (kati 7 i ndërtesës, mbi oraj e Bankës NBO). Prona është e debitorit e nuk rrodhet nga aspej detyrim ijtuar civil.

Cmimi fillestar me të cilin hapet ankandi është 11.772.000 lekë.

Cmimi ilogarit edhe në euro sipas kursit të këmbimit ditur.

P.s. Detyruesitshkëlqet që detyrojnë të marrin pjesë në ankand krahas një kërkesë duhet të kenë depozituar dhe 10% të cmimit fillestar si garancë për pjesëmarrjen në ankand. Kjo garancë pasurore duhet të jetë e dorëdhur në BKT, në illogarisë Saimir Hoxha PF (IBAN: AL07 2051 2046 4204 9801 PRCLALIA)

Adresa: L.2, prapa Prokurorisë së Rrethit Durrës. Tel/Fax: 052-22-4000

E-mail: best.2010@permbarrues.al, web: www.permbarrues.al

**REPUBLIKA E SHQIPËRISE**  
Zyra përmbarrimore "Best 2010"

**SHPALLJE ANKANDI**

Më datë 16 korrik 2018 nga ora 08.00-ora 16.00 tek kjo zyre përmbarrimore do zhvillohet ankandi për shitjen e pasurisë nr.5856, vol 17, fq 3 të ndodhur në L.13, ZK 8518, Plazh, Durrës. Trullit që ka sipërfaqen prej 600 m<sup>2</sup> kulturohet sipas një marrëveshje sipërmarje.

Prona është e vëllezërëve, z.Arben e z.Shkëlqim Riza Brameta

Cmimi fillestar me të cilin hapet ankandi do të jetë 570020 Euro.

Cmimi mund të illogarit edhe në lek sipas kursit të këmbimit ditur.

Oftentimes duhet të kenë depozituar në illogarisë e zyrës përmbarrimore 10% të cmimit fillestar.

Adresa: L. 2, prapa Prokurorisë së Rrethit Durrës. Tel/Fax: 052-22-6000

E-mail: best.2010@permbarrues.al, web: www.permbarrues.al

**REPUBLIKA E SHQIPËRISE**  
Zyra përmbarrimore "E.G Bailiff Service"

**SHPALLJE ANKANDI**

Zyra Përmbarrimore "E.G Bailiff Service" me permbarrues Enuar Merko me adresë Rr Ibrahim Rruova, Pall 64, Hyrja 8, Ap 1, Tiranë, njofton se me date 03.07.2018 ora 8<sup>00</sup> - 16<sup>00</sup> në ambientet e saj, do të zhvillohet: Ankandi i I për shitjen e pasurisë të paluajtshme Trullit me sipërfaqe totale 500 m<sup>2</sup> nga e cila Ndërtësi me sipërfaqe 128 m<sup>2</sup>, regjistruar në Z.V.R.P.P Durrës me Nr pasurie 72/67, Vol.3, Fq.189, ZK.1242 në pronësi të Z.Sali Ibrahim Jamaku me vlerë fillestare në ankand 128.640 (Njëqind e njëzet e tetë mijë e gjashtëqind e dyzet) EURO . Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580, 355 4 22 31 888. email enuar.merko@gmail.com

## TARIFAT HETIMI

Ornela Manjani

Konkurrenca i kërkon Aviacionit Civil të ndërhyjë kur ka çmime abuzivisht të larta

# Taksat e TIA zënë 25 % të çmimit të biletave të avionit

Fluturimet drejt Vjenës, mbyllen hetimet, zbardhen shkeljet

Autoriteti i Konkurrencës ka dalë në konkluzionin se një e katërta e çmimit të një bilete në Shqipëri përbëhet nga taksat që vendos koncesionari i aeroportit të Tiranës. Në një vendim të datës 14 qershor, Komisioni i Konkurrencës ka kërkuar nga autoritetet që të marrin masa nga abuzimet që janë duke bërë edhe kompanitë e fluturimit ajror me çmimin e biletave që tregtojnë në Shqipëri. Për këtë arsye Autoriteti i Konkurrencës i rekomandon Autoritetit të Aviacionit Civil që brenda 90 ditëve të kryejë analizën e çmimeve që vendosin linjat ajrore dhe të parandalojë abuzimin me çmimet e larta se rezultat i pozitës dominuese që kanë shumë kompani. Në vendim zbulohet se Aviacioni Civil nuk ka një rregullore ose metodologji për vendosjen e tarifave të biletave. Konkurrenca tregon se në monitorimin që i ka bërë një linje ajrore, Albanian Airlines, ka rezultuar se nga viti 2016 deri në 2017-ën çmimet e biletave janë rritur vetëm si arsye e rritjes së kërkesës për fluturime dhe jo e kostove të kompanisë. Abuzime të shumta janë gjetur edhe me shumë pasagjerë, të cilëve iu është anuluar fluturimi pa arsye dhe nuk kanë marrë kompensim, ndërsa vetë institucionet përgjegjëse nuk janë marrë masa për të rregulluar këtë situatë. Në pikën e fundit të vendimit, komisioni i konkurrencës kërkon që edhe koncesionari i Rinasit duhet të marrë masat që shfaqë në vende të dukshme brenda aeroportit informacionin mbi të drejtat e udhëtarëve dhe informimin e tyre për anulimet e fluturimeve. Vetëm në rastin e linjës Tiranë-Vjenë është evidentuar se çmimi mesatar i biletave është 190 euro, 7.7% më i lartë se mesatarja e rajonit.

### HETIMI

Autoriteti i Konkurrencës ka vendosur të mbyllë procedurën e hetimit paraprak në tregun e transportit ajror të pasagjerëve ndaj ndërmarrjes Austrian Airlines, duke dhënë disa rekomandime për analizën e çmimeve për operatorët me pozitë dominuese dhe rritjen e transparencës ndaj pasagjerëve. Konkurrenca thotë se Autoriteti i Aviacionit Civil (AAC) ka tagrin ligjor që të marrë të gjitha masat e nevojshme për parandalimin e tarifave dhe praktikave diskriminuese, çmimeve abuzivisht të larta



### Të rritet transparenca

Konkurrenca reko mandon që ndër-marrja Austrian Airlines, për shkak të pozitës së saj dominuese në treg, duhet të jetë sa më transparente me pasagjerët e saj dhe t'i informojë ata (paraprakisht kur është e mundur) për anulimin e fluturimit, ndryshimin e orarit etj. Gjithashtu, ndërmarrja Austrian Airlines, si i vetmi transportues ajror për linjën direkt Tiranë - Vjenë dhe anasjelltas, duhet të minimizojë sa më shumë tregtimin e biletave mbi kapacitetin e avionit, sidomos gjatë sezonit të lartë, për të shmangur ndonjë sjellje të mundshme anti-konkurrense në treg, e cila i vendos pasagjerët në kushte të pafavorshme konkurrence. Transportuesi ajror (Austrian Airlines) duhet t'i sigurojë pasagjerëve që pranë kontrollit të biletave (check-in desk) dhe pranë portës së hyrjes (boarding gate) të kenë një njoftim të lexueshëm dhe të qartë lidhur me të drejtat e tyre, i cili duhet të ekspozohet në mënyrë të dallueshme për pasagjerët.

## Aviacioni Civil të analizojë kostot

Konkurrenca thotë se në bazë të nenit 11 të Kodit Ajror, përcaktohet qartë se çmimet e transportit ajror vendosen lirish nga tregu dhe transportuesit ajrorë informojnë publikun për të gjitha tarifaj ajrore për pasagjerët, postën dhe ngarkesat. Në këtë nen përcaktohet dhe detyrimi për Autoritetin e Aviacionit Civil (AAC) që të marrë të gjitha masat e nevojshme për parandalimin e tarifave dhe praktikave diskriminuese, çmimeve abuzivisht të larta si rezultat i një pozitë dominuese dhe çmimeve abuzivisht shumë të ulëta. Për të bërë të zbatueshme kontrollin e tarifave shumë të ulëta apo shumë të larta që aplikohen nga transportuesit ajror me pozitë dominuese në treg ndaj pasagjerëve, në zbatim të këtij neni të Kodit Ajror, ministri duhet të miratojë rregullore për përcaktimin e rregullave të hollësishme. Pra, për



të parandaluar tarifaj dhe praktikaj diskriminuese, çmimet abuzivisht të larta si rezultat i një pozitë dominuese dhe çmimet abuzivisht shumë të ulëta, AAC duhet të kryejë analizën e çmimeve të aplikuara nga transportuesit ajror me pozitë dominuese në treg, siç është rasti i ndërmarrjes Austrian Airlines. Pas kryerjes së analizës së çmimit të aplikuar nga ndërmarrja me pozitë dominuese, AAC duhet të vlerësojë nëse kjo ndërmarrje aplikon çmime shumë të larta apo

shumë të ulëta në treg. Siç përmendëm edhe më lart, AAC nuk disponon një metodologji për të kryer këtë vlerësim. Gjithashtu, edhe në Udhëzimin e ministrit Nr. 17, datë 02.09.2010 "Mbi rregullat e zbatueshme të operimit në fushën e shërbimeve ajrore", nuk është parashikuar rasti i aplikimit të çmimeve abuzivisht të larta apo çmimeve abuzivisht shumë të ulëta, si rezultat i një pozitë dominuese të ndërmarrjes në treg.

si rezultat i një pozitë dominuese dhe çmimeve abuzivisht shumë të ulëta. Por, AAC nuk disponon një metodologji për të kryer këtë vlerësim, ndaj Konkurrenca i ka rekomanduar që

brenda 90 ditëve AAC duhet të kryejë analizën e çmimeve të aplikuara nga transportuesit ajrorë me pozitë dominuese në treg, për të parandaluar tarifaj dhe praktikaj diskriminuese,

çmimet abuzivisht të larta si rezultat i një pozitë dominuese dhe çmimet abuzivisht shumë të ulëta. Krahas analizës, Aviacioni Civil duhet të hartojë një metodologji për llogaritjen e kostove të ndër-

marrjeve për krahasimin e çmimeve abuzivisht të larta dhe praktikave diskriminuese. Konkurrenca ka paralajmëruar ndërkohë se ajo do të monitorojë për një vit sjelljen e Austrian Air-

lines, duke raportuar pranë Autoritetit të Konkurrencës çdo 4 muaj në lidhje me çmimet që ka aplikuar, numrin e ankesave që ka pasur, rastet të overbooking.

### POZITA DOMINUESE NË LINJËN TIRANË-VJENË

Austrian Airlines vepron e vetme në linjën direkte Tiranë - Vjenë (TIA-VIE), Vjenë - Tiranë (VIE-TIA) dhe Konkurrenca vlerëson se kompania ka pozitë dominuese në linjën direkte Tiranë - Vjenë dhe anasjelltas. Autoriteti ka analizuar dhe strukturën e kostos së biletës për në Vjenë. Taksat përfaqësojnë deri 25% të çmimit total të biletës. Tarifa mesatare e çmimit të biletave Tiranë - Vjenë dhe anasjelltas për vitin 2016 është 156 euro, ndërsa për vitin 2017 kjo tarifë është 161 euro. Rritja e lehtë e çmimit mesatar të biletave nga 2016 në 2017 sipas ndërmarrjes Austrian Airlines vjen nga rritja e kërkesave në fluturim për këtë linjë. Nga krahasimi i çmimit të biletave të avionit me vendet e rajonit për udhëtime vajtërdhje rreth datave 4 deri më 11 qershor drejt të njëjtit destinacion, Vjenës me të njëjtën linjë ajrore Austrian Airlines, për nisje nga Tiranë është 190 euro, përkatësisht 7.7% më i lartë se mesatarja e vendeve të rajonit (pa Shqipërinë). Prishtina rezultoi të jetë vendi me çmimin e biletave më të lartë në rajon me 198 euro, ose 12.3% më të lartë se mesatarja. Çmimin më të lirë të biletave drejt Vjenës e ka Shkupi (160 euro), ose 9.3% më lirë se mesatarja e rajonit. Ndërsa Mali i Zi e ka çmimin pothuajse sa mesatarja e rajonit. Gjithashtu, duhet marrë parasysh se Shqipëria dhe Kosova kanë vetëm një aeroport, Maqedonia dhe Mali i Zi kanë nga dy aeroporte, ndërsa Kroacia ka tetë aeroporte. Linja ajrore Austrian Airlines ofron udhëtim direkt për në Vjenë (pa ndalesë), ndërsa linjat e tjera që e ofrojnë këtë mundësi janë udhëtime jo direkte (me një ndalesë) dhe në rastin tonë janë të pazvëndësueshme. Pra, udhëtimi direkt me Austrian Airlines mbetet alternativa më e mirë për konsumatorët duke qenë se është linjë direkte dhe nuk ka humbje kohe për ta. Gjithashtu, duhet pasur parasysh se më formimin e çmimit, duhen marrë në konsideratë dhe taksat aeroportuale dhe çmimi i karburantit të avionëve që janë të ndryshme në vende të ndryshme.



Dokumentet duhet të dorëzohen elektronikisht nga data 1 deri më 20 korrik 2018

# Shtohen kategoritë e profesioneve të lira, Tatimet: Deklaroni listëpagesat

## "Vonesat në raportimin 'online' penalizohen"

Ornela Manjani

**D**rejtoria e Përgjithshme e Tatimeve iu ka lënë afat nga data 1 deri në 20 korrik të gjithë personave që ushtrojnë profesione të lira për të dorëzuar elektronikisht listëpagesat. Përmes një njoftimi, Tatimet bëjnë të ditur për të gjithë tatimpaguesit, se duke filluar nga data 1 korrik 2018, listëpagesat që do të gjenerohen nga sistemi për periudhën tatimore qershor 2018 dhe që do të dorëzohen elektronikisht nga data 1 deri më 20 korrik 2018, do të reflektojnë kodet e rishikuara të profesioneve sipas Listës Kombëtare të Profesioneve të Miratuara me VKM nr. 514 nr. 514, datë 20.09.2017 dhe të publikuar në Fletoren Zyrtare Nr. 169, datë 22 shtator 2017. Këto ndryshime kanë të bëjnë kryesisht me shtimin e disa kategorive të reja të profesioneve, ndryshime në kategoritë ekzistuese, si dhe pafleshmërinë e disa kategorive të Listës Kombëtare të Profesioneve të përdorura deri para hyrjes në fuqi të vendimit të mësipërm.



Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve

**LISTA E RE**

Implementimi i ndryshimeve të mësipërme në listëpagesë do të mundësojë në pjesën më të madhe të tyre përditësimin automatik. Në këto raste, tatimpaguesi do të dorëzojë listëpagesën e tij pa genë e nevojshme të përditësojë kategorinë e profesioneve edhe nëse ajo ka ndryshuar. Tatimpaguesit, të cilët kanë të paktën një punonjës, për të cilin sistemi identifikon se "Emri i Kategorisë së Profesioneve" nuk është më i vlefshëm sipas listës së re, nuk do të mund të dorëzojnë listëpagesën pa ndryshuar/përditësuar këtë kategori. Sistemi automatikisht do të

### Gjikhuri në Uashington, siguria energjetike, kontribut për stabilitetin

**N**ë kuadër të vizitës që po kryen në Washington të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë, Damian Gjikhuri vazhdoi takimet me zyrtarë të lartë të administratës së Presidentit Trump. Gjatë pritjes së organizuar në Departamentin e Shtetit për delegacionet e nivelit të lartë pjesëmarrës në Konferencën Botërore të Gazit, ministri Gjikhuri takoi Sekre-

tarin e Shtetit Michael Pompeo dhe Sekretarin për Energjinë Rick Perry. Gjatë këtyre takimeve u bisedua për projektet strategjike që lidhen me sigurinë energjetike evropiane dhe rolin që ka Shqipëria në këto procese. "Gjeta mbështetjen e zyrtarëve të lartë të administratës së Presidentit Trump për atë çka po bën Shqipëria në lidhje me ecurinë e Korridorit Jugor të Gazit, si vendi që ka kontribuar më shumë në ecur-

**PROFESIONET**

- Forcat e Armatosura
- Menaxherë.
- Specialistë me arsim të lartë (profesionistë).
- Teknikë dhe specialistë në zbatim.
- Nëpunësit.
- Punonjës të shitjeve dhe të shërbimeve.
- Punonjës të kualifikuar të bujqësisë, pyjeve dhe peshkimit.
- Zejtarë, artizanë dhe profesione të lidhura me to
- Punonjës të montimit dhe përdorimit të makinerive dhe pajisjeve.
- Punëtorë (Profesione elementare).

shfaqë një mesazh paralajmërues, përmes të cilit tatimpaguesit do të informohen rreth detajeve të punonjësit, për të cilin do të duhet të bëhet përditësimi manual. Më pas tatimpaguesi duhet të klikojë në fushën e kategorisë dhe të përzgjedhë profesionin apo funksionin që i përshkruan rastin konkret. DPT u bën thirrje subjekteve të verifikojnë dhe të përditësojnë ndryshimet e mësipërme në listëpagesa, duke filluar që nga data 1 korrik 2018, për të bërë të mundur deklarimin e tyre brenda afatit për të shmangur çdo penalitet për dorëzim të vonuar.



Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë, Damian Gjikhuri, dhe Peter Maroço

inë e këtij projekti madhor për Evropën dhe sigurinë energjetike globale"-u shpreh ministri Gjikhuri. Një tjetër takim, ministri Gjikhuri e realizoi me zëvendës nënsekretarin e shtetit për stabilizimin e konfliktëve Peter Maroço. "Pata mundësinë të takohem me një tjetër mik të Shqipërisë me të cilin diskutuam mbi sigurinë e Ballkanit Perëndimor dhe rolin që luan Shqipëria si faktor stabiliteti në rajon. Një vëmendje e

veçantë u tregua edhe për sigurinë energjetike dhe projektet e ndërlydhjes energjetike si instrument i zhvillimit ekonomik. U vlerësua roli i qeverisë shqiptare për politikën e ndërmarra në rajon dhe si një faktor i rëndësishëm i stabilitetit"-theksoi ministri Gjikhuri.

**EPSA** SHOQËRIA PËRMBARUESE PRIVATE "E.P.S.A" SHPK NJOFTON SHPALLJEN E ANKANDIT PER:

- 1- "Pyll + Kullote" me sip. 280.000 m2, Nr. hipotekor 168 date 29.05.2012, ZK 3028, e ndodhur ne Poro, Vlore. Kjo pasuri eshte hipotekuar ne favor te Banka Raiffeisen sha. Çmimi me te cilin fillon ankandi eshte **4.800.320 Euro** . Ankandi zhvillohet **datë 26.07.2018 ora 16.00** ne adresen Rr."I. Qemali", Pall."Fratar", K.6,Tirane.
- 2- "Pyll + Kullote" me sip. 95.000 m2, Nr. hipotekor 66 date 25.03.2009, ZK 3028, e ndodhur ne Poro, Vlore. Kjo pasuri eshte hipotekuar ne favor te Banka Raiffeisen sha. Çmimi me te cilin fillon ankandi eshte **1.628.680 Euro** . Ankandi zhvillohet **datë 26.07.2018 ora 16.00** ne adresen Rr."I. Qemali", Pall."Fratar", K.6,Tirane.
- 3- "Truall + Ndërtim" me sip.3,250 m2 nga kjo 1474,5 m2 ndërtesë me adresë Xhafzotaj, Durrës. Kjo pasuri eshte hipotekuar ne favor te Banka Raiffeisen sha. Çmimi me te cilin fillon ankandi eshte **545.440 Euro** . Ankandi zhvillohet **datë 26.07.2018 ora 16.00** ne adresen Rr."I. Qemali", Pall."Fratar", K.6,Tirane.
- 4- **Për pasurinë** me Nr.578/184, vol.13, fq.216, Zk.3385, me sip.1,270 m2 me adresë Shkallnur, Durrës, Kjo pasuri eshte hipotekuar ne favor te Banka Raiffeisen sha. Çmimi me te cilin fillon ankandi eshte **35.560 Euro** . Ankandi zhvillohet **datë 26.07.2018 ora 16.00** ne adresen Rr."I. Qemali", Pall."Fratar", K.6,Tirane.
- 5-**Për pasurinë** me Nr.1/973+1-9, vol.41, fq.85, Zk.8513, me sip.119,2 me adresë Rr."Muco/15", Durrës, Kjo pasuri eshte hipotekuar ne favor te Banka Raiffeisen sha. Çmimi me te cilin fillon ankandi eshte **40.040 Euro** . Ankandi zhvillohet **datë 26.07.2018 ora 16.00** ne adresen Rr."I. Qemali", Pall."Fratar", K.6,Tirane.
- 6-**Për pasurinë** me Nr.160/51, vol.16, fq.72, Zk.2574, me sip.2.470 m2 me adresë Xhafzotaj, Durrës, Kjo pasuri eshte hipotekuar ne favor te Banka Raiffeisen sha. Çmimi me te cilin fillon ankandi eshte **138.320 Euro** . Ankandi zhvillohet **datë 26.07.2018 ora 16.00** ne adresen Rr."I. Qemali", Pall."Fratar", K.6,Tirane.
- 7- **Për pasurinë** me Nr.160/50, vol.6, fq.71, Zk.2574, truall + ndertese me sip.7.330 m2 me adresë Xhafzotaj, Durrës, Kjo pasuri eshte hipotekuar ne favor te Banka Raiffeisen sha. Çmimi me te cilin fillon ankandi eshte **941.360 Euro** . Ankandi zhvillohet **datë 26.07.2018 ora 16.00** ne adresen Rr."I. Qemali", Pall."Fratar", K.6,Tirane.

Per cdo informacion kontaktoni ne tel. 04 2262711 ose ne [www.epsa.al](http://www.epsa.al)

**PROFARMA**  
CURE TECHNOLOGY,  
HEALING PHILOSOPHY

**NJOFTIM**

**Shoqëria Profarma sh.a, me seli në adresën: Rr."Myslym Keta", Ish-Antibiotiku, Tiranë, njofton mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë më datë 27 Korrik 2018, në orën 10:00, në ambientet e selinë së shoqërisë, sipas këtij rendi dite:**

1. Miratimin e Raportit të Drejtorit dhe të Ekspertit Kontabël të Treguesve Ekonomiko-Financiar për vitin ushtrimor 2017;
2. Emërimin e Ekspertit Kontabël për vitin ushtrimor 2018 - 2019;
3. Shpërndarjen e Dividendit;
4. Të ndryshme.

**Aksioneret jane të lutur që të marrin pjesë në këtë mbledhje dhe të respektojnë kërkesat e nenit 11 të statutit të shoqërisë dhe Ligjin Nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar.**

Katër të arrestuarit kyçin gojë para prokurores. Policia: Dyshime për përfshirje të personave të tjerë në histori

# Hetimi i 3.4 mln eurove, shpallen në kërkim ndërkombëtar Alfred dhe Elvis Vladi

*Autoritetet u kërkojnë ndihmë homologëve belgë, gjermanë e italianë*

Ina Allkanjari

Në kuadër të zhvillimit të hetimeve për kapjen dhe sekuestrimin e 3.4 milionë euro në portin e Durrësit mesditën e së dielës, 4 të arrestuarit e kësaj çështjeje kanë dalë ditën e djeshme para prokurorëve. Konkretisht Agim Çeka, Edi Lika, Klevi Lika dhe Alban Mollaymeri janë pyetur nga prokurorja Ornella Rrumbullaku. Mësohet se ata i kanë qëndruar deklarimeve të dhënave merhet, duke mos dhënë dëshmi të reja. Të arrestuarit akuzohen për veprat penale "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale e kryer në bashkëpunim", "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarakë dhe e municionit" dhe "Falsifikimi i monedhave". Ndërkohë ditën e sotme 4 të pandehurit pritet të dalin përpara gjykatës së Durrësit për t'u njohur me masën e sigurisë.

**HETIMET**

Policia shqiptare ka shpallur në kërkim ndërkombëtar dy kushërinjtë, Alfred dhe Elvis Vladi, të cilët dyshohen se janë personat që kishin organizuar trafikun e 3.4 milionë eurove nga Belgjika për në vendin tonë. Ndërkohë hetimet e policisë dhe prokurorisë pritet të shtrihen jashtë vendit. Burime nga grupi hetimor bëjnë të ditur se iu është kërkuar bashkëpunim edhe homologëve të tyre belgë, gjermanë dhe atyre italianë rezultojnë pronarë biznesesh. Referuar këtyre të dhënave Elvis Vladi ka themeluar një kompani në shtator 2015, që ofron pjesë këmbimi për automjetet. Kushëri i tij Alfred Vladi rezultoi të ketë themeluar në gusht të 2017, një kompani me objekt kryesor dhënie me qira të automjeteve dhe Shërbime të këmbimit valutë, nën emrin e subjektit në histori.

Një ndër personat e arrestuar, shtetasi Alban Mollaymeri mësohet se kishte kontraktuar për transportin e makinave kompaninë e Edi Likës, e cila gëzonte të drejtën e transportit ndërkombëtar të mjeteve për të tretë me qira. Nuk dihet ende nëse Mollaymeri u porositi nga dy personat e shpallur në kërkim, por 40-vjeçari Mollaymeri deklaroi gjatë hetimeve se atij i ishte kërkuar ky shërbim nga Alfred Vladi, duke mohuar të kishte dijeni për 3.4 milionë euro që u gjetën në makinë. Kujtojmë se pasuria e Alfred dhe Elvis Vladi, të shpallur në kërkim si porositesit e 2 'Toyotave' ku u gjetën paratë do të jetë subjekti i ligjit Antimafia. Mësohet se do të vihen nën sekuestrim pasuritë e tyre, llogari bankare dhe pasuri të tjera të paluajtshme. Të dy kushërinjtë nga Dibra janë arratisur dhe dyshohet se kanë dalë jashtë



Elvis Vladi



Alfred Vladi

**KUSHËRINJTË VLADI**

Burime nga grupi hetimor bëjnë të ditur se iu është kërkuar bashkëpunim edhe homologëve të tyre belgë, gjermanë dhe atyre italianë për të rënë në gjurmë të dy kushërinjve Vladi si dhe për të marrë informacion lidhur me vendin ku janë ngarkuar makinat në Belgjikë, që më pas udhëtuan drejt Gjermanisë, Italisë dhe më pas mbërritën në Shqipëri.

vendit. Nga verifikimet e bëra në qendrën kombëtare të biznesit, dy kushërinjtë Vladi rezultojnë pronarë biznesesh. Referuar këtyre të dhënave Elvis Vladi ka themeluar një kompani në shtator 2015, që ofron pjesë këmbimi për automjetet. Kushëri i tij Alfred Vladi rezultoi të ketë themeluar në gusht të 2017, një kompani me objekt kryesor dhënie me qira të automjeteve dhe Shërbime të këmbimit valutë, nën emrin e subjektit në histori.

tregtar ("Tirana Rental Car"). Oficerët janë duke verifikuar edhe pasuritë e familjarëve të afërt të tyre për të parë nëse ata i justifikojnë ato.

Në sitën e hetuesve do të kalojë dhe pasuria e 4 të arrestuarve të tjerë Agim Çeka, Edi Lika, Klevi Lika dhe Alban Mollaymeri. Ky i fundit ka në pronësi një servis pranë zonës së bregut të lumit në kryeqytet.

**OPERACIONI**

Policia e Shtetit është

vënë në dijeni nga burimet e saj vendase, në datën 20 qershor 2018, ditën e mërkurë, për një karroatrec me targa 'AA 120 SP', që pritet të transportonte disa automotura, e mes tyre një mjet me sasi eurosh të padeklaruar, pa specifikuar tipin e automjeteve dhe as origjinën e vendit. Me marrjen e këtij informacioni, iu është dhënë porosi gjithë strukturave të pikat e kalimit kufitar për konstatimin dhe kontrollin e kësaj ngarkese.

Ditën e enjte, 21 qershor 2018, në mesditë, gjatë punimeve të parlamentit në sallën e Kuvendit, është bërë publik fakti lidhur me një automjet tip "Toyota Yaris" me 1.5 milion euro, të zbuluar në Gjermani. Po atë ditë, të enjten e kaluar, datë 21 qershor 2018, një agjenci ligj zbatuese shqiptare në orën

17:00, ka njoftuar Policinë e Shtetit lidhur me një informacion për një ngarkesë me trajler që do të sillte disa mjete tip 'Toyota', e cila pritet të vinte nga Gjermania, e mes tyre një mjet me sasi eurosh të padeklaruar. Në datë 24 qershor 2018, në Portin e Durrësit në orën 07:30, mbërriti nga Belgjika një trajler tip "Bizark" me 9 automjete, përmes Portit të Barit, Itali. Policia Kufitare, mbi bazën e porosisë së marrë në datë 20 qershor, ka bërë identifikimin dhe ndalimin e mjetit. Policia e Shtetit ka njoftuar Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Durrës, e cila po drejton hetimet. Më tej, specialistët për Hetimin e Krimeve në Drejtorinë Rajonale për Kufirin dhe Migracionin Durrës në bashkëpunim me efektivet e Drejtorisë Vendore të Policisë Durrës, nën drejtimin e prokurorisë, finalizuan operacionin dhe kryen veprimet procedurale.


Policia ka arrestuar në flagrancë shtetasit: Agim Çeka, 61 vjeç, lindur në Luz i Madh, banues në Durrës; Edi Lika (Cani), 41 vjeç, lindur në Dibër, banues në Tiranë; Klevi Lika, 21 vjeç, lindur në Bulqizë, banues në Tiranë; Alban Mollaymeri, 40 vjeç, lindur dhe banues në Tiranë. Gjithashtu, janë shpallur në kërkim dhe punohet për kapjen e shtetasve: Alfred Vladi 33 vjeç, lindur në Peshkopi e banues në

Tiranë; Elvis Vladi 38 vjeç, lindur në Peshkopi e banues në Tiranë.

Gjatë kontrollit të ushtruar në Pikën e Kalimit Kufitar Durrës në automjetin tip 'Bizark' të drejtuar nga shtetasi Agim Çeku dhe pronar Klevi Lika (Cani), në 2 automjete të ngarkuar në të, tip 'Toyota' janë gjetur një shumë e konsiderueshme eurosh dhe franga zvicerane, të padeklaruar. Gjithashtu, janë ushtruar kontrole në banesat dhe ambiente të tjera të personave të dyshuar. Janë sekuestruar në cilësinë e provave materiale: 3,366,800 euro dhe 100 euro që dyshohet të jenë të falsifikuara; 80,000 franga zvicerane; 10 automjete, nga të cilat 7 automjete të tipit 'Toyota Yaris', 1 tip 'Alfa Romeo', 1 tip 'Opel' dhe 1 tip 'Bizark'; 1 armë kallashnikov me 2 krehëra fishekë, gjetur nga kontrolli i ushtruar në banesën e shtetasit A.Çeka; 1 radio policie; 7 telefona celularë. Nga hetimet paraprake, Policia e Shtetit ka të dhëna të besueshme se ngarkesa e sekuestruar ishte e porositur nga shtetasi Elvis Vladi dhe Alfred Vladi, tashmë të shpallur në kërkim. Hetimet po vijojnë drejt zbardhjes e plotë të rrethanave të ngjarjes dhe zbulimin e personave të tjerë të implikuar.

## Eurot në portin e Durrësit, Taulant Balla kallëzon Bashën për nxjerrje të sekretit hetimor

sikur tha Basha ditën e enjte në Kuvend. "Njëri prej atyre që zgërdhëhen me shumë (duke treguar me gisht nga Balla, që po qeshte bashkë me Ramën) ka qenë në Gjermani para tre ditësh. Mbajeni mend këtë që po ju them! Dhe ka porositur një 'Toyota Yaris' Por ta kanë zbuluar 'Toyotën', o zgërdhëtar, bashkë me 1.5 milion euro të drogës brenda! Vazhdo qesh, do ta shikosh se çfarë do të tundet para hundës shumë shpejt", ka thënë Basha ditën e enjte në Kuvend, e që sipas kreut të Grupit të PS-së ka përhapur qëllimisht sekretin hetimor". ka thënë Basha ditën e enjte në Kuvend, e që sipas kreut të



Faksimile e kallëzimit penal të Taulant Ballës

grupit të PS-së ka përhapur qëllimisht sekretin hetimor. Por duke iu përgjigjur

akuzave, Balla mohoi të kishte qenë në Gjermani dhe përmendi emrat e Mimi Kodhe-

lit, Lulzim Bashës dhe Sali Berishës si politikanët shqiptarë që kanë shkuar këto 20 ditët e fundit në Gjermani. "Në Gjermani, në 20 ditët e fundit kanë qenë: Nga PS, Mimi Kodheli, nga PD Sali Berisha, dhe Lulzim Basha. Këta di unë që kanë qenë në Berlin. Tani, nëse Saliu ka qenë me drogë në 'Toyota Yaris' dhe e ka parë Lulzim kjo është çështje dueli për lidhshinën e PD. Lulzim Basha ka probleme si Babalja. Të kesh parë një person qoftë deputet me një 'Toyota Yaris' me 1.5 milionë euro para të drogës dhe të mos e denoncosh..." - tha Balla.




Rolet e biznesmenëve dhe 3 rastet e trafikimit të drogës. Ja vendi ku bëheshin takimet

Ina Allkanjari

# Trafikuan heroinë, prokuroria kërkon 131 vite burg për 9 të pandehurit

## Zbrardhet dosja, si u zbulua rrjeti i Jurgen Mollës

Prokuroria e Krimeve të Rënda ka përfunduar hetimet për bandën e Jurgen Mollës të akuzuar për trafik ndërkombëtar droge. Nëntë të prangosurit në kuadër të operacionit të koduar "Ballkan", të akuzuar për trafik heroinë nga Shqipëria në Kosovë dhe më pas drejt Europës, rrezikojnë 131 vite burg. Ditën e djeshme organi i akuzës lexoi pretendencën duke kërkuar 17 vite burg për Jurgen Mollën të konsideruar kreun e grupit kriminal të trafikimit të heroinës e kanabisit. Për anëtarët e tjerë të grupit të trafikimit prokuroria kërkoj konkretisht: 16 vite burg për Shyqyri Kotorri; 15 vite burg për Anest Koromani; 15 vite burg për Arif Çiço; 15 vite burg për turkun Enver Kurtulush; 14 vite burg për Abubekir Tunçdemir; 14 vite burg për Blerim Ukimere; 12 vite burg për Elmi Thaci dhe 13 vite burg për Orges Myftaraj. Të pandehurit, sipas prokurorisë ishin përfshirë në trafikun e lëndëve narkotike e llojit heroinë nga Turqia në Kosovë, Greqi, Shqipëri e më pas destinacioni final ishin vendet e Bashkimit Europian përgjatë viteve 2015-2016. Në dosjen e prokurorisë, të siguruar nga "Gazeta Shqiptare" theksohet se pjesëmarrësit në këtë veprimtari kriminale jo vetëm janë në një numër të konsiderueshëm me shtrirje në hapësirë të disa shteteve dhe që kanë vepruar në kohë në disa episode kriminale, por edhe se në mënyrë të qartë kanë pasur mes tyre organizime dhe strukturë të zhvilluar. "Rolet e detyrat mes tyre kanë qenë të qarta duke kapërcyer tiparet e grupit të strukturuar kriminal madje duke qenë në kufijtë e organizatës kriminale. Kështu gjatë kësaj veprimtarie kriminale u provua se të pandehurit Jurgen Molla, Anesti Koromani dhe Shyqyri Kotorri kanë qenë në rolin e financuesve dhe organizatorëve të aktivi-



**PRETENCA**  
Nëntë të prangosurit në kuadër të operacionit të koduar "Ballkan", të akuzuar për trafik heroinë nga Shqipëria në Kosovë dhe më pas drejt Europës, rrezikojnë 131 vite burg. Ditën e djeshme organi i akuzës lexoi pretendencën duke kërkuar 17 vite burg për Jurgen Mollën, të konsideruar kreun e grupit kriminal të trafikimit të heroinës e kanabisit.

tetit të trafikimit të lëndëve narkotike nga Turqia në Shqipëri", thuhet dosjen e prokurorisë. Në rolin e ndërmjetës mes organizatorëve të këtij trafikimi dhe personave të tjerë që kishin në posedim lëndën narkotike që do të trafikoheshin shtetasit Arif Çiço, enver Kurtulush, Abu Bakir Tunçdemir. Ndërsa të pandehurit Blerim Ukimere, Ilmi Thaci, Orges Myftaraj dhe Klaudio Veizaj ishin në rolin e ndihmësve. 9 të pandehurit akuzohen se janë pjesë e një rrjeti më të gjerë të arretuarish. Kujtojmë se në korrik 2016, në kuadër të operacionit "Ballkan" policia arres-

ngarkim të dyshuarve si pjesë e rrjetit të trafikimit të drogës mes Turqisë-Greqisë-Maqedonisë-Kosovës dhe Shqipërisë, evidentohen 3 rastet e trafikimit të lëndëve narkotike. Sipas materialit të përpiluar nga prokurori Eugen Beçi dhe që ka bindur gjykatën e krimeve të rënda t'i caktojë masën e sigurisë "arrest me burg" të dyshuarve, përgjimet janë prova kryesore në ngarkim të të dyshuarve. Në dosje thuhet se Jurgen Molla ka organizuar në 3 raste trafikun e drogës dhe ishte personi që kishte njoheje me kosovarin Arif Çiço, i cili kryente rolin e ndërmjetës mes shtetasit turq, të cilët sigurojnë heroinën. Prokuroria thotë se është provuar se në rastin e parë, Jurgen Molla ka organizuar trafikun e drogës dhe transportimin e 15 kg heroinë nga Prizreni në drejtim të Tiranës. Për të blerë këtë sasi, Jurgen Molla ishte takuar me kosovarin Arif Çiço dhe shtetasit turk që kishin drogën.

shuar edhe vendin. Pikë-takimi bëhet qyteti grek i Selanikut dhe që andej duhej të trafikoheshin në Shqipëri. Për këtë rrugë dy ndërtuesit kontaktuan me pronarin e kompanisë së betonit Shyqyri Kotorri. Ky i fundit kishte pranuar transportin e 15 kg heroinë kundrejt 5 kg që do të mbante për vete. Por si rezultat i bashkëpunimit mes policive rajonale, ishte policia greke që në këtë rast arrestoi më 18 shtator 2015, dy korrierët turq dhe bllokoi drogën që do të vinte në Shqipëri. Duke aplikuar të njëjtë skemë, të dyshuarit i rikthehen përsëri Prizrenit për një rast të tretë të trafikimit të drogës nga Kosova. Jurgen Molla dhe Anesti Koromani përsëri në rolin e blerësve tek shtetasit turq. Por për shkak se ishin në ndjekje dhe në përgjim, edhe sasia prej 500 gramëve heroinë u bllokua në Tiranë në mars të këtij viti, ku u arrestua Anesti Koromani dhe bashkëpunëtori i tij Romeo Beqo. Për prokurorinë, si pjesë e këtij rrjeti janë edhe të dyshuarit Nuredin Nazëraj, i cili kishte organizuar për të dërguar në Greqi një sasi prej 5 kg hashash në formë pagësë për heroinën që do vinte në Shqipëri për llogari të Jurgen Mollës. Por edhe kjo tentativë mbeti e pa realizuar, pasi policia arrestoi korrierin Viktor Behaj së bashku me 5 kg hashash.

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**BANKA E SHQIPERISE**  
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT  
SEKTORI I PROKURIMIT

**TENDER I HAPUR NDËRKOMBËTAR**

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: "Upgrade i Sistemit të Regjistrimit të Kredive të Bankës së Shqipërisë"

Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur ndërkombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 30,000,000 Lekë ose 226,655 Euro**.

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halli", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411(ext. 4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e paktyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë  
BIC: STANALTR  
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC  
Përkshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: "Upgrade i sistemit të Regjistrimit të Kredive të Bankës së Shqipërisë"

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më **datë 26 Korrik 2018, ora 09:00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**BANKA E SHQIPERISE**  
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT  
SEKTORI I PROKURIMIT

**TENDER I HAPUR KOMBËTAR**

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: "Blerje dhe implementim i 4 copë pajisje 'SAN Switch' për nevojat e Bankës së Shqipërisë"

Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 27.000.000 Lekë**.

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halli", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411(ext. 4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e paktyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë  
BIC: STANALTR  
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC  
Përkshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: "Blerje dhe implementim i 4 copë pajisjeve 'SAN Switch' për nevojat e Bankës së Shqipërisë"

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më **datë 25 Korrik 2018, ora 11:00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

## Shëndetësi

Ajri i keq i mbushur me grimca (bakterie, spore kërpudhash) përmban edhe gazra të rrezikshëm për shëndetin tonë e zakonisht ndotja më e madhe paraqitet në zonat urbane. Pra, ky përbërës që futet në rrugët respiratore, **shkon në mushkëri e bëhet shkëmbimi i gazit karbonik me oksigjenin, por gazi që merr gjakun nuk është më i pastër, por i kontaminuar.**



**Mjeku popullor:** Ndotja e mënyra e jetesës, faktorët kryesorë në problemet me gjakun

# YLLI MERJA: Si të luftoni lodhjen e këputjen me bimë mjekësore

Voltiza Duro

Njeriu në vetvete është produkt i natyrës dhe bashkëpunon me të edhe pse në shumë raste ai abuzon me këtë pasuri të madhe, pra nuk i zbatojnë ligjësitë e saj. Por kjo ndikon në shëndetin e njeriut, mbarëvajtjen e mirëqenien e tyre. Po të vërejmë efektin përvëlues të diellit në ditët e sotme është shumë herë më i lartë sesa 30 vite më parë e kjo pasi vetë ne kemi prishur balancën e shtresave të ajrit dhe të përbërësve të tij. Gjithë ky disbalancim ka ndikuar që të rritet sasia e gazit karbonik nga ndotësit e ajrit (tymrat, makinat) që shohërohet me efekte negative të rrezatimit diellor. Vlen të theksoj se ajri i keq i mbushur me grimca (bakterie, spore kërpudhash) përmban edhe gazra të rrezikshëm për shëndetin tonë e zakonisht ndotja më e madhe paraqitet në zonat urbane. Pra, ky përbërës që futet në rrugët respiratore, shkon në mushkëri e bëhet shkëmbimi i gazit karbonik me oksigjenin, por gazi që merr gjakun nuk është më i pastër, por i kontaminuar. Më tej ky gjak jo i pastër shkon në tru, muskuj e qeliza dhe duke mos pasur cilësi do të shfaqen efektet e para negative në sistemin nervor, qarkullimin e gjakut e organet e tjera. Më të predispozuarit për t'u prekur nga ky problem, janë të gjithë individët e prekur nga astma e ne iu rekomandojmë që të përdorin një çaj me lule bliri, agulice, thundërmushkë, zhumbriçë apo dhe një përzierje kundër kollës. Të sëmurët me astmë duhet të kenë parasysh në stinën e verës se ajri thahet e përqindja e lagështirës së tij bie nën 50%, çka sjell edhe vështirësi në frymëmarrje te këta të sëmurë. Ne do këshillojmë që dyshemeja të laget disa



Mjeku popullor Ylli Merja

herë në ditë, pra të bëhet një pastrim natyral i ajrit brenda ambienteve të shtëpisë. Krahas kësaj rekomandohet

edhe përdorimi i propolisit të bletës, duke konsumuar 10 pika në ditë pasi do të shërbejë si një ngacmues për

të gjithë receptorët (ndikon në tensionin e gjakut, gjëndrat endokrine, zgjeron pulmonet). Propolisi i bletës

Personat më të predispozuar që goditen nga ndryshimet klimaterike janë ata që vuajnë nga reumatizma. Për një kohë të gjatë arteriet e këtyre të sëmurëve fillojnë të dobësohen e kur ulet shtypja atmosferike, venat ngushtohen.

është një fuqizues shumë i mirë i punës dhe anës fiziologjike të organizmit.

### LODHJA DHE KËPUTJA

Ulja e shtypjes atmosferike ndikon në gjithë sistemin tonë të qarkullimit të gjakut e zemra pompon gjak me vështirësi, kështu që në këto raste personat që vuajnë nga tensioni e problemet kardiovaskulare duhet të përdorin bimën e murrizit. Kjo e fundit gjendet pothuajse në të gjitha trevat e Shqipërisë e ndikon në zgjerimin e arterieve, veçanërisht të atyre koronare. Në këtë mënyrë mbrohet zemra e parandalohet infarkti. Ka edhe bimë të tjera si gjethet e ullirit, lëvorja e shelgut, trëndafili, boronica apo çaji kolesterol që forcojnë zemrën. Personat më të predis-

pozuar që goditen nga ndryshimet klimaterike janë ata që vuajnë nga reumatizma. Për një kohë të gjatë arteriet e këtyre të sëmurëve fillojnë të dobësohen e kur ulet shtypja atmosferike, venat ngushtohen. Për të rritur rezistencën e trupit, ky grup të sëmurësh duhet të përdorin pak propolis për të marrë fuqi, si dhe çajin e reumatizmit e vajin e sinapit. Ky i fundit mund të përdoret duke masazhuar kyçet dhe ka vaj dafine, livando në përbërjen e tij.

### PROBLEMET ME TENSIONIN

Të sëmurët me tension mund të përdorin çaj me gjethet ulliri apo boronicë që shërbejnë për normalizimin e qarkullimit të gjakut. Duhet të kushtohet një vëmendje e veçantë pastrimit të trupit nga toksinat në mënyrë që të bëhet detoksifikimi i mëlcisë. Kështu duhet të pini 2 gota ujë në mëngjes dhe një lugë gjelle me vaj ulliri, ndërsa vaji i lirit dhe ai i farës së zezë ka efekte të mrekulueshme për pastrimin dhe forcimin e organizmit. Organizmi fillon të pastrohet dhe mjalti mund të sjellë çlirimin e toksinave, gjithashtu. Por mund të përdoren edhe farat chia, të përziera me mjaltë, e në këtë mënyrë trupi do të fitojë fuqinë e mëparshme brenda 2-3 ditësh. Vlen të theksohet që në momentin e parë që njeriu ndjen këputje apo lodhje mund të nisë të bëjë gjimnastikë edhe në kushte shtëpia apo në natyrë.





Monitorimi i Qëndresës Qytetare zbardh shumat marramendëse për luksin e zyrave

Voltiza Duro

7 institucione të arsimit të lartë në vend do të vihen nën auditimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit për sa i përket menaxhimit të fondeve në universitete. Akuzat për abuzimet me financat kanë ardhur nga monitorimi i kryer në periudhën shtator 2017- qershor 2018, nga organizata Qëndrore Qytetare. Sipas këtij studimi, shpenzimet për kërkimet shkencore në Universitetin e Tiranës, të Durrësit dhe të Elbasanit janë zero. "Të tre universitetet publike janë më larg shkencës dhe më pranë luksit të zyrave. Nuk kanë shpenzuar asnjë vlerë për nënkategorinë e studimeve dhe kërkimeve përgjatë një viti akademik", - thanë përfaqësuesit e Qëndresës Qytetare gjatë takimit me përfaqësueset e KLSH-së. Në monitorim është zbuluar se paratë e tarifave të studentëve dhe të ardhurat nga buxheti i shtetit janë shpenzuar përkatësisht për investimet luksi dhe zyrash.

# Menaxhimi i fondeve, KLSH merr në auditim 7 universitete

## "Investimet për studimet shkencore janë zero"

Kategori/Nënkategori	Universiteti Tiranës	Universiteti i Durrësit "Aleksandër Moisiu"	Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani"
<b>Transferata dhe Subvencione</b>	2,736,813.00	130,826.00	184,691.00
Transferata për projekte	1,470,170.00	130,822.00	153,120.00
Kuota Anëtarësimit	1,266,643.00	0.00	17,771.00
Komisione Bankare	0.00	4.00	13,800.00
<b>Të tjera</b>	45,577,368.00	31,893,022.00	41,982,335.00
Mbështetje e nxënësve të dalluar dhe bursa studimi	0.00	24,005,909.00	41,982,335.00
Shpenzime gjyqësore	45,577,368.00	7,887,113.00	0.00

Faksimilie e raportit mbi shpenzimet financiare



Gjatë takimit të djeshëm mes përfaqësuesve të Qëndresës Qytetare dhe KLSH-se

### RAPORTI I DETAJUAR

Sipas raportit përfundimtar mbi 1 miliardë lekë të vjetra ka shpenzuar Universiteti i Durrësit për rikonstruksione ndërtesash dhe pajisje zyrash, ndërsa Universiteti i Elbasanit ka blerë një automjet pranë kompanisë Hyndai në vlerën 76 milion lekë të vjetra. Më tej në monitorim bëhet me dije se referuar pagesave të faturave për energji elektrike, Universiteti i Tiranës, megjithëse ka në menaxhim më shumë godina funksionale se dy universitetet e tjera, ka shpenzuar 7 herë më pak se ai i Elbasanit dhe 14 herë më pak se universiteti i Durrësit, i cili ka shpenzuar ekzaktesisht 14,341,150 lekë për këtë nënkategori. "Për nënkategorinë Ujë, konsumatori i madh është Universiteti i Elbasanit duke kryer transaksione me vlerë shumë më të madhe se dy universitetet e tjera, 5,456,404 lekë, kundrejt shumës 311,000 lekë të Universitetit të Tiranës dhe 497,052 lekë të Universitetit të Durrësit", - nënvizohet në raport. Ndërkohë drejtori ekzekutiv i Qëndresës Qytetare, Rigels Xhemollari thotë për "Gazeta Shqiptare" se studentët meritojnë një sistem arsimor modern. "Me këto zbulime kërkojmë që të zg-

Sipas raportit, universiteti "Aleksandër Xhuvani" ka kryer një transfertë me vlerë 319,440 lekë me përshkrim fature "1011099 universiteti Aleksandër Xhuvani abonim karte TV, urdhër nr. 304 dt. 22.12.2017", në kategorinë shërbime të printimit dhe publikimit.

jojmë studentët nga apatia që të kërkojnë më shumë llogari nga universiteti i tyre, sepse janë ata që paguajnë tarifën më të larta në Europë dhe familjet e tyre që sakrifikojnë kaq shumë për ta. Ata meritojnë një sistem arsimor modern dhe jo universitetet që i japin vetëm ambiente dhe salla boshe", - u shpreh Xhemollari. Ky i

fundit shtoi se sa më shumë të kërkohet llogari, aq më demokratike do jenë universitetet dhe aq më shumë do të rritet transparenca. Sipas raportit, Universiteti "Aleksandër Xhuvani" ka kryer një transfertë me vlerë 319,440 lekë kundrejt përfituesit "Alban Tirana NACENDO.AL" me përshkrim fature "1011099 Universiteti Aleksandër Xhuvani abonim karte TV urdhër nr 304 dt 22.12.2017 ft nr 393544433" në kategorinë shërbime të printimit dhe publikimit. "Së pari, studentët duhet të informohen se paratë e tyre po shkojnë për një shpenzim luksi për zyrat e drejtuesve siç është abonimi tv, ndërkohë që ambientet universitare nuk kanë internet falas, së dyti kjo vlerë nuk përkon me vlerat reale të tregut të operatorëve dixhitalë dhe së treti, ky transaksion është

### MILIARD LEKË PËR LUKS ZYRASH

Sipas raportit përfundimtar, mbi 1 miliard lekë të vjetra ka shpenzuar universiteti i Durrësit për rikonstruksione ndërtesash dhe pajisje zyrash, ndërsa universiteti i Elbasanit ka blerë një automjet pranë kompanisë 'Hyndai' në vlerën 76 milionë lekë të vjetra.

### RIGELS XHEMOLLARI

"Me këto zbulime kërkojmë që të zgjojmë studentët nga apatia që të kërkojnë më shumë llogari nga universiteti i tyre, sepse janë ata që paguajnë tarifën më të larta në Europë dhe familjet e tyre që sakrifikojnë kaq shumë për ta. Ata meritojnë një sistem arsimor modern dhe jo universitetet që i japin vetëm ambiente dhe salla boshe", - u shpreh Xhemollari.



### SI I MENAXHUAN PARATË UNIVERSITETET?

Të tre universitetet publike janë më larg shkencës dhe më pranë luksit të zyrave. Nuk kanë shpenzuar asnjë vlerë për nënkategorinë e studimeve dhe kërkimeve përgjatë 1 viti akademik. UAMD ka shpenzuar mbi 1 miliardë lekë të vjetra për rikonstruksione ndërtesash dhe pajisje zyrash, ndërsa Universiteti i Elbasanit ka blerë një automjet pranë kompanisë Hyndai në vlerën 76 milion lekë të vjetra, ndërkohë asnjë bibliotekë, laborator apo investim për studentët dhe shkencën.

0 LEK SHKENCA

Kategori/Nënkategori	Universiteti Tiranës	Universiteti i Durrësit "Aleksandër Moisiu"	Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani"
<b>Të ardhurat</b>	1,619,490.00	144,617,713.00	15,746,440.00
Rikonstruksione e ndërtimesh qëndrore	0.00	89,603,603.00	0.00
Pajisje zyrash	0.00	0.00	0.00
Mjetë transporti	0.00	2,742.00	1,202,000.00
Mjetë dhe pajisje teknike	0.00	0.00	0.00
Pajisje zyrash dhe pajisje tjera	0.00	0.00	0.00
Shërbime tjera	0.00	0.00	0.00

Faksimilie e raportit përfundimtar

kategorizuar në një kategori jopërfshirëse siç është ajo e publikimeve", - thuhet në raport. Gjithashtu, nga monitorimi janë evidencuar pagesa të larta që universitetet shpenzojnë për sigurimin e ndërtesave. Universiteti i Tiranës ka shpenzuar vlerën 21,304,490 lekë, Universiteti i Durrësit 10,780,030 lekë dhe Universiteti i Elbasanit 28,001,291 lekë për nënkategorinë "Ruajtja dhe sigurimi i ndërtesave", shërbim i cili nuk justifikon mjaftueshëm shërbimin e sigurimit për

ndërtesën apo për pajisjet që ato kanë, pasi zënë një shumë të konsiderueshme që buron nga tarifën e studentëve apo nga buxheti i shtetit dhe në përshkrimin e faturave shoqërohet me fjalët shërbim roje. Ndërkohë që universitetet paguajnë kaq shtrenjtë shërbimin e rojes, studentët vuajnë pasojat e mungesës së shërbimeve minimale, si kartonët e diplomave, internetit, ngrohjes dhe ftohjes apo për të mos thënë laboratorëve dhe bibliotekave.

Shtet	Maj '17	Maj '18	Niveli i rritjes/ulësimit (%)	Janar Maj '17	Janar Maj '18	Niveli i rritjes/ulësimit (%)
Albania	125,646	96,301	-8.7	420,226	442,098	2.4
Austria	48,891	54,903	12.2	193,506	204,887	5.8
Çeçia	31,925	38,854	22.4	160,598	171,489	7.1
Danimë	22,836	26,260	14.2	98,019	108,353	10.5
Francia	15,473	12,167	-16.2	30,798	32,764	6.4
Germania	38,209	42,825	12.7	142,618	150,766	5.6
Italia	8,657	8,881	2.6	34,9	32,962	-5.7
Spanja	8,181	11,172	36.6	23,245	28,867	24.2
Polonia	11,002	17,768	61.5	27,789	34,724	25.0
Udhë	3,028	3,175	4.8	11,142	10,506	-5.6
Turqi	73,294	84,143	14.8	190,424	200,912	5.2
Udhë	305,092	304,389	-0.2	1,221,474	1,423,307	17.1

Faksimilie e hyrjeve të shtetasve të huaj

## INSTAT: Ja nga cilat shtete po vijnë turistët në Shqipëri

Instituti i Statistikave ka publikuar të dhënat zyrtare të lëvizjes së shtetasve, ku rezultoi se në muajin maj 2018, rritjen më të madhe në përqindje e kanë pasur hyrjet e

shtetasve nga Gjermania, Polonia dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Referuar të dhënave të INSTAT, në maj 2018 hyrjet nga Gjermania u rritën me 61.5%, ato nga Shtetet e

Bashkuara të Amerikës me 36.6% ndërsa ato nga Polonia me 34.9%. Kjo rritje në përqindje konstatohet edhe në rang 5 mujori (janar-maj) krahasuar me të njëjtën peri-

udhë të një viti më parë. Hyrjet e shtetasve nga Gjermania rezultoi se në rang 5 mujori janë rritur me 25%, hyrjet nga Polonia me 34.4% ndërsa hyrjet nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës me 14.7%.

"Shqiptarët përdorin lokalet 'Madam' në Belgjikë, shfrytëzojnë edhe prostitutat"

TIRANË


# "Shqipëria, rruga më e zakonshme e trafikimit ndërkombëtar të kanabisit"

## Raporti i Zyrës së Kombeve të Bashkuara i 2018-ës/Përfshihet edhe në hartën e heroinës

Shqipëria dhe Holanda janë dy vendet më të përmendura për trafikun ndërkombëtar të barit të kanabisit, të ndjekura në distancë nga Çekia. Kjo sipas raportit vjetor të "Drogave" 2018, të sapopublikuar nga UNODC (Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimet). Ndërsa në hartën globale, Shqipëria është e përfshirë në rrugën e trafikimit të heroinës nga Azia, me origjinë nga Afganistani, që kalon përmes Turqisë dhe më pas i drejtohet Europës Perëndimore. Bullgaria është një tjetër shtet që përfshihet në këtë gjurmë. Raporti u referohet zhvillimeve të vitit 2016. Shqipëria dhe Holanda raportuan asgjësimin më të madh të bimëve të kanabisit në Evropë gjatë viteve të fundit (Shqipëria raportoi asgjësimin e 5,205 fushave në vende të hapura me një total prej 2,536,288 bimë kanabis në vitin 2016, ndërsa Holanda njoftoi asgjësimin e 5,856 plantacioneve të brendshme me gjithsej 994,068 bimë të kanabisit), sipas raportit të UNODC. Shqiptarët përmenden edhe për aktivitetin jashtë vendit, ku në Belgjikë, grupe nga Shqipëria përdorin "Zonjat", lokale për të kontrolluar femrat që janë trafikuar për shfrytëzim seksual dhe për t'u siguruar që ato transportojnë drogë. Ky është viti i tretë radhazi që Shqipëria përfshihet në raportin botëror të drogave. Në raportin e vitit 2017, Shqipëria përmendet si një nga vendet kyçe në trafikimin, prodhimin e barit të kanabisit, madje edhe përdorimin e substancave të forta psikotike nga të rinjtë. Shqipëria përmendet gjithashtu si një nga vendet me evidencë të forta në përfshirjen e grupeve të krimtë të organizuar në trafikun e heroinës, kokainës dhe kanabisit.

### TRAFIKU I HEROINËS E KOKAINËS

Ky është viti i tretë radhazi që Shqipëria përfshihet në raportin botëror të drogave. Në raportin e vitit 2017, Shqipëria përmendet si një nga vendet kyçe në trafikimin, prodhimin e barit të kanabisit, madje edhe përdorimin e substancave të forta psikotike nga të rinjtë. Shqipëria përmendet gjithashtu si një nga vendet me evidencë të forta në përfshirjen e grupeve të krimtë të organizuar në trafikun e heroinës, kokainës dhe kanabisit.



ku prodhuesi kryesor mbetet Afganistani. Prodhimi global i kokainës në vitin 2016 arriti nivelin më të lartë ndonjëherë: rreth 1,410 tonë. Pas rënies gjatë periudhës 2005-2013, prodhimi global i kokainës u rrit me 56 për qind gjatë periudhës 2013-2016. Rritja nga 2015 në 2016

ishte 25 për qind.

Pjesa më e madhe e kokainës në botë vjen nga Kolumbia, e cila nxiti prodhimin e saj me shumë se një të tretën nga viti 2015 deri në vitin 2016, në rreth 866 ton. Sipërfaqja totale e kultivimit të bimës së kokainës në mbarë botën në

vitin 2016 ishte 213,000 ha, nga të cilat pothuajse 69 për qind ishte në Kolumbi. Rilindja dramatike e kultivimit të bimëve të kokainës në Kolumbi, e cila pothuajse ishte përgjysmuar nga viti 2000 deri në vitin 2013, erdhi për një numër arsyesh të lidhura me dinamikën e

tregut, strategjitë e organizatave të trafikimit, si dhe një reduktim në ndërhyrjet alternative të zhvillimit dhe në asgjësimin e tyre. Në vitin 2006 u asgjësuan më shumë se 213,000 ha. Dhjetë vjet më vonë, shifra ishte më pak se 18,000 ha. (MARRË NGA "MONITOR")



### Vrasja e biznesmenit Dervishaj, ndalohe një tjetër person

VLORË - Afro 1 muaj nga ekzekutimi i biznesmenit të kafesë në Vlorë, Vasil Dervishaj, policia ka vënë në pranga një tjetër person që ka lidhje me këtë ngjarje. Bëhet fjalë për 28-vjeçarin Donel Sh., banues në qytetin bregdetar. Sipas policisë, ndalimi i të riut është bërë, pasi Gjykata e Shkallës së Parë Vlorë, me vendimin nr:169 të datës 20 qershor 2018, ka vendosur ndaj tij masën e sigurisë "Arrest në burg" për veprën penale "Moskallëzim krimi". 29-vjeçari Dervishaj u vra më 4 qershor në lagjen "Pavarësia". Për ngjarjen u ndaluan 2 persona si bashkëpunëtorë, ndërsa një prej dy autorëve të dyshuar në vrasje u vetëdorëzua. Autori tjetër i dyshuar vijon të jetë në kërkim.

### SHKURT

#### Gjendet dhe sekuestrohet kanabis buzë liqenit

SHKODËR - Një sasi droge është gjendur dhe bregun e liqenit të Shkodrës. Policia raporton se sasia e hashashit, e cila nuk bëhet ende e ditur, është gjetur në vendin e quajtur "Vija e Vrakës" në breg të liqenit (mes Shkodrës dhe Malësisë së Madhe). Nga raportimet e para thuhet se trafikantët e kanë lënë aty drogën për arsye ende të paditura. Një prej dyshimeve është se lenda narkotike e gjetur në breg mund të ketë marrë lagështirë ose mund të ketë rënë nga thasët që po ngarkoheshin. Nuk ka ende persona të dyshuar, ndërsa dyshohet se sasia e hashashit mund të transportohej drejt Malit të Zi.

#### Kapet turisti italian me 380 kg kanabis

SARANDE - Policia e Sarandës ka bllokuar në Qafën e Gjashtë një autokamper, i cili drejtohej nga një turist italian. Nisur nga dyshimet, agjentët bënë shoqërimin e automjetit në pikën kufitare të Kakavijës për ta kaluar në skaner. Pas verifikimeve, rezultoi se në tavanin e autokamperit ishin fshesur plot 383 kg kanabis, si dhe 96 kg formë çokollate. Policia ka vënë në pranga italianin Vito Baruceli. Blutë po punojnë për zbardhjen e plotë të ngjarjes.

## Sezoni turistik, patrullime të përbashkëta nga Policia e Shtetit dhe Policia e Kosovës



Takimi i krerëve të policive në Lezhë

**LEZHË** - Marrja e masave për mbarëvajtjen e sezonit turistik që tashmë ka filluar ka bërë bashkë në Lezhë, krerët e Policive të Shqipërisë dhe Kosovës. Drejtori i Policisë së Shtetit, Ardi Veliu dhe drejtori i Policisë së Kosovës, Naim Rexha nënshkruan dje Memorandumin e Bashkëpunimit "Për organizimin e shërbimeve të përbashkëta të policimit rrugor mes Policisë së Kosovës dhe Policisë së Shtetit Shqiptar, në territorin e Republikës së Shqipërisë", gjatë sezonit turistik 2018. Ky memorandum ka qëllim vendosjen e bashkëpunimit konkret për parandalimin e shkeljeve administrative në fushën e trafikut rrugor, uljen e numrit të ngjarjeve rrugore dhe zbatimin me rigorozitet të legjislacionit rrugor për krijimin e një mjedisi më të sigurt për të gjithë qytetarët dhe përdoruesit e rrugës, që qarkullojnë në akset rrugore, që lidhin dy vendet. Në një prononcim të përbashkët për mediat, pas nënshkrimit të memo-

randumit, kreu i Policisë së Shtetit, Ardi Veliu, tha: "Sot (dje), së bashku me drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Kosovës nënshkruam memorandumin e bashkëpunimit për sezonin turistik ku si edhe në vitet e tjera, shërbimi policor i Kosovës do të jetë prezent së

bashku me shërbimet e Policisë së Shtetit për sigurimin e akteve rrugore, njëkohësisht edhe disa zonave turistike, të cilat frekuentohen masivisht nga shtetasit kosovar. Gjej rastin që të falënderoj drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Kosovës, njëkohësisht dhe Policinë e

Kosovës për kontributin që është duke dhënë në drejtim të sigurimit dhe mbarëvajtjes të sezonit turistik në vendin tonë". Nga ana e tij, kreu i Policisë së Kosovës, Naim Rexha, shprehu angazhimin për të mundësuar mbarëvajtjen e këtij sezoni turistik. "Me këtë rast dëshiroj të potencoj që qëllimin e kahershëm, të njëjtë me angazhimet tona të përbashkëta, po e begatog me modalitetet e reja të ofrimit të shërbimeve të sigurisë në trafikun rrugor dhe jo vetëm në trafikun rrugor, si hallkë e re shtesë të zinxhirit të gjatë të bashkëpunimit tonë të përbashkët me një model shtesë jashtëzakonisht të rëndësishëm të zvogëlimit të fataliteteve gjatë qarkullimit në rrugët publike si pasojë e aksidenteve të trafikut dhe ofrimit sa më të mirë të shërbimeve të trafikut të dy policive respektive, brenda afatëve kohore me fokus të veçantë në mbulimin e tërë sezonit veror", tha ndër të tjera, Naim Rexha.



"Shqiptarët dhe ukrainasit janë shkelësit kryesorë të kapur në Britani"

# "Daily Mail": Si blemë për 3 ditë një kartë identiteti italiane në Tiranë

"Pasaportën false e siguroam për 800 paund"

BRITANI

Gazeta britanike "Daily Mail" ka investuar si mund të marrësh një mjet identifikimi të një prej vendeve të BE-së në Shqipëri për të hyrë me pas në Mbretërinë e Bashkuar. E përditshmja britanike shkruan se mjaftojnë tri ditë pas porosisë për t'u pajisur me një kartë të falsifikuar. Për 800 paund, reporterja ka mundur të sigurojë një dokument identiteti italian të falsifikuar nga një shqiptar, dokument i cili mund të përdoret për të kaluar kontrolin kufitar në Britani. Për një shumë prej 250 paund, gazeta shkruan se është siguruar një kartë identiteti shëndetësore italiane, e cila, gjithashtu, u lejon emigrantëve qasje në disa shërbime HNS. Hetimi i "Daily Mail" vjen pas shqetësimit në rritje rreth përhapjes së ID-ve të rreme evropiane, të cilat janë përdorur nga xhihadistët, përdhunuesit, hajdutët dhe mashtruesit. Gazeta kujton se Fatmira Tafa u burgos për 14 muaj në prill për përdorimin e një ID të rreme greke për të përfituruar një transplantim të veshkave që kushton më shumë se 72 mijë paund. Edhe terroristët e Shtetit Islamik pas mizorive të



Tirana

Parisit dhe Brukselit përdorën, gjithashtu, kartat identiteti të falsifikuara të "cilësisë së lartë" të BE për të udhëtuar lirshëm rreth kontinentit duke planifikuar masakrën e tyre. Agjencia kufitare e BE Frontex tha se më shumë se 7,000 njerëz janë zbuluar duke u përpjekur të hyjnë në BE, duke përdorur

mjeteve identifikimi të falsifikuara në vitin 2016, shumica e të cilëve janë përpjekur të hyjnë në Britani të Madhe. "Daily Mail" shkruan se shtetasit shqiptarë dhe ukrainas që përdorin kartat identiteti të rreme italiane dhe greke janë shkelësit kryesorë të kapur në kufijtë e Mbretërisë së Bashkuar.

INVESTIGIMI

E përditshmja britanike "Daily Mail", në shkrimin e saj investigativ shkruan se reporterja e tyre arriti të kontaktojë në Tiranë me një person që i siguroi mjet identifikimi fals. "Në kryeqytetin shqiptar, reporterja jonë kontaktoi me një falsifikator nëpërmjet një ndërmjetësi dhe brenda 72 orëve arriti të merret një ID italiane false", - citohej në shkrim.

## Operacioni antidrogë, arrestohen 24 persona, mes tyre edhe shqiptarë

GREQI - Policia greke ka zhvilluar një tjetër operacion në Serres dhe Selanik ku ka sekuestruar rreth 58 kg e 523 gr marijuanë. Sipas mediave të vendit fqinj, janë arrestuar 24 persona, shumica grekë por edhe shqiptarë si pjesë e një grupi kriminal në fushën e trafikut të drogës. Mësohet se lënda narkotike ishte e ndarë në 77 pako, 50 prej të cilave u gjetën në një automjet dhe 27 gjatë kontrolleve të benseave. Gjatë operacionit u sekuestruan 1 pistoletë, 6 fishekë, 3 peshore elektronike, 12.125 euro, 8 makina, 25 celularë etj. Që prej fillimit të vitit e deri tani, në Igumenicë, Janinë, Athinë, Selanik, Artë, Kostur e Follorinë, policia greke ka sekuestruar rreth 5.6 tonë marijuanë që vinte nga Shqipëria.



## Përleshje në Athinë, vritet me thikë 26-vjeçari shqiptar

GREQI - Një shqiptar ka humbur jetën tragjikisht në kryeqytetin e Greqisë, pasi është goditur me thikë nga persona ende të paidentifikuar. Mësohet se ngjarja ka ndodhur pas një shërri, në orët e para të ditës së djeshme në lagjen "Peristeri" të Athinës, ndërsa viktimë mbeti 26-vjeçari shqiptar, identiteti i të cilit nuk bëhet me dije. Sipas mediave greke, i riu shqiptar nuk ka mundur t'u rezistojë plagëve të marra dhe ka ndërruar jetë rrugës për në spital. Ndërkaq, policia e vendit fqinj po heton për zbardhjen e plotë të kësaj ngjarjeje.



Implemented by **giz** Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

### OPEN CALL FOR TENDER PREQUALIFICATION

#### 1. GENERAL CONDITIONS

**1.1 Requester:** Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit GmbH (GIZ), Office Tirana, Rr. Skenderbej No. 21/1

**1.2 Profile:** The Programme "Customer Oriented Drinking Water and Sanitation Services" is implemented by the Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit GmbH (GIZ) on behalf of the German Federal Ministry of Economic Cooperation and Development (BMZ). The objective of the programme is to support the partners at central and local level in the implementation of the water sector reforms. At local level the programme supports three partner municipalities and their water utilities in the improvement of drinking water and sanitation services, especially performance orientation, accountability and in customer orientation.

**1.3 Subject:** The Government of Albania has started a reform on water supply and sewerage sector aiming to improve the service to the citizens, to enhance the water supply continuity and to shift the sector towards better performing.

The Government of Albania aims to expand access to and enhance the quality of water supply and sewerage services for the entire population of Albania. The ultimate aim is to provide piped water supply to all people and to provide wastewater services to protect human health and minimize negative environmental impacts. This aim will be achieved taking into account the overall policy framework:

- Government sector policies operate within a macro-economic framework that limits overall public debt and is based on sound macro-economic policies.
- The Government will give emphasis to the need to protect the poor and vulnerable inter alia by ensuring that their utility bills are within international norms for affordability.

- Albania is an EU candidate country and Government sector policies are designed with the adherence to the EU environmental acquis in mind.

Within the context of the above Background Information, the Government of Albania is seeking to retain the services of a Consultancy with proven experience in the development of water sector strategic documents, that would assist the Government to:

- Prepare twelve (12) year water supply and sewerage services sector strategy, to include an implementation monitoring mechanism.
- Recommend appropriate initiatives and procedures to support the water supply and sewerage services sector reform effort.
- Recommend and quantify the effort needed, at the national and utility level, to ensure that a capable work force is being prepared to assume operational and maintenance responsibility that will be needed to protect the assets being created under the sector capital investment program.

GIZ now invites eligible national consulting companies to indicate their interest in providing the required Services. Interested Consultants should provide information demonstrating that they have the required qualifications and relevant experience to perform the Services.

- 1.4 Eligibility:** Participation is open to all eligible national consulting companies (participating either individually or in a grouping — consortium — of tenderers) which are effectively established in Albania.

All legal entities interested in the application process should ask for application forms to the address: [giz-albanien@giz.de](mailto:giz-albanien@giz.de)

- 2. The due date** for submitting the application is **06.07.2018**. The documents should be submitted in a sealed envelope, marked "Application for prequalification: **National Water Supply and Sewerage Services Sector Strategy for Albania 2018-2030**" to:

**Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ)  
Office Tirana, Rr. Skenderbej No. 21/1, Tirane**

After the due date for submitting the application, the process of prequalification will follow. The submitted applications will be evaluated and only prequalified candidates will be invited to answer the bid. All written communication for this procedure and the following successful ones must be in English.

# TURIZMI SUPER-RESORTI

“Apollo” dhe “Der Turistik” janë operatorët që sjellin pa ndalur çarterat me turistët nordikë

## Turistët elitare, gjithmonë e më shumë në Shqipëri: “Prestige Resort”, nga më të mirët Golemi, “Hirushja” e bregdetit shqiptar këtë verë

**T**uristët nordikë vijnë në “pushtojnë” bregdetin shqiptar. Mirëseardhjen ia uron më së miri “Prestige Resort” në zemër të Golemit. “Apollo” dhe “Der Turistik”, operatorët që sjellin pa ndalur çarterat me turistët nordikë, shprehen në “News 24” se rezervimet bëhen në avancë e duhet të jesh fatlum të gesh një dhomë të pazezruar, ndërsa i bëjnë apel shtetit për të vënë më shumë dorë në infrastrukturë. Me ta biseduam gazetarët, Eric Kaçori dhe Marsela Karapanço.

### INTERVISTA

**Gazetarja:** Si nisi ky sezon?  
Ilda Kasa: Faleminderit për ftesën! Mund të them se sezoni ka nisur dhe është në pikun e tij, pasi kemi nisur që më 11 maj. Kanë ardhur çarterat e parë dhe jemi në operacion të plotë. Turistët vijnë aktualisht nga vendet nordike. Por, “Der Turistik” nuk na sjell veç nordikë, por edhe polakë e çekë dhe së shpejti edhe hungarezë, pse jo edhe gjermanë.

**Gazetarja:** Cilën pjesë të bregdetit shqiptar zgjedhin për të pushuar?  
Kasa: Tashmë operacioni ka nisur nga Saranda në Durrës, Himarë dhe Dhërmi. Pothuajse në të gjithë bregdetin shqiptar, me perspektive për t’u zhvilluar më tej.

**Gazetarja:** Zoti Hartman, ku është e fokusuar kryesisht kompania juaj “Der Turistik”?  
Soren Hartman: Kompania jonë është e fokusuar tek turizmi, por është pjesë e një grupi të madh, është nën ombrellën e grupi REWE, një kompani gjigante ku janë të punësuar shumë njerëz, treqind e pesëdhjetë mijë të punësuar, ku fokusi kryesor i saj janë supermarketet, ndërsa fokusi i dytë janë aktivitetet e turizmit në të gjithë Evropën.

**Gazetarja:** A mund të na thoni diçka për publikun shqiptar. Për shembull, përse zgjedhët vendin tonë?  
Hartman: Po është shumë e thjeshtë, disa nga kolegjët tanë, veçanërisht ata në vendet veriore të Evropës ishin shumë të interesuar për Shqipërinë, sepse kanë besim se e sa i fuqishëm mund të jetë turizmi për të ardhmen këtu



dhe për mua ishte e rëndësishme që ta shikoj nga afër, në mënyrë që të mund të sjellë turistë gjermanë, britanikë apo francezë gjithashtu këtu në Shqipëri.

**Gazetarja:** Kur themi turistë gjermanë kemi parasysh Majorkën apo Ibiza. A mendoni se Shqipëria po bëhet një destinacion për turistët gjermanë?  
Hartman: Padyshim që po. Shqipëria e ka këtë shans. Nëse vendi do të vazhdojë të zhvillohet, do kemi shumë turistë. Ju arrini që të tërhiqni një pjesë turistësh që mund të vijnë nga Gjermania. Ju kemi rinovuar apo edhe ndërtuar hotele të reja që mund të tërheqin turistë gjermanë, por për të arritur maksimumin nevojitet pak më shumë, nevojiten fluturime të plota çarter nga Gjermania, duhet më shumë sa i përket rregullimit të imazhit të vendit, sepse imazhi është ende si në Gjermani, ashtu edhe në Britaninë e Madhe, jo aq i mirë sa duhet të ishte sepse ka pasur shumë ndryshime në të kaluarën dhe sigurisht që ju nevojiten partnerët të mirë për të kryer atë që njihet PR, apo marketing, që nevojitet të bëhet në mënyrë që Shqipëria të shndërrohet në një destinacion të ri për gjermanët, sepse në fund të fundit duhet të kuptojmë se Shqipëria është një vend shumë i afërt. Shqipëria nuk ka qenë kurrë një vend i largët. Turistët tanë shkojnë deri në Republikën Dënenikane apo Oqeanin Indian dhe për të qenë të sigurtë, ka ardhur koha për të zhvilluar një vend si Shqipëria sepse është i rrethuar nga vende të mrekullueshme turistike si Turqia, Greqia, Italia apo Kroacia apo së fundmi edhe Mali i Zi. Nuk ka asnjë dyshim që ky bregdet do të

**“DER TURISTIK”**  
Soren Hartman: “Kompania jonë është e fokusuar tek turizmi, por është pjesë e një grupi të madh, është nën ombrellën e grupi REWE, një kompani gjigante ku janë të punësuar shumë njerëz, treqind e pesëdhjetë mijë të punësuar, ku fokusi kryesor i saj janë supermarketet, ndërsa fokusi i dytë janë aktivitetet e turizmit në të gjithë Evropën”.

tërheqë shumë turistë gjermanë edhe për shkak të afërsisë.

**Gazetarja:** Kjo është hera juaj e parë në Shqipëri?  
Hartman: Absolutisht që po. Për të qenë i sigurtë, jam i lumtur që vizitoj Shqipërinë për të parë bukuritë e këtij vendi. Shqipëria ka ndryshuar shumë dhe jam i trishtuar që ndryshimet kam ndodhur kaq vonë, sepse jemi në vitin 2018 dhe vende si Greqia apo Kroacia janë zhvilluar në sektorin e turizmit që 30 apo 40 vjet më parë dhe janë shumë të suksesshëm në këtë



punë për të bërë, por do ta kryejmë atë. Jam absolutisht e bindur.

**Gazetarja:** Po njerëzit? Si ju duket populli shqiptar?  
Nina Hornewal: Janë shumë miqësorë, me shumë energji dhe shumë mendjehapur. Të dëgjojnë, kërkojnë këshilla, dëshirojnë të mësojnë dhe të zhvillohen. Pra, jam shumë optimiste për popullin shqiptar dhe për të gjithë vendin tuaj.

**Gazetarja:** Ju jeni pjesërisht greke. A shikoni ngjashmëri mes Shqipërisë dhe Greqisë, duke qenë se jemi edhe vende fqinje? A mendoni se Shqipëria mund të jetë një alternative për turistët që nuk duan të shpenzojnë shumë në vende të tjera, por të paguajnë më pak në Shqipëri?  
Nina Hornewal: Në Greqi kemi një shprehje, ‘una faccia, una razia’. Nuk ka shumë ndryshime mes dy vendeve. Sigurisht që ka dallime për shkak të historisë së dy vendeve, por shikoj shumë ngjashmëri dhe nuk mendoj se ka shumë sfida sa i përket komunikimit. Dhe për t’u përgjigjur pyetjes tuaj të dytë, po Shqipëria për ne është bërë tashmë një alternative, pjesë e klientelës sonë. Ne operojmë në Sarandë prej pesë vjetësh. Pra, e nisëm në Tiranë dhe Durrës, më pas Dhërmi e Himarë. Saranda është një arenë e vjetër për “Apollon”.

**Gazetarja:** Interesante. Kam një pyetje për zotin Larson. Kemi lexuar shumë për agjencinë “Apollo”, është agjencia juaj. Si nisi bashkëpunimi juaj me Shqipërinë?  
Larson: Në fakt u rrit në Sarandë, ashtu siç tha edhe Nina. Nisëm të shikojmë një dritare mundësisht kur dërguam njerëz në Korfuz dhe tanë, më shumë se 30 për qind e klientëve tanë kryejnë një vizitë me anije në Sarandë. Pra, është duke u shndërruar në një alternativë shumë të madhe për Greqinë. Na pëlqeu shumë ajo çfarë pamë në Sarandë duke bërë që të zhvillojmë biznesin për pesë vjet atje. Kjo na bëri që këtë vit të vijnë klientë edhe në Durrës dhe siç e tha edhe Nina, ky sezon ka nisur shumë mirë në Shqipëri.

**Gazetarja:** Por, a shikoni pengesa? Ka gjithmonë pengesa kur nis një aktivitet në një vend të ri, por unë shikoj më shumë mundësi, në fakt shikoj shumë shanse,

veçanërisht në bregdet dhe duhet ta zhvillojmë këtë për të ardhmen. Pra, unë zgjedh që të shikoj mundësitë dhe jo pengesat.

**Gazetarja:** Si bashkëpunoni me kompanitë shqiptare? Dimë që po bashkëpunoni me “Prestige Resort”, një nga resortet më të mëdha në Shqipëri, i cili ndodhet në Golem. Fillimisht si dëgjua për “Prestige Resort”?  
Larson: Kemi kontratë me agjencitë turistike, kemi partnerë që gjithashtu gjëjnë hotele më të mira për ne dhe përmes tyre mësuam rreth “Prestige Resort” dhe rezultoi të ishte një nga resortet më të mira që pamë. Jam i sigurt që deri vitin tjetër do të jetë resorti numër një në Shqipëri.

**Gazetarja:** Si vijnë turistët në Shqipëri për të rezervuar hotele? Ju jeni kreu i agjencisë “Happy Tours”. Pra, unë vetëm i pres të ftuarit, por ata e organizojnë, ata ndërmarrin rrezikun. Ata merren me çështjen e pagesave dhe pjesën tjetër. Ata merren me fluturimet çarter. Ata organizojnë gjithçka, ndërsa ne bëjmë pjesën tonë.

**Gazetarja:** Me kompaninë tuaj...  
Ilda Kasa: Ata vijnë përmes agjencisë “Apollo”. Unë i mirëpres këtu. Jam si ‘network’ për “Apollon”. Pra, unë vetëm i pres të ftuarit, por ata e organizojnë, ata ndërmarrin rrezikun. Ata merren me çështjen e pagesave dhe pjesën tjetër. Ata merren me fluturimet çarter. Ata organizojnë gjithçka, ndërsa ne bëjmë pjesën tonë.

**Gazetarja:** Perse e quani një rrezik të madh?  
Ilda Kasa: Por është një rrezik i madh, sepse ata paguajnë para në avancë, që do të thotë bllokim i pronave, të paguash paratë përpara, të paguash fluturimet me çarter, të paguash reklamën, të kryesh shumë inspektime duke ardhur këtu, sepse është e vërtetë që Shqipëria është një vend i këndshëm dhe i bukur dhe jemi krenarë për vendin tonë, por kemi të dyja anët e medaljes: kemi të mirën për të cilën jemi krenarë, por kemi gjithashtu shumë gjëra për të përmirësuar dhe për të bërë.

**Gazetarja:** Për shembull?  
Ilda Kasa: Për shembull, infrastruktura pikë së





pari. Pastërtia, siguria dhe shëndetësia, ushqimet dhe pijet. Pra, janë shumë gjëra për t'u bërë. Ne jemi një vend i ri sa i përket turizmit, nuk kemi traditë në këtë sektor dhe mendoj se e dimë të gjithë këtë. Gjithçka që kemi bërë gjatë këtyre viteve është se kemi parë, kemi mësuar dhe më pas i kemi hyre punës. Sof kemi mbështetjen e këtyre emrave të mëdhenj, brenda të rëndësishme për të cilët jemi të nderuar t'i kemi këtu, sepse po bëjnë një reklamë të jashtëzakonshme për Shqipërinë. Po bëjnë të njohur emrin e Shqipërisë, jo vetëm të "Prestigj Resort", por për të gjithë hotelet ata po bëjnë një reklamë fantastike. Ata gjithashtu po ndihmojnë shumë sa i përket stafit dhe menaxhimit, që është një suport fantastik.

**Gazetari:** Kam një pyetje për zotin Larson. Si ju duket kushtet në hotelet shqiptare dhe veçanërisht në "Prestigj Hotel"?

**Larson:** Në fakt, me rëndësi është ajo që na thotë klientët tanë.

**Gazetari:** Cila është përshypja e tyre?

**Larson:** Përshypja e tyre është shumë pozitive. Klientët tanë japin nota shumë të larta. Ata vlerësojnë shërbimin, ushqimin dhe gjithçka tjetër me nota shumë të larta. Ngrohtësia e njerëzve gjithashtu është për t'u vlerësuar. Për ne ka qenë një surprizë shumë pozitive nga përshypjet që kemi marrë nga klientët.

**Gazetari:** Çfarë ofron ky resort për turistët që ju sillni këtu?

**Larson:** Pikë së pari, ofron cilësi shumë të mirë, akomodim të shkëlqyer, ushqim shumë të mirë dhe është buzë detit, që është një mrekulli.

**Gazetari:** Si ju është dukur ushqimi shqiptar?

**Larson:** Më pëlgen ushqimi shqiptar. Është si ushqimi grek apo kroat, por më pëlgen shumë peshku këtu, apo frutat e detit. Cilësia është e mirë.

**Gazetari:** Sa u përket udhëtimeve me çarter, a mund të themi se kemi turistë më cilësorë në Shqipëri? Pra, a kemi turistë që shpenzojnë shumë para këtu? Turistë që rrinë më shumë se dy tri ditë në Shqipëri? A kemi turistë që qëndrojnë këtu një javë, apo turistë që kthehen këtu?

**Ilda Kasa:** Sigurisht.

**KESHILLA PER KLIENTET**

Nina Horneval:  
"Këshillë për klientët? Shpresoj që ata të bëjnë siç tha zonja Kasa në fillim, që të mos rrinë gjithë ditën në pishinë apo plazh, por të vizitojnë edhe kryeqytetin, të shkojnë në Krutë, të vizitojnë malet dhe të përpiqen që të eksplorojnë vendin, sepse është i bukur dhe interesant".

"Shpenzojnë shumë" është një shprehje e madhe.

**Gazetari:** Nga cila shumë fillon?

**Ilda Kasa:** Së pari, ata nuk qëndrojnë një, dy apo tri net. Minimumi qëndrojnë shtatë ditë, por ndonjëherë qëndrojnë edhe dy javë. Ndonjëherë qëndrojnë dhjetë ditë. Ndonjëherë edhe 28 ditë. Kemi pasur vizitorë që kanë ardhur në maj dhe kanë rezervuar për të ardhur edhe në shtator. Mund të duket e çuditshme, por është e vërtetë. Sa i përket shpenzimit të parave, gjithçka është e organizuar, sepse këta zotërij dhe kompanitë që ata përfaqësojnë sjellin me vete edhe stafin e tyre në Shqipëri. Në Sarandë, në Durrës dhe në të gjitha destinacionet e tjera. Ata kanë ekipe shumë profesionale që në bashkëpunim me ne bëjnë këtë punë. Ata organizojnë ekskursionet. Sigurisht që turistët vijnë për diellin, detin dhe ushqimin, por kjo nuk është mjaftueshëm. Sigurisht që ka edhe dëmbelë që duan të qëndrojnë gjithë ditën në plazh, duke ngrënë...

**Gazetari:** Unë jam një prej tyre...

**Ilda Kasa:** Por ka edhe njerëz që duan të eksplorojnë destinacione të reja. Kjo për shkak se kemi qenë një vend i mbyllur ndaj botës. Për këtë arsye janë të interesuar që të vizitojnë edhe Krutën apo Tiranën. Në këtë mënyrë, ata vizitojnë edhe muzeumet.

**Gazetari:** Bëhen udhëtime të organizuara?

**Ilda Kasa:** Sigurisht që të organizuara. Ata gjithashtu bëjnë suvenirë. Hanë drekë atje. Pra, kjo është e mirë edhe për Tiranën dhe Krutën,

sepse paratë shkojnë atje. Ata gjithashtu shkojnë në Durrës, vizitojnë amfiteatrin, muzeumin arkeologjik, vizitojnë qytetin dhe shpenzojnë para edhe atje, sepse blejnë konjakun e famshëm që kemi. Më pas ata shkojnë në Berat. Jemi krenarë për këtë qytet.

**Gazetari:** Po, është një qytet i bukur.

**Ilda Kasa:** Pra, edhe në Berat shkojnë paratë e turistëve. Më pas shkojnë në veri, në alpet e vendit tone. Ata bëjnë xhip safari. Ata bëjnë kaq shumë aktivitete dhe nuk qëndrojnë gjithë ditën në hotel. Pra, nuk paguajnë vetëm paketën për kompanitë, por janë duke shpenzuar shumë para në vend, duke pasur parasysh çmimet tona dhe ato që ne ofrojmë.

**Gazetari:** Nga sa fillon kjo shumë?

**Ilda Kasa:** Në ditë? Nuk mund ta llogaris këtu sesa shpenzojnë, por duke u bazuar të çmimet që kemi ne, mund të jenë 100 euro për person. Mund të jenë edhe më pak.

**Gazetari:** A ka turistë që kthehen në Shqipëri?

**Ilda Kasa:** Sigurisht që kthehen. Kemi katër vjet që punojmë me udhëtimet çarter. Sigurisht që nuk mund të kënaqim 100 për qind, është pamundur sepse kjo nuk ndodh as në destinacionet më të mira, por ka njerëz që kthehen, por gjithmonë janë njerëz që mendojnë pozitivisht dhe japin ide që kanë të bëjnë transportin publik apo dobësitë, të cilat ne i dimë që i kemi.

**Gazetari:** Zoti Hartman, kam një pyetje për ju. Kemi parë turistë gjermanë, të cilët qëndrojnë në resorte në Turqi apo Greqi për gjatë gjithë vitit. Është ndoshta më e lirë për ata sesa të paguajnë taksat apo gazin në vendin e tyre apo të përballen me kushtet e motit në vendet e tyre ku është ftohtë dhe ku mungon dielli. A e shikoni perspektivën e këtyre turistëve edhe në Shqipëri?

**Hartman:** Është një rrugë e gjatë për këtë. Për momentin keni një sezon shumë të shkurtër në Shqipëri po ta krahasosh me Greqinë apo në veçanti me Turqinë, Egjiptin apo Tunizin, ku sezonet janë shumë të gjata. Është e vërtetë që është më lirë sesa të qëndros në shtëpi, për këtë arsye gjermanët qëndrojnë gjatë gjithë vitit në Tunizi apo në Turqi. Së dyti, duhet të keni produktin e duhur. Pra, nuk duhen vetëm plazhet, sepse në dimër nuk mund të futesh në det, por duhen edhe ambiente të mëdha relaksimi SPA, ambiente sportive, apo oferta ekskursionesh.

**Gazetari:** Mund t'i gjeni këto në "Prestigj Resort" në fakt.

**Hartman:** E vërtetë, por nevojiten edhe dyqanet e hapura, nevojitet infrastruktura që do të thotë shumë investime. Qëllimi kryesor në Shqipëri duhet të jetë që të zgjatet sezoni, sepse moti është i mirë, më pas të investohet në akomodim, që

të këtë oferta të mira gjatë dimrit dhe më pas do të vijë edhe dita kur resortet të jenë të shfrytëzueshme 365 ditët e vitit. Por është një rrugë e gjatë deri atje. Gjithmonë duhet të shikoni se jeni në konkurrencë të fortë me të tjerët. Ne kemi miliona klientë, por asnjëri prej tyre që udhëton dhjetë herë në Majorjka nuk bën më ekskursione atje sepse, e kanë vizituar aq shumë atë vend dhe ky atraksion i përket Shqipërisë, sepse është destinacion i ri, njerëzit do të interesoheshin për historinë e këtij vendi, për kulturën që kemi këtu, të interesuar për ushqimin shqiptar, ndërsa nga ana tjetër do të vijnë këtu për shkak të hotelit. Edhe ky produkt duhet të jetë konkurrues që turistët të kthehen sërish. Kemi parë zhvillime shumë të mira, por nuk është ende volumi për të cilin ne kemi nevojë që të kemi më shumë turistë nga Gjermania. Pra, ka ende shumë punë për t'u bërë.

**Gazetari:** A keni një numër turistësh që kanë ardhur në Shqipëri?

**Hartman:** Po, janë rreth 40 mijë klientë nga vendet nordike. Nga Europa Lindore kemi pasur rreth 5 mijë deri në 10 mijë klientë. Kemi turistë nga Gjermania, le të themi rreth 1 mijë të tillë. Por nëse e krahasoni këtë me destinacionet e tjera, është shumë i vogël. Nuk është aty ku do të duhej të ishte.

**Gazetari:** Çfarë mund të përmirësojmë për të rritur numrin e turistëve?

**Gazetari:** Na jepni disa sugjerime.

**Hartman:** Ka disa. Një pjesë e dëgjuar tashmë, cilësia duhet të jetë e mirë, siguria dhe shëndetësia është me shumë rëndësi. Qëndrueshmëria, të krijojmë destinacione ku mund të shkojë me një ndjesi të mirë. Kjo është me shumë rëndësi. Nëse ju pëlqen ambienti që ju rrethon, kjo ka shumë rëndësi për njerëzit. Gjithashtu, me shumë rëndësi është imazhi. Për shkak se ndryshimet kanë qenë të shpejta, ndryshimi i imazhit do kohën e veti. Ende në Evropën Perëndimore njerëzit kanë ide të ndryshme për atë çfarë përfaqëson Shqipëria. Në fakt, Shqipëria është një vend i bukur, me plazhe të bukura dhe shumë i hapur, por ndryshimi i imazhit kërkohet. Për këtë luajnë rol edhe ambasadorët tuaj jashtë vendit. Në fakt, çdo klient i ynë është një ambasador për Shqipërinë, sepse kur kthehen në shtëpinë e tyre të kënaqur nga pushimet, ata e transmetojnë këtë ndjesi tek të tjerët. Do t'i këshillojmë edhe të tjerët që të shkojnë në Shqipëri sepse është një vend i këndshëm, ndoshta një vend për të cilin askush nuk kishte menduar më parë. Është çmenduri sepse jemi kaq afër, por Shqipëria nuk njihet shumë, prandaj duhet të punojmë në këtë drejtim.

**Gazetari:** Cfarë thonë në përgjithësi klientët që vizitojnë Shqipërinë?

**Hartman:** Në fakt, nuk kemi pasur shumë turistë gjermanë, por ata njerëz që e kanë eksploruar një herë këtë vend, ndoshta edhe me çanta shpine, kthehen me Gjermani dhe tregojnë histori shumë të bukura për Shqipërinë, por numri i turistëve është i vogël. Ajo që duhet të bëjmë, në Gjermani kemi mbi 2000 dyqane ku reklamohen udhëtimet. Këta njerëz që punojnë në këto dyqane duhet të rekomandojnë Shqipërinë tek turistët, sepse askush nuk vjen tek zyrat për të kërkuar informacion mbi Shqipërinë. Ajo që duhet të bëjmë është që ta rekomandojmë Shqipërinë në çdo moment. Nëse dikush vjen dhe kërkon informacion mbi Majorjka, ne u themi atyre, që shikoni se kemi edhe këtë destinacion tjetër. Durrësin, një qytet me mot të bukur, plazh shumë të mirë dhe për momentin edhe më lirë. Kjo gjë ka të bëjë edhe me besimin. Pra, duhet t'i bindim klientët tanë se pushimet e tyre në Shqipëri do të jenë të bukura. Pra, nevojitet të rritet besimi. Së dyti, ne po shesim shumë produkte "online" dhe Shqipërinë duhet ta rekomandojmë edhe përmes internetit.

**Gazetari:** Mendoni se çmimet në Shqipëri janë diçka pozitive për të tërhequr turistë? Pra, janë këto çmime më të lira se në vendet e tjera të Mesdheut?

**Hartman:** Për momentin është një çmim i mirë. Nuk dua të them çmim i lirë apo çmim i shtrenjtë...

**Gazetari:** Krahasuar me atë çfarë marrin si shërbim?

**Hartman:** Po, cilësia është e mirë dhe e marrin në një çmim të arsyeshëm. Në këtë mënyrë tërheq familjet për të ardhur këtu. Kur klientët kthehen në shtëpi të kënaqur, sigurisht që herën tjetër janë të gatshëm të paguajnë më shumë. Pastaj vjen momenti kur njerëzit vijnë te agjencitë e udhëtimit dhe pyesin për Shqipërinë. Këtë pikë do ta arrijmë nëse ofrojmë cilësi dhe njerëzit shprehin të kënaqur duke ia rekomanduar edhe njëri-tjetrit.

**Gazetari:** Zoti Larson, kemi folur për plazhet. Ç'mund të themi për turizmin malor? A ka njerëz që duan të vizitojnë malet e bukura të Shqipërisë?

**Larson:** Po, për këtë duhet më shumë kohë. Turistët e huaj kryesisht vijnë për plazhet. Mund ta shikojmë në rajonin e Pargës, që është shumë pranë Sarandës, ku në fillim u zhvillua turizmi detar dhe tashmë po zhvillohet turizmi malor. Padyshim që edhe turizmi malor ka një treg të zhvilluar, por numri i turistëve është më i vogël. Për të ardhur në Shqipëri duhen çarterat dhe për të pasur çarterat nevojitet volumi i turistëve. Duke zhvilluar turizmin detar, më pas zhvillojmë edhe turizmin malor ku me pas ndërtohen ambiente sportive, apo për hajking.

**Gazetari:** Çfarë mund të themi për rezervimet e hoteleve. A janë tashmë të rezervuara ato? A keni një listë të tyre?

**Ilda Kasa:** Sigurisht që i kemi ato. Ata punojnë në avancë dhe sigurisht që ata kanë politikat e tyre. Ata bëjnë atë që njihet si PR, kanë ekskluzivitetin e rezervimeve të hershme. Kjo

është politika e kompanisë. Të gjithë avionët çarter vijnë të mbushur plot.

**Larson:** Pra, ne marrin garanci për numrin e dhomave të hoteleve për të mundësuar më pas edhe avionet çarter plotë me turistë.

**Gazetari:** Po sa i përket resortit "Prestigj". A ka më dhoma të lira për këtë sezon?

**Ilda Kasa:** E kemi tejkaluar me rezervime, por do ta zgjidhim këtë.

**Gazetari:** Ishte shumë kënaqësi dhe faleminderit shumë që e promovoni Shqipërinë dhe turizmin shqiptar në vendet tuaja! **Gazetari:** Nëse keni ndonjë këshillë tjetër për të gjithë ata që duan të vizitojnë Shqipërinë... Më pak fjalë çfarë do t'u këshillojti?

**Nina Horneval:** Këshillë për klientët? Shpresoj që ata të bëjnë siç tha zonja Kasa në fillim, që të mos rrinë gjithë ditën në pishinë apo plazh, por të vizitojnë edhe kryeqytetin, të shkojnë në Krutë, të vizitojnë malet dhe të përpiqen që të eksplorojnë vendin, sepse është i bukur dhe interesant.

**Gazetari:** Si e shikoni të ardhmen e Shqipërisë për turizmin?

**Nina Horneval:** Jam shumë optimiste, e thashë me herët dhe do e them sërish. Gjithçka varet nga ajo që bëjmë së bashku, sepse kemi shumë punë përpara nesh. Duhet të jemi të vetëdijshëm se kur klientët vijnë për herë të parë, për shkak të imazhit që zoti Hartman e përshkroi, pritshmëritë janë shumë të ulëta. Por kur ata kthehen sërish, pritshmëritë rriten. Më pas fillon puna e vështirë, por jam shumë optimiste. Mendoj se Shqipëria ka një të ardhme të ndritur si vendi i turistit.

**Gazetari:** Le të shpresojmë. Ju?

**Hartman:** Nëse do e rekomandoja, turistëve në vendet tona do u thosha se nëse duan të vizitojnë një vend të ri, atëherë shkoni në Shqipëri, sepse keni qenë në Turqi, keni qenë në Greqi, keni qenë në Spanjë. Proveni diçka të re, do të jetë emocionuese, do të takoni njerëz interesantë dhe është një rekomandim për njerëz, të cilët vërtetë dëshirojnë pushime cilësore me çmime të arsyeshme.

**Larson:** Ashtu siç tha edhe Nina, duhet të eksplorojmë këtë vend, jo vetëm plazhin, por edhe të njohim njerëzit, të provoni ushqimet, të njihni kulturën dhe të përfitoni që të jeni ndër të parët turistë të një vendi që nuk njihet shumë në përditë, sepse deri para 30 vjetësh ishte i izoluar.

**Gazetari:** Vizitojeni tani që është një vend i virgjër.

**Larson:** Dhe pasi ta vizitojnë, t'u thonë miqve që kemi qenë në Shqipëri, një vend i bukur. Është gjithmonë bukur të jesh vizitor i parë.

**Ilda Kasa:** Dhe për mua dua të them edhe një herë, faleminderit për mbështetjen, faleminderit për besimin dhe dua ta mbyll me fjalët e zotit Hartman, që Shqipëria nuk është shumë larg. Ne jemi këtu.

**Gazetari:** Edhe ne ju mirëpresim! Faleminderit! Ishte kënaqësi që zhvilluam këtë bisedë!





Zëdhënësja e KE: Fillojnë negociatat me Maqedoninë dhe Shqipërinë

# 'The Economist': Ballkani Perëndimor, rrezik i madh gjeopolitik

Pacolli uron Shqipërinë: Edhe ne do marrim lajmin pozitiv

Vendet e Ballkanit Perëndimor, Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova, Maqedonia, Mali i Zi dhe Serbia vuajnë nga disa "sëmundje". Kështu thuhet në një raport të Njësisë për të dhëna në revistën, "The Economist": Ballkani Perëndimor më 2025: Një e ardhme më e ndritur apo marginalizim i përhershëm? Sipas gjetjeve në raport thuhet se rajoni karakterizohet nga një rrezik i madh gjeopolitik. Në rreziqet e sigurisë përfshihen një varg i mosmarrëveshjeve bilaterale, ekzistenca e armiqësive nga periudha e luftës e viteve të '90 dhe rreziku nga fundamentalizmi islamik. Për më shumë, Bashkimi Evropian ka vërejtur edhe garë gjeopolitike në rajon nga Kina, Rusia dhe Turqia. Faktorët që mund të ndikojnë në rrezikun politik dhe jostabilitet përfshijnë ndasitë etnike, nivelin e ulët të besimit në qeveri, histori konfliktesh, papunësi të lartë, qasje të armë të vogla, rrezik nga terrorizmi, tensione ndërkombëtare, abuzim me të drejta të njeriut, dhe numër të madh të refugjatëve dhe personave të zhvendosur, shkruan REL. Raporti përmend se si më 2003, në një samit në Selanik, liderët e BE-së u kanë premtuar shteteve të Ballkanit se për do të jetë e hapur dera e anëtarësimit në bllok. Pesëmbëdhjetë vjet më vonë, një gjë e tillë mbetet një perspektivë e largët për gjashtë vendet e Ballkanit, derisa disa liderët të BE-së kanë deklaruar se viti 2018 është vit tejet i rëndësishëm për këtë rajon, duke përmendur zgjidhjen e konflikteve afatgjata, të cilat edhe kanë ndikuar në zgjatjen e procesit të anëtarësimit. Pas një pike të kthesës në kontestin 27-vjeçar në mes të Greqisë dhe ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, liderët shpresojnë që një fund i tillë të krijohet edhe për statusin e Kosovës. Ky njëherësh do të jetë në mesin e mesazheve kyçe në Samitin e Ballkanit Perëndimor që do të mbahet në Londër më 10 korrik të këtij viti. Në një tjetër raport të kësaj njësie që tregon për indeksin e demokracisë më 2017, Serbia ishte renditur e 66-ta në mesin e shteteve dhe territoreve, duke u cilësuar si i vetmi vend me "demokraci të çalë" në rajon. Të gjitha vendet tjera janë renditur në mesin e vendeve me "regjime të përziera", ku Shqipëria është renditur e 77-ta, Mali i Zi në vendin e 83-të dhe Maqedonia është listuar e 88-ta. Bosnja dhe Hercegovina gjendet e fundit në listën e vendeve në këtë aspekt, përkatësisht në vendin e 101-të. Në raport përmendet edhe se Mali i Zi dhe deri vonë edhe Maqedonia kanë qenë vende në të cilat de fakto ka ekzistuar vetëm një parti për një dekadë, të cilat kanë udhëhequr si pasojë e manipulimit me vota dhe rrezeve të klienteliste. Sa i për-



### BEHGJET PACOLLI

"Urime Shqipërisë dhe Maqedonisë për vendimin pozitiv për hapjen e negociatave. Edhe Kosova do të marrë lajmin pozitiv për liberalizimin e vizave shumë shpejt", -ka shkruar ministri i Punëve të Jashtme të Kosovës, Behgjet Pacolli.

### MARGARITA SHINAS

"KE-ja tani e fillon punën e përgatitjeve, siç qëndron në konkluzionet e Këshillit dhe do të vazhdojë të mbështesë rezultate të prekshme dhe të qëndrueshme, sidomos në fushën e gjyqësisë, luftën kundër korrupsionit, dhe administratës publike, të cilët kanë impakt të madh mbi jetën e çdoditshme të qytetarëve", -tha zëdhënësja e Komisionit Evropian, Margarita Shinas.

lematikë mbetet niveli relativisht i ulët i zhvillimit ekonomik në rajon, ndikimi gjeopolitik i Rusisë dhe mungesa ose dështimi i realizimit të reformave të kërkuara nga BE-ja. Ndërkaq ministri i Punëve të Jashtme të Kosovës, Behgjet Pacolli u është bashkuar reagimeve për vendimin e ministrave të Jashtëm të BE për shtyrjen e negociatave për Shqipërinë. Pacolli përmes një postimi në "Facebook", tekta uroi Shqipërinë dhe Maqedoninë, ka shkruar se edhe Kosova së shpejti do ta marrë lajmin pozitiv për vizat. "Urime Shqipërisë dhe Maqedonisë për vendimin pozitiv për hapjen

e negociatave. Edhe Kosova do të marrë lajmin pozitiv për liberalizimin e vizave shumë shpejt", -ka shkruar Pacolli. Këshilli Evropian në një draft dokument të publikuar ka dhënë konkluzione pozitive për Shqipërinë dhe Maqedoninë lidhur me hapjen e negociatave. Komisioni Evropian informoi opinionin publik se pas konkluzioneve të djeshme të ministrave të Punëve të Jashtme të BE-së për fillim të kushtëzuar të bisedimeve me Maqedoninë dhe Shqipërinë, do të fillojnë përgatitjet për ato bisedime. "KE-ja tani e fillon punën e përgatitjeve, siç qëndron në konkluzionet e Këshillit dhe do të vazhdojë të mbështesë rezultate të prekshme dhe të qëndrueshme, sidomos në fushën e gjyqësisë, luftën kundër korrupsionit, dhe administratës publike, të cilët kanë impakt të madh mbi jetën e çdoditshme të qytetarëve", tha zëdhënësja e Komisionit Evropian, Margarita Shinas. Sipas vendimit të djeshëm të Këshillit të BE-së, me plotësimin e kushteve të vendosura Maqedonia dhe Shqipëria do të mund të fillojnë negociatat për anëtarësim në qershor të vitit 2019.

"The Economist":

"Ballkani Perëndimor më 2025: Një e ardhme më e ndritur apo marginalizim i përhershëm? Rajoni karakterizohet nga një rrezik i madh gjeopolitik", - shkruhet në raportin e revistës "The Economist"

### SHKURT

#### Rusia po përgatit sulm të madh kibernetik

Kreu i policisë kibernetike të Ukrainës, Serhiy Demedyuk tha se hakëretë rusë po piraterojnë sistemet kompjuterike të kompanive të Ukrainës për t'i hapur rrugë "një sulmi të koordinuar, të shkallës së gjerë". Demedyuk i tha agjencisë Reuters se bankat dhe kompanitë energjetike janë në mesin e shënjestrave të hakëretëve të dyshuar dhe tha se policia e Ukrainës është duke punuar me autoritetet e huaja për t'i identifikuar fajtorët. Zëdhënësi i Kremlinit, Dmitry Peskov, i hodhi poshtë pretendimet e Demedyukut, duke i cilësuar si "të pavërteta". Autoritetet e sundimit të ligjit dhe firmat private të sigurisë në gjithë botën janë duke i monitoruar me kujdes kërcënimet në Ukrainë, pasi ky vend ka qenë origjinë e disa prej sulmeve më serioze kibernetike që kanë ndodhur në botë. Në qershor të vitit 2017, një virus i quajtur NotPetya ka goditur departamentet qeveritare dhe kompanitë shtetërore në Ukrainë, para se të përhapej në rrjetet e korporatave në gjithë globin, duke shkaktuar humbje prej miliarda dollarësh. Shtetet e Bashkuara dhe Britania e Madhe, së bashku me Ukrainën, kanë fajësuar Rusinë për virusin NotPetya.

#### Alarm në Britani, zjarri i madh përpin dhjetëra shtëpi

Zjarrfikësit po vazhdojnë të luftojnë për orë të tëra me flakët e zjarrit në një zonë të Manchesterit. Deri më tani janë evakuuar 50 shtëpi dhe qindra njerëz. Flakët kanë filluar që në fundjavë, por moti i nxehtë dhe erërat e natës kanë bërë që të përhapet në një zonë shumë të madhe. Autoritetet deklarojnë se zjarrfikësit po punojnë në kushte jashtëzakonisht të vështira për të përmbajtur këtë "incident të madh", siç ata e quajnë. Ushtria është në gatishmëri dhe pritet të ndërhyjë pasi kjo është një emergjencë e madhe. Banorët tregojnë se janë shumë të frikësuar pasi zjarri arriti shumë pranë shtëpive të tyre. Policia ka njoftuar banorët që të mbajnë gjatë gjithë kohës dritaret mbyllur dhe pse temperaturat janë shumë të larta.

## KONGRESMENI AMERIKAN FESTON ME SIMBOLIN E SHQIPONJËS

Eliot Engel, kongresmeni amerikan, mbështetës i hapur i shqiptarëve, ka treguar me një gjest të theksuar se anën e kujt mban edhe në rastin e gjatitjes së futbollistëve Xherdan Shaqiri dhe Granit Xhaka nga FIFA për mënyrën sesi e festuan fitoren, duke bërë shenjën e shqiptarjes. Pas marrjes së mandatit në Kongres, Engel po bëri duke bashkuar duart mbi gjoks në të njëjtën mënyrë. Veprimi i tij tejet domethënës është përshëndetur gjerësisht nga komuniteti shqiptar. Por Engel nuk ishte i vetmi që rreshtohet në anën e Xhakës e Shaqirit. Të njëjtin gjest bëri edhe ish-presidenti i Kroacisë, Stipe Mesiq, çka ngjalli reagimin e fortë të presidentit serb Aleksandër Vuçiq.



FOTOLAJM



India, vendi më i rrezikshëm në botë për të qenë grua

# India, vendi më i rrezikshëm në botë për të qenë grua

Marrë nga radio "Evropa e Lirë"

India është vendi më i rrezikshëm në botë për të qenë grua, për shkak të rrezikut të madh nga dhuna seksuale dhe puna si sklave, tregon një studim i ri i ekspertëve. Fondacioni "Thomson Reuters" publikoi të martën një anketë me 550 ekspertë të çështjes së grave dhe gjeti se India është vendi më i rrezikshëm për dhunën seksuale ndaj grave, trafikimin e tyre, martesat e detyruara e të tjera. Pas Indisë, vendet më të rrezikshme për gratë janë Libia, Mianmari, Nigeria dhe Rusia. "Gratë janë të cenueshme për shkak të statusit të tyre vartës ekonomik, social dhe kulturor", tha Christina Hayden Sharpe nga Misioni Ndërkombëtar i Drejtësisë. Sipas studimit, gratë në Indi përballen me kërcënimin të madh nga trafikantët, sepse ato ende konsiderohen si objekte seksuale dhe qytetare të klasës së dytë. Rreth dy të tretat e 15,000 rasteve të trafikimit të regjistruara në Indi në vitin 2016 kanë përfshirë gra, gjysma e të cilave e tyre nën 18 vjeç. Shumica e tyre janë shitur për punë seksuale dhe shërbëtoresh shtëpiake. "Trafikimi është një çështje globale, por nga të gjitha viktimat që kam parë, ato nga



Azia Juglindore, kryesisht India, janë më të cenueshme", tha Triveni Acharya nga Fondacioni i Shpëtimin, organizatë bamirëse në Indi. Sipas saj, "vajzat vazhdojnë të shihen si barrë për prindërit dhe më me pak vlerë se djemtë". Në Libi, vend i ndarë midis qeverive

rivale, ku portet kontrollohen kryesisht nga grupe të armatosura që kontrabandojnë afrikanë në anije që shkojnë për në Evropë, shumë emigrantë ndalojnë dhe detyrohen të punojnë në Kombat e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian. "Situata e grave që udhë-

tojnë përmes Libisë është e tmerrshme", tha Hannah Salah, hulumtuese e çështjes së Libisë në organizatën "Human Rights Watch". "Do të thosha se shumica e tyre përballen me rrezikun e keqtrajtimit dhe abuzimit", tha ajo. Sipas studimit, gratë në Mianmar për-

ballen me një tjetër kërcënim nga trafikantët, ato detyrohen të martohen në Kinë. Mungesa e vendeve të punës në Mianmar bën që gratë të bien pre e trafikimit - thotë studimi. Sipas Kombeve të Bashkuara, mijëra gra nigeriane dërgohen në Evropë çdo vit përmes Libisë dhe detyrohen të bëjnë punë seksuale në Itali. Rusia, ndërkaj është burim dhe vend destinacion për viktimat. Gratë ruse trafikohen në Evropë dhe në Lindjen e Mesme, ndërsa gra nga Tajlanda, Kina dhe Nigeria trafikohen në Rusi. Procesi i rreptë i vizave në Rusi ka bërë që trafikimi i grave në këtë vend të jetë një përpjekje e vështirë, por kriminelët e kanë shfrytëzuar Kampionatin Botëror të Futbollit, i cili u lejon vizitorëve të hyjnë pa viza në Rusi, nëse posedojnë biletë dhe kartë të tifoizit. Në dhjetëshen e parë të vendeve, ku të qenët grua është rrezik, janë edhe Filipinet, Afganistani, Tajlanda, Nepali dhe Bangladeshi.

SHKURT



Motorët "Harley-Davidson" "zhgënjëjnë" presidentin Trump

Harley-Davidson", simboli i rrugëve të Amerikës, ka njoftuar se do të zhvendosë prodhimin e motorëve jashtë SHBA-ve për të shmangur barrën e tarifave të Bashkimit Evropian. Javën e kaluar, BE-ja vuri taksa hakmarrëse mbi prodhimet amerikane, pasi presidenti i SHBA-ve, Donald Trump, ka vënë tarifa mbi importet e aluminit dhe çelikut nga Evropa dhe vende të tjera aleate. Sipas kompanisë, tarifat kanë shtuar çmimin mesatarisht me 2,200 dollarë për çdo motor të eksportuar nga SHBA-të në BE dhe kjo vlerë nuk do të përballohej më nga qytetarët. Aksionet e "Harley-Davidson" pësuan rënie me 5% gjatë ditës së djeshme. Kompania e motorëve "Harley-Davidson" me seli në shtetin Uiskonsinit, me degë në Australi, Brazil, Indi dhe Tajlandë njoftoi se do të rrisë investimet në fabrikat e saj ndërkombëtare, por nuk tregoi se në cilat. Për këtë ka reaguar dhe Presidenti i SHBA-ve, Donald Trump, duke kritikuar firmën e motoçikletave. Ai shkroi në "Twitter" se ishte i befusuar që kompania u bë "e para që valëvit flamurin e bardhë për t'u larguar". Trump shkroi se luftoi shumë për ta.

Eksperti kushtetues: Vonesa e nënshkrimit të ligjit, vepër penale për Ivanov

## Marrëveshja me Greqinë për emrin, Kuvendi i Maqedonisë përgatitet për votimin e ri

Pas deklarimit të Presidentit të Maqedonisë, Gjorge Ivanov, për mosnënshkrimin e ligjit për ratifikimin e marrëveshjes për emrin, ligjvënësi do të duhet të kthejë ligjin në lexim të tretë. Zyrtarisht nuk dihet akoma data se kur do të vendoset në rend dite, por që duhet të vendoset në seancën e parë, këtë e garanton rregullorja e Kuvendit. Marrëveshja për çështjen e emrit siç duket do ta ketë fatin e ligjit për përdorimin e guhëve. Në votim të tretë, Ivanovin e detyron Kushtetuta ta nënshkruajë ligjin. Ekspertët

vlerësojnë se zvarritja e ligjit përbën vepër penale, e cila në rast se jo tani, pas përfundimit të mandatit, mund të jetë bazë për përgjegjësi penale të kryetarit të shtetit. Themelko Risteviski kujton që Ivanov duhet të nënshkruajë ligjin dhe më pas në rast se dyshon në kushtetutshmërinë e tij, të iniciojë procedurë për vlerësim në Gjykatën Kushtetuese. "Ta nënshkruajë ligjin, sepse këtë e kërkon Kushtetuta dhe këtu nuk ka dilema. Pas kësaj, derisa nuk pajtohet me ligjin, ka të drejtë që pas publikimit të ligjit në Gazetën Zyrtare, si Presi-

dent i shtetit mund nisë iniciativë për vlerësimin e Kushtetutshmërisë në Gjykatën Kushtetuese. Në fund Kushtetuesja do të thotë fjalën përfundimtare", deklaroi eksperti kushtetues, Themelko Risteviski për "Alsat-M". Ndërkohë, paralajmërimet e presidentit për përgjegjësi penale, sipas Risteviskit janë manipulime, të cilat sipas tij janë në të njëjtën vijë me VMRO-DPMNE-në, e cila gjithashtu ka paralajmëruar përgjegjësi penale për të gjithë ata që sipas tyre kanë votuar për "marrëveshjen kapitulluese". Marrëveshja



mes Maqedonisë dhe Greqisë rreth kontestit të emrit u ratifikua në Kuvend më 20 qershor. Me arsyetimin se marrëveshja bie në kundërshtim me Kushtetutën, Ivanovi vendosi veto mbi të, duke mos e dekretuar, qëndrim ky që si-

pas shumicës parlamentare ishte i pritshëm. Në leximin e tretë, në këtë situatë siç është ratifikimi i marrëveshjes nuk parashikon amendamente, ndërsa në seancë plenare nuk do të mund as të diskutohet.

NJOFTIM ANKANDI

Përmbanues gjyqësor privat Artan Sima zhvillon ankandet sipas datave të mëposhtme: **Datë 03/07/2018, ditën e Martë, ora 16:00,** përfundon ankandit i ri (i parë), për shitjen e pasurive të paluajtshme të llojit: "Apartament" me sipërfaqe prej 53,92 m2, Rr" Ahmet Bektaşi", pl. 59, shk. 1, k2, ap. 6, në Kolonjë, në vlerën 1,600,000 lekë. Pasuria është lenë në garanci bankare për shlyerje kredie sipas kontratës për venien e sendit ne hipoteke të debitorit: Z.Bashkim Itri Sotari banues në Korçë, për detyrimin ndaj kreditorit z.Vllco Koco Sotiri, banues në Erseke, Kolonjë. Ankandit zhvillohet pranë zyrës së përmbanuesit me seli lagjen nr.3, Rruga «Avni Rustemi», nr.31, k.1, Korçë. Kontakt Cel.0674044666, e-mail: simaartan@yahoo.com

NJOFTIM ANKANDI

Përmbanues gjyqësor privat Artan Sima zhvillon ankandet sipas datave të mëposhtme: **Datë 04/07/2018, ditën e Mërkurë, ora 16:00,** përfundon ankandit i ri (i parë), për shitjen e pasurive të paluajtshme të llojit: "Apartament" me sipërfaqe prej 82 m2, e ndodhur në Korçë, në vlerën 2,099,200 lekë. Pasuria është lenë në garanci bankare për shlyerje kredie sipas kontratës për venien e sendit ne hipoteke të debitorit: Z.Bashkim Itri Sotari banues në Korçë, për detyrimin ndaj kreditorit z.Alfred Selim Xhambazi banues në Korçë. Ankandit zhvillohet pranë zyrës së përmbanuesit me seli lagjen nr.3, Rruga «Avni Rustemi», nr.31, k.1, Korçë. Kontakt Cel.0674044666, e-mail: simaartan@yahoo.com

SHPALLJE ANKANDI

Datë 02.07.2018, Ora 16:00

Shoqëria Përmbanimore "Besnik Bajraktari" sh.p.k me adresë Rr. "George W. Bush", Pallati "Kasmi", Zyra 107, Tiranë, Tel. 404506426, Cel. 067 201 9460/ 068 904 9202, e-mail: besnik.bajraktari@gmail.com. Shpall ankandit e parë për pasurinë e paluajtshme të debitorit Shoqëria "VIGAND Konstruktion" sh.p.k: "Njësi" me sipërfaqe 265,22 m2, nr. i pasurisë 8/440-N12, zona kadastrale 8150, vol. 47, faqe 208, adresa Rruga "Petro Nini Luarasi", Tiranë. Çmimi fillestar i ankandit të dytë është në shumën 339 482 (treqind e tridhjetë e nëntë mijë e katërqind e tetëdhjetë e dy) EUR. Ankandit do të zhvillohet në ambientet e Shoqërisë Përmbanimore "Besnik Bajraktari" sh.p.k me adresë Rr. "George W. Bush", Pall. Kasmi, Zyra 107, Tiranë.

PROTESTA VAZHDON

# TEATRI KOMBËTAR

## Artistët përçahen, Ndrenika e Derhemi bien dakord me bashkinë, të tjerët në protestë

*Kreu i bashkisë takon katër përfaqësues të protestuesve për çështjen e TK, Liçaj: Nuk shitemi, nuk jemi lodra partish*

*Pas takimit dalin në qëndrime të ndryshme, Trebicka: Marrëveshja nuk bëhet me fotografi, të anulohet ligji*

Fatmira Nikolli

**K**ur ka vullnet, ka rrugëzgjidhje! Mirënjohje nga zemra aktorëve, regjisorëve, arkitektëve, inxhinierëve e sidomos sindikatave e protestuesve! Falë kontributit të secilit kemi një marrëveshje më të mirë dhe jemi sot gati të nisim negociatat për një Teatër të ri Kombëtar!

Ka qenë ky postimi që ka bërë dje në Twitter kreu i Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj pas një takimi me Arben Derhemin, Alfred Trebickën, Altin Bashën, përfaqësues të grupit të artistëve që protestojnë për ruajtjen e godinës/ truallit të Teatrit Kombëtar. Pas pesë muajsh protestë, nga të cilët 14 ditët e fundit çdo mbrëmje, gjuha e përbashkët nuk duket të jetë gjendur ende. "Nuk ishte marrëveshje, ishte takim ku u kërkuan tri pika: të ndryshohet/ tërhiqet projektligji që të mos preket asnjë cm tokë e teatrit. Të jenë dy përfaqësues nga komuniteti dhe të ketë konkurs ndërkombëtar për ndërtimin e teatrit!", thanë dje artistët. Ndërkaq, Alfred Trebicka ka thënë për "Gazetën Shqiptare" se "nuk është se ka ndonjë marrëveshje përfundimtare. Ka marrëveshje në kontekstin e negociatave që po vazhdojnë. Kjo është një punë që nuk bëhet me një takim edhe me një fotografi. Ajo që ne diskutuam me të ishte tek hapja e konkursit ndërkombëtar për këtë projekt që është. Ne ngulëm këmbë që kjo të bëhet patjetër. Nuk cenohet asnjë centimetër nga truallit që ka Teatri Kombëtar". Më tej, Arben Derhemi tha dje se "territori i Teatrit Kombëtar është i panegociueshëm dhe për këtë pikë Veliaj ka rënë dakord. Nga gjurma aktuale nuk do lëvizet asnjë centimetër. Kjo është një pikë e shkruar në projektin që po diskutohet". Duke qenë se artistët u akuzuan se tradhtuan kauzën, pas postimit të Veliajt, Derhemi shkroi në Facebook një sqarim. "Për të gjithë ata që më njohin dhe ata që s'më njohin ose nuk duan të më njohin. Për të gjithë ata që janë të interesuar për godinën e Teatrit dhe fatet e te-



atrit, por edhe për ata që nuk iu intereson se as kanë qenë në Teatër dhe as ka për t'u rënë rruga ndonjëherë këndeje...Për të gjithë ata që më njohin si Arben Derhemi dhe ata që nuk më njohin si aktor teatri...për ata që mendojnë se unë jam koka e protestës dhe për ata që mund të më paragjykojnë si një person me status që mund të firmos marrëveshje...Ju lutem, pak durim dhe urrejtje, kuptoni që negociimi, takimet, bisedat apo ballafaqimet janë thjesht elemente të një dialogu shoqëror dhe institucional që të mbrohët teatri, kujtesa historike, qyteti dhe memoria institucionale...Mos më bëni kështu që të fuqishëm duke me veshur kompetenca dhetribute apo sovranitete të deleguara për të firmosur marrëveshje...", vërejtj Derhemi. Ai kujtoi se "edhe në rolet skenike që kam luajtur nuk e kam pasur ndonjë personazh të tillë të përafërt që firmos marrëveshje...Pak durim ju lutem, dhe më shumë përgjegjësi qytetare dhe shoqërore...Asgjë nuk bëhet në një ditë përveç marrëzive...Ju faleminderit nëse s'paku më lexoni dhe shumë faleminderit nëse edhe më kuptoni". Po dje, Neritan Liçaj, shkroi se "TEATRI NUK PREKET". Si vazhdues i frymës qytetare të profesorëve të mi Agim Qirjaqi, Vangjush Furrxhi, Robert Ndrenika e shumë të tjerëve. Në mbrojtje të vlerave më të mira të trashëgimisë kulturore, pronës publike ku bën pjesë dhe Teatri Kombëtar, kundër politikës së korruptuar, mafjes së betonit, propagandës dhe gënjeshtërave ditën për ditë, ju ftoj të gjithëve pa përjashtim të

mblihdemi në Teatër në orën 19:00 për të mbrojtur dinjitetin tonë qytetar. Nuk jemi të shitur as tradhtojmë në artistet. Nuk jemi lodra partish për këtë ju siguroj. Duam vetëm të na dëgjoni dhe mbështesni ju shqiptarë pa përjashtim, pa të cilët ne nuk jemi asgjë. #mbrovetenmbroteatrin"

**DEKLARATË E ALEANCËS QYTETARE PËR MBROJTJEN E TEATRIT**

Përmes një deklaratë zyrtare Aleanca për Mbrojtjen e Teatrit Kombëtar, shkroi sesir rjedhjeje dhe takimeve të vazhdueshme private që vazhdon të kryejë Kryetari i Bashkisë Tiranë, Erion Veliaj, duam të informojmë publikun dhe qytetarët se "nuk ka asnjë kompromis dhe marrëveshje me asnjë përfaqësues qeveritar pa u tërhequr ligji i veçantë nëpërmjet të cilit kërkohet të kryhet ndërtimi i godinës së re të Teatrit Kombëtar". Sipas Aleancës, ky ligj i veçantë, nëpërmjet të cilit qeveria i jep vetes pushtetin të negociojë pa kushte me një kompani të paravendosur, jo vetëm bie në kundërshtim me ligjet aktuale për prokurimin publik, partneritetet publike-private, dhe pushtetin vendor. Akoma më tej, ai është në kundërshtim të qartë të Kushtetutit ku sanksionohet barazia para ligjit dhe ndarja e pushteteve. Shteti dhe shoqëria shqiptare nuk kanë nevojë për artificia të tilla ligjore. Ato krijojnë vetëm për të mbrojtur me ligj autoritet e grabitjes së pronës publike. Së dyti, Aleanca shihon se kursesi dhe absolutisht nuk mund të ketë falje të truallit publik ku shtrihet Teatri Kombëtar dhe ai Eks-

perimental. Ajo shton se këto metoda financimi jo vetëm që nuk janë "falas", jo vetëm që i kushtojnë më shtrenjtë publikut, por kanë si qëllim të vetëm vjedhjen e pasurisë së përbashkët - pasuri jo vetëm e artistëve, por e të gjithë shoqërisë shqiptare. Si rrjedhojë qëndrimi i Aleancës Qytetare për Mbrojtjen e Teatrit mbetet i qartë dhe i pandryshueshëm: Qeveria duhet të tërheqë draftin e ligjit të veçantë dhe të fusë procesin në kuadrin e rregullit ligjor. "Vetëm ky proces garanton gjetjen e mundësive të ndryshme në lidhje me godinën e Teatrit si zgjidhjen më të mirë teknike. Së treti, Kryetari i Bashkisë Tiranë, Erion Veliaj aktualisht nuk ka asnjë status për kryerjen e negociatave apo dëgjesave publike. Teatri është pronë publike në varësi të Ministrisë së Kulturës, e cila është po ashtu përgjegjëse për nisjen e procedurave të rregullta ligjore. Përfshirja e z. Veliaj jo vetëm që është personale dhe informale, por është në kundërshtim të frymës së procedurave ligjore aktuale dhe parimit të ndarjes së pushteteve. Veliaj është i mirëpritur të japë mendime personale, ashtu si gjithë qytetarët e tjerë, por asgjë më shumë se kaq!", përfundon reagimi i Aleancës.

### ÇESHJTJA NE PE

Parlamenti Europian në Bruksel diskutoi mbi trashëgiminë kulturore në Europë me praninë e autoriteteve më të larta të Bashkimit Europian si kreu i Parlamentit Antonio Tajani dhe Presidenti i Komisionit Europian, Jean-Claude Juncker. Pjesë e kësaj Konference të nivelit të lartë ishte edhe kryetaria e Komisionit të Kulturës, Albana Vokshi, e cila ngriti shqetësimin e shkatërrimit të trashëgimisë kulturore shqiptare. Në fjalën e saj në Parlamentin Europian, Vokshi apeloj për ruajtjen e Teatrit Kombëtar. "Ne duam të mbrojmë këtë ndërtës, sepse qeveria vendosi ta prishë që t'i japë tokën privatit për të ndërtuar kulla të larta. Kam një apel për ju për të shpëtuar këtë ndërtës, por edhe t'i kushtoni më shumë vëmendje vendeve si Shqipëria, për të pasur projekte për ruajtjen e trashëgimisë kulturore, për të lidhur të sh-

kuarën me të ardhmen",-tha Vokshi. Ndërkaq, deputetët e opozitës thërresin në dëgjesë kryetarin e Bashkisë së Tiranës Erion Veliaj për ligjin e posaçëm që shemb Teatrin Kombëtar dhe i jep privatit territorin e Teatrit Kombëtar.

### PROTESTA VIJON, POR ME MUNGESA

Është ora 19:30 kur në sheshin para teatrit qëndrojnë protestues dhe tërhequr të protestës bëhen gati të flasin. Dita ka qenë e gjatë dhe disa prej tyre "janë njosur" nga takimi me kryetarin e bashkisë. Ata, nuk janë në takim. Budina, jep e merr me protestuesit. Ervin Goce sqaron se kushdo ka të drejtë të bëjë takime private. "Në imazh nuk del mirë të firmosësh për teatrin monument. Nuk është çështje vetëm e aktorëve. Është e qytetarëve. Një sindikatë nuk hedh dot një kauzë. Kauza vazhdon. Po përqipimi që përtej takimeve këtu do hapim debat kombëtar. Do ketë debat për ligjin dhe do transmetohen live. Në opinion është krijuar konfuzion për vlerën e godinës. Protesta do vazhdojë me axhendë. Ne nuk tërhiqemi nga kërkesa e parë: tërheqja e ligjit". Pas radhës së parë qëndron Maks Velo. Pranë tij Stefan Çapaliku. Emrat e njohur të skenës nuk janë, por qytetarët nuk mungojnë.

Çapaliku tha se nuk e kupton politikën. "Sinqerisht nuk e kuptoj se pse nuk e marrin këtë si kauzën më të rëndësishme politike të vitit 2018. Se kuptoj pse nuk janë të pranishëm. A janë homo urbanus apo janë genie urbane apo organizohen në fushata korrje- shirjesh. Këtu po krijohet një precedent, nëse prona publike i kalon privatit, atdheu do shitet. A ka qenie më të rëndësishme se kaq? Në greva janë: grevistët, grevthyesit e aristokracia që ushqen grevthyesit. Ju lutem atyre që s'janë këtu, thjesht të deklarojnë me cilën anë janë".

Dash Shehi ndërhyr dhe merr mikrofonin. "Meqë për mendet politikë, po ju them se nuk kemi dashur të përzihem. Një betejë civile si kjo duhet të jetë më e madhe me rezistencën. Shqipëria ka arritur sukses të madh me rezistencën. Kjo është betejë civile dhe ajo e armëve kimike. Stadiumi është supermerkato me



hotel brenda. Tani duan ta bëjnë me teatrin. Kullat bëhen kudo jo të bëhen te ne. Veç njerëzve të teatrit duhet të dalin qytetarët e Tiranës. Të zgjidhet ndërgjegjia qytetare. Një vjedhje materiale po bëhet këtu. Ju falenderoj për këtë që keni bërë. Ka qenë shenjë qytetare. Të gjithë kur jemi vetëm jemi më të dobët", tha ai.

Neritan Liçaj vjen me vonesë por

Njeriu nuk tradhton kurrë nëse nuk tradhton veten. Ju qytetarë jeni Giovanni Falcone dhe Borsteri. Ju s'keni frikë nga pushteti as nga rroga. Ju e doni këtë vend. Jemi idealistë e jemi krenarë. Ftoj ata qytetarë që duan ti tregojnë forcën e tyre pushtetit të vijnë të na bashkohen. Kemi para nesh makineri gebelsiane dhe një mal me para. Duam të jemi qytetarë të lirë. Ta jetojmë siç duhet jetën me kokën lart".

Robert Budina në fund vërejtj se protesta sapo ka filluar: "Ne i shpëtojmë të tërë me qëndresën tonë. Edhe ata që kanë likur i shpëtojmë nga vetja e tyre".

### MESAZHI I NDRENIKËS

Mbrëmë në orët e vona ka reaguar edhe Robert Ndrenika. Përmes një mesazhi në profilin e tij në "Facebook", ai shkroi: "Të nderuar zotërinj Arben Derhemi, Altin Bashka dhe Alfred Trebicka. I nderuar kryetari i bashkisë, zoti Erion Veliaj! Personalisht ju falënderoj për rezultatit e arritur. Ju sot shënuat fillimin e një maratone që le të shpresojmë do të përfundojë me ndërtimin e një Teatrit Kombëtar bashkëkohor: Uroj që fryma e sinqeritetit, transparencës dhe mirëkuptimit midis jush si përfaqësues të komunitetit teatror dhe bashkisë të jetë deri në ditën e përfundimit e më tej! Përqafime! Robert Ndrenika".





BIBLIOTEKA KOMBETARE



PD KËRKON HETIM: BIBLIOTEKA DHE BASHKIA U PËRMBYTËN NGA PUNIMET NË SHESHIN "SKËNDERBEJ"

20 milionë euro nuk mjaftuan për kanalizimet! Mungesa e shkarkimeve të ujërave nëntokësore, të punimeve në shesh, janë bërë shkak i përmbytjes dhe shkatërrimit të qindra titujve dhe materialeve në Bibliotekën Kombëtare dhe në Arkivin e Bashkisë së Tiranës. Denoncimi i bërë publik nga deputetët e Partisë Demokratike Romeo Gurakuqi dhe Hekuran Hoxhalli, vë në dukje sipas tyre një tjetër skandal të investimeve nga Bashkia Tiranë. "Punimet në shesh, përballë hyrjes së Bibliotekës kanë bllokuar rrjedhjen e ujërave nëntokësore", tha Gurakuqi,

i cili theksoi se i është drejtuar parlamentit me kërkesa të vazhdueshme për një Bibliotekë të re Kombëtare dhe të një Arkivi Qendror modern. "E kam kërkuar disa herë në parlament dhe gjatë diskutimit të buxhetit të shtetit, por kemi hasur në vesh të shurdhët", tha Gurakuqi. Deputeti Hekuran Hoxhalli theksoi se qeveria po mundohet të shesë idenë se përmbytja erdhi nga reshjet e shiut, por e vërteta është krejtësisht tjetër, tha ai. "Përmbytja me themel e Bibliotekës Kombëtare shkaktoi kaq investimet pa kushtin bazë në shesh, shkarkimin e ujërave, të cilat mungojnë. Kjo është

arsyeja që 20 milionë euro investim, nuk mjaftojnë për të kryer fillimin e çdo pune publike, trajtimin e ujërave të shiut", tha Hoxhalli, duke kërkuar hetim dhe ndëshkim për këtë abuzim. Ai theksoi se kryearkitekti diletant i Shqipërisë, kur "dhunoi" sheshin "Skënderbej" nuk e la në duart e ekspertëve të inxhinierisë, por fantazisë dhe kapriçios të tij, tha Hoxhalli. Biblioteka Kombëtare pas përmbytjes kishte mbyllur të gjitha hyrjet e saj, ndonëse deputetët demokratë kërkojnë prej ditësh të vëzhgojnë nga afër situatën.

Drejtorët e qeverisë dhe vëllai i ministres: Duam teatër të ri, por trualli të mos preket

Fatmira Nikolli

LETËR E HAPUR Drejtuar: SH.T.Z. Ilir Meta President i Republikës së Shqipërisë

Z. Gramoz Ruçi Kryetar i Parlamentit Shqiptar

SH.T.Z. Edi Rama Kryeministër i Shqipërisë

Znj. Mirela Kumbaro Ministre e Kulturës

Z. Erion Veliaj Kryetar i Bashkisë Tiranë

Ne artistët nënshkruar të kësaj deklaratë, të vëmendshëm dhe të ndjeshëm ndaj debatit aktual rreth vendimmarrjes për godinën e Teatrit Kombëtar, gjithashtu, të vetëdijshëm se kjo vendimarrje do të ketë ndikim shumë të rëndësishëm në jetën kulturore dhe shpirtërore të publikut, dëshirojmë t'i bëjmë me dije të gjithë opinionionit publik se: Shprehim dakordësinë tonë dhe nevojën urgjente për një godinë të re të Teatrit Kombëtar, një godinë, e cila t'u shërbejë artistëve dhe mbi të gjitha publikut, i cili edhe pse në kushte të rëndësishëm të papërshtatshme, për asnjë moment nuk e ka braktisur skenën e teatrit. Ne artistët e skenës, shprehim vullnetin dhe njëkohësisht edhe kërkesën, në funksion edhe të transparencës që i shërben forcim-

Letra e Hapur e 65 artistëve të tjerë: Politika të mos e përdorë për qëllime mesquine

Table with 2 columns: Names of artists and their professions. Includes names like Lulzim Zegaj, Armando Bora, Genti Deçka, etc.

it të besimit në këtë proces, për përfshirjen tonë në mënyrë të domosdoshme në komisionin e negociimit që do të ngrihet për zhvillimin e projektit të ri, me qëllim për të qenë pjesë e vendimmarrjes që ka të bëjë me ngritjen e godinës së re të Teatrit Kombëtar. Po kështu, shprehim mendimin tonë paraprak, para nisjes së negociatave, se prona që zotëron Teatri Kombëtar, duhet të shfrytëzohet ekskluzivisht për godinën e re të Teatrit Kombëtar, duke mos e cenuar dhe duke mos lejuar tjetërsimin e asnjë pjesë të kësaj prone, apo vendosjen

ditës. Kjo vendimarrje ka rëndësi historike dhe kombëtare; impakti i saj shkon përtej palëve dhe aktualitetit politik. Kërkojmë dhe inkurajojmë të gjitha institucionet vendimmarrëse ekzekutive dhe legjislative t'i japin rëndësinë e duhur me përgjegjësi jo vetëm ligjore, por edhe qytetare kësaj çështjeje. Koha për vendimarrje në lidhje me këtë çështje tashmë ka ardhur. Prej momentit kur mendimi i ekspertizës institucionale që ka lidhje me arkitekturën, inxhinierinë e ndërtimit, zjarrfikësit etj., është shprehur në formë të qartë në lidhje me këtë çështje, çdo ditë që kalon është thjesht humbje kohë me debate, të cilat mund t'i shërbejnë kujtudo, por jo interesave të publikut dhe Teatrit Kombëtar. I gjithë ky proces, kërkon një bashkërendim dhe mbi të gjitha besim midis palëve, për të ngritur më në fund një godinë bashkëkohore dhe moderne të Teatrit Kombëtar, në shërbim të artistëve dhe publikut tonë artdashës.

- NENSHKRUESIT E DEKLARATËS
1. Firro Mani
2. Fatos Haxhiraj
3. Drita Haxhiraj
4. Artan Imami
5. Gëzim Kame
6. Viktor Zhusti
7. Pëllumb Kulla
8. Bashkim Hoxha
9. Luftar Paja
10. Haxhi Rama
11. Eva Alikaj
12. Josif Papagjoni
13. Berina Kokona
14. Spiro Duni
15. Laert Vasili
16. Zamira Kita
17. Sotiraq Bratko
18. Guri Koço
19. Hervin çuli
20. Indrit gobani
21. Genc Shkodrani
22. Lulzim Zeqja
23. Armando Bora
24. Gazmend Paja
25. Genti Deçka
26. Andia Xhunga
27. Adelina Muça
28. Gent Hazizi
29. Ardiyan Cerga
30. Arben Kumbaro
31. Kastriot çausi
32. Petri Malaj
33. Inis Gjoni
34. Kozeta Bakui
35. Flaura Kureta
36. Elia Zaharia
37. Laedia Hajdari
38. Genti Kame
39. Erion Kame
40. Mateus Frukro
41. Kristo çala
42. Gert Ferra
43. Bruno Shllaku
44. Paskualina Gruda
45. Erion Isai
46. Monika Lubonja
47. Paola Kodra
48. Blerta Belliu
49. Albano Prodari
50. Afrim Agalliu
51. Astrit Mamaj
52. Ilirjan Ali
53. Agron Hamo
54. Lavdimir Abilalaj
55. Matilda Avdyli
56. Agron Jakupi
57. Drini Shehu
58. Jorgaq Tushë
59. Shkëlqim Jaupi
60. Jaho Guma
61. Luli Hoxha
62. Arjola Basho
63. Josif Sina
64. Gjergj Mena
65. Klea Huta

Opinion i Ditës

# Sistemi apo vetingu

Nga Sokol Hazaj

(Vijon nga faqja 1)

... iniciativa të këqija, apo tërësisht në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Fatkeqësisht e radhës, të cilën unë e pres, qëndron në faktin se dhe pas krautjes, drejtësia do të ngelet ende në prehrin e politikës, duke u shfrytëzuar tejskajshëmrisht si lobing votash, apo si errësira ku njerëzit enden pambarimisht duke besuar pakës dritë tek e keqja më e vogël.

Gjithsesi, pa dashur ta ngarkoj diskutimin tim, bëj me dije se sistemi i drejtësisë duam apo nuk duam ne, ka tre komponentë përbërës, kahershëm të padikutueshëm. Ajo mund të ketë edhe katër, pesë dhe më shumë në ofrtë se udhëheqja politike e deritanishme tek ne kërkon ta zgjas pafundësisht ekuacionin, siç dhe bën në mënyrë të përhershme. Por e vërteta, pra themelet e një reforme janë tri dhe vetëm tri, të cilat konsistojnë në forcimin e sistemit ligjor, forcimin e gjykatave, si dhe rregullimi pasojave.

Duke thjeshtuar akoma më tej diskutimin, citoj se mjafton të merresh në mënyrë sipërfaqësore me këto tri kategori, konstaton se i gjithë kuorumi ligjor i deritanishëm ende nuk e ka arritur qëllimin për të cilin qytetarët e këtij vendi kanë shpresuar dhe vazhdojnë të kenë ende besim se akte të ndryshme ligjore do të mund të kthejnë fytyrën nga prona e etërve të tyre. Parashikimet kushtetuese janë të qarta, të sakta dhe nuk lënë vend për asnjë lajthitje ligjore të mëpastajme. Për këtë mjafton të citosh parashikimet e neneve 11, 41, 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Neni 11/2 pranon se "Prona private dhe publike mbrohen njëllig me ligj". Neni 41/2 pranon se "Prona fitohet me dhurim, me trashëgimi, me blerje dhe me çdo mënyrë tjetër klasike të parashikuar në Kodin Civil". Neni 42 pranon se "Liria, prona dhe të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor". Vështruar me vëmendje këto dispozita, konstatohet lehtë se këto akte nuk kanë nevojë, ose nuk të lënë mundësi të devijosh nga e vërteta, nuk të krijojnë asnjë tolerancë të mosnjohësh apo të mos krijosh kushtet e veçanta ligjore dhe më tej, mbi njohjen, kthimin pse jo dhe ekzekutimit e vendimeve pa kushtet mbi çdo pronë. Madje, për nga mënyra se si janë ndërtuar nenet e sipërcituara konstatohet se barrën e provës duhet ta merrte shteti, jo individit. Por çka ndodhur? Që prej vitit 1991 në kushtet kur mbi Ligjin nr.7501, datë 19.07.1991 "Për Tokën" janë bërë ndryshime për mbi katër herë, si dhe mbi dyzet herë kanë ndryshuar ligjet mbi pronësinë, na bën të mundur të konkludojmë se garancia juridike e dhënë nëpërmjet Kushtetutës ose është zbehur, ose ka humbur kuptimin e saj. Pra, ka ndodhur e kundërta e dimensionit të parë të kuptimit dhe forcimit të sistemit të drejtësisë, e cila lidhet ngushtësisht me forcimin e legjislacionit dhe rritjen e etiketit të tij mbi



garancinë e mbrojtjes së pronës. Shëndetësia, e konsideruar si pjesë e garancisë për të jetuar, është moment tjetër kushtetues, e cila ashtu siç shkruhet dhe pranohet në Kushtetutë, konsiderohet si një nga objektivat sociale më të rëndësishëm. E qartë, saktë dhe vijuese vjen neni 54 i saj, ku shteti merr përsipër të garantojë standardin më të lartë shëndetësor, fizik e mendor të mundshëm, një mjedis të shëndetshëm dhe ekologjikisht të përshtatshëm për brezat e sotëm dhe të ardhshëm si dhe riaftësimin shëndetësor, edukimin e specializuar dhe integrimin në shoqëri të të paafetëve, si dhe përmirësimin në vazhdimësi të kushteve të tyre të jetesës. Por çfarë ka ndodhur? Përpara këtij detyrimi, konstatohet lehtë se gjendja juridike e garancive të sipërcituara nga Kushtetuta, por ngatërruar nga akte të panumërta ligjore dhe nënligjore vjen në kundërshtim total me parashikimin kushtetues. Realiteti që ofrohet jo vetëm nuk ka lidhje me shërbimin shëndetësor, mjedisor dhe më tej, por lë për të dëshiruar skajshëm, deri në pamundësi kritike për të jetuar. Identifikimi i gjithë të drejtave të parashikuara nga Kushtetuta dhe ligji, si dhe ballafaqimi i tyre me realitetin ku bëjmë pjesë, të bën pesimist, veçanërisht kur konstaton dhe sheh se ligjëbërja nuk ka ardhur duke forcur misionin kushtetues, por realizon të kundërtën e garancive juridike të afirmuara deri tashmë brenda saj. Pra, në konkluzion, i gjithë procesi ligjëbërës, me pak përjashtime nuk është vendosur sipas parimit të formatimit të një ligji të fortë, siç kërkon sistemi modern, por shpeshherë brenda ligjit fshihen interesa mekinë politikash të përkohshme, pse jo edhe individuale, si këto kohët e fundit.

Siç edhe më sipër kam cituar se faktori dytë i konsolidimit të një sistemi drejtësisë është forcimi i gjykatave, të cilat larg një terminologjie të ngarkuar, janë thjesht disa ambiente të cilat mbikëqyren nga gjyqtarët, roli i të cilëve qëndron në garantimin e zbatimit të ligjit dhe të gjyqimit bazuar në aktet që ofrohen në formën më të thjeshtë ligjore. Trupat gjyqësorë, thjeshtazi dëgjojnë provat e paraqitura nga mbrojtësit ligjorë, ose

nga organet e ngritura po nëpërmjet ligjit dhe bazuar mbi të njëjtat norma argumentojnë fajësinë, pafajësinë ose japin të drejtën. Në rastin më të mirë, një sistem gjyqësor i ndershëm shqyrton të gjitha provat në mënyrë të qetë, racionale duke dhënë më pas një opinion të paanshëm. Mjafton që këtë mënyrë të thjeshtë të artikullimit të rolit dhe funksionit të gjykatave ta krahasosh me mënyrat e organizimit dhe funksionimit të pushtetit gjyqësor në vendin tonë, konstaton lehtë se vetë ligji i organizimit dhe funksionimit të tyre, për nga mënyra se si është ndërtuar, duke qenë shumë i gjatë, i komplikuar, i padobishëm, si dhe përkundër se si janë formuluar dispozitat, kanë krijuar e konceptuar pushtetin gjyqësor jo vetëm "larg" politikës, por edhe larg funksionit për të cilin është krijuar. Mënyra e organizimit dhe funksionimit të tij është sofistikuar kaq shumë sa që ligjëbërësi duket sikur në veprimtarinë e tij ka pasur dhe ka vetëm një shqetësim, vetëm një mision, atë të largimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve nga funksionet e tyre, pra të trupave ligjbatues nëpërmjet procesit të vetingut, pa marrë parasysh qoftë edhe një nga parimet më të thjeshta të fizikës, atë të anëve komunikuese. Duhet pranuar se ky mision është sa mediokër, aq edhe pa ndonjë të ardhme. Mjafton të shohësh me vëmendje Ligjin nr.84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë". Duke filluar nga preambula e tij dhe përmosur ligjin konstatohet lehtë se formati strukturor i ngritjes së institucioneve vetinguese, përmes Komisionit të Posaçëm të Apelit, nuk është brenda kuadratit të krijimit të pavarësisë së gjyqësorit, misioni për të cilin është ngritur. Përkundrazi, struktura, përbërja, organizimi dhe misioni është tërësisht politik si në thelb edhe në shfaqje. Për këtë mjafton të shohësh mënyrën se si dhe nga merret burimi informacionit tredimensional mbi pasurinë, integritetin, profesionalizimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve. Përvoja e deritanishme ka treguar se me integritetin moral dhe atë profesional, Komisioni Pavarur i Kualifikimit nuk është marrë fare, sepse po për të

njëjtat arsye politike, komisioni ka vepruar njëanshmërisht dhe njëtimthi me shkarkimet e gjyqtarëve dhe prokurorëve, duke konsideruar veten dhe vendimarrjet e tij, si zbatim dhe kërkesë të mesazheve politike të imponuara nga vendimarrjet e institucioneve europiane. Edhe sa i përket shqyrtimit të pasurisë së gjyqtarëve prej Komisionit, konstatohet lehtësisht që vlerësimi është politik dhe i njëanshëm, sa kohë që të dhënat merren nga i njëjti institucion, pra ILDKPI-ja, që për vite me radhë, duke filluar nga viti 2003 ka pranuar dhe hetuar mbi pasurinë e gjyqtarëve dhe prokurorëve, duke i konfirmuar ato si të përpëthura me ligjin. Ndryshe nga sot, kur ndodh e kundërta prej tyre, duke vlerësuar të njëjtat të dhëna prej gjyqtarëve dhe prokurorëve në kundërshtim me ligjin. E vetmja ide që të shkon ndërmend, është konstatimi se veprimtaria e këtij organi në gjithë këto vite ka qenë dhe është në kundërshtim të hapur me ligjin, pse jo dhe veprimtaria e qëllimshme joligjore, duke na sjellë në vëmendjen tonë figurën penale të "Shpërdorimit të detyrës", parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Sa kohë prej institucioneve ligjore përdoren standarde të ndryshme joligjore, është më e drejtë që reforma ligjore t'i mundësonte Komisionit të Pavarur të Kualifikimit të përdorte logjistikën e ILDKPI-s dhe përmes detyrimit e paktërësia prej saj. Në të njëjtën mënyrë, ligjëbërësi do të duhej të veponte edhe me ekzistencën e institucionit të DSIK (Drejtoria e Informacionit të Klasifikuar), ndonëse deri tani prej Komisionit të Vetingut, kjo pjesë nuk është konsideruar. Kujtojmë që të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët e vendit tonë kanë qenë dhe janë të pajisur me "Certifikatën e sigurisë". Madje, janë duke punuar ende në këtë ombrellë ligjore. Në këtë kuptim, del fare e qartë se misioni vetingues, nisur nga instrumentet, mjetet që përdor dhe mënyra se si arsyetun mbi ato, është qartazi politike, fakt i cili jo vetëm që do të cedojë rezultatin, por do të shtojë dyshimet mbi rezultatin. Për nga kuptimi ligjor dhe mënyra se si funksionon, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (Komisioni i

Vetingut) është i përafërt me ngrehinën e një trupi gjyqësor, vendimarrës, objekti i veprimtarisë së të cilit është përcaktimi i rregullave të posaçme për rivlerësimin kalimtar të të gjitha subjekteve të rivlerësimit për të garantuar funksionimin e shtetit të së drejtës, pavarësisë së sistemit të drejtësisë, si dhe rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi. Në këto kushte është fare normale të ngresh dilemën se ky organizëm apo trup vlerësimi, a përbën garant të zbatimit të ligjit dhe të gjyqimit, kur veprimtaria e tij bazohet në aktet që ofrohen në formën më të thjeshtë ligjore nga organet, të cilat deri tani kanë gënjyer edhe veten?

Referuar përgjigjes së kësaj pyetjeje, është pashmangshëm koncepti se forcimi i sistemit të drejtësisë nuk mund dhe nuk ka se si të shihet pa rregullimin e pasojave të prodhuara nga organet joeficiente.

Rregullimi pasojave të sipërcituara të sistemit jo vetëm nuk janë rregulluar, por për më tepër janë thelluar në negativitet. Dhe për këtë arsye, e para gjë që të shkon në mendje, kur flitet për pasojat, është rrëzimi që i është bërë sot Gjykatës Kushtetuese, pse jo edhe Gjykatës së Lartë. Pra, sot ne jemi në situatë shoku ligjor dhe kushtetues, pa Gjykatë Kushtetuese dhe Gjykatë të Lartë. Çdo deklarami poshtë e lartë, që korruptiviteti është faktori që rrëzoi Gjykatën Kushtetuese, është i gabuar dhe jo i dobishëm për shkaqet dhe pasojat gjithashtu. Siç duket sërish politika, nuk ka rëndësi se cila pjesë, majtas apo djathtas, brendshme apo e huazuar, shërben si pengesë e zbatimit të shpejtë të ligjit, sepse është fare e thjeshtë se asgjë nuk e pengon Kuvendin e Shqipërisë, Presidentin e Republikës të zgjedhë anëtarët e tjerë të saj. Sot më shumë se kurrë, tamam o sot o kurrë funksionimi i Gjykatës Kushtetuese është domosdoshmëri, arsye për të cilën rrezikohet çdo marrëveshje dypalëshe apo shumëpalëshe, ku vendi ynë është ose kërkon të jetë pjesë. Frenimi i veprimtarisë së kësaj ngrehine lë për të dëshiruar, pse jo, fshih të tjera qëllime, të cilat unë nuk jam i zoti t'i citoj. Në të njëjtën pengim është edhe funksionimi i gjykatave të tjera. Parimi i veprimtarisë gjykatave, gjyqtarëve dhe prokurorëve është i thjeshtë, vetëm duhet qetësi në vendimarrje, e cila kohët e fundit nuk ekziston më. Sot vendimet e gjyqtarëve dhe prokurorëve janë ose në lajthitje totale të ligjit, ose në kundërshtim flagrant me parimet themelore të drejtësisë. Pasojat e kësaj kohe, pse jo dhe pasojat e vendimarrjeve të korruptuara të mëparshme nuk rregullohen dhe nuk ka mundësi të rikuperohen dhe kjo duhet pranuar, sepse në fund të fundit këtë fakt legjislativ i ri nuk e ka garantuar, pra reforma në drejtësi nuk ka marrë përsipër të korrektoje vendimet e gabuara si ato penale dhe civile gjithashtu. Në këtë kuptim, shumë shpejt njerëzit do kuptojnë se ndryshimi i sistemit në mungesë të përmirësimit legjislativ procedural dhe material, ngelet brenda përmbytjes së fjalës popullore "Ku ishim, asgjëkund; çfarë bëmë, asnjë gjë".



Opinioni *i* Ditës

# 700 fjalë që tronditën muret

Dr. Jorgji Kote

(vijon nga faqja 1)

... ëndrën e madhe të ribashkimit. Por tej Atlantikut ndriçon-te një dritë e madhe shprehe. Të gjithë i kishin drejtuar sytë nga SHBA-të dhe Presidenti i madh Kenedi. Dhe ai futuroi drejt Berlinit më 26 qershor 1963 me premtimin monumental për mbrojtjen e vlerave të demokracisë, të solidaritetit dhe të ribashkimit. I shprehu këto mesazhe me shumë emocione, por dhe bindshëm, me oratorinë e tij të pasqyrore, pikërisht aty, pranë Murit. Berlinit oshtiu ato ditë nga brohoritjet entuziaste "Kenedi" "Kenedi"! I pari kryepolitikan i botës që "e kapërceu" këtë mur, si preludi i shembjes së tij pas 28 vitesh.

Me fjalimin e tij historik, mes ekzaltimit të gjysmë milionë të pranishmëve që nisi dhe u mbyll me deklarin lapidar në gjermanisht "Ich bin ein Berliner". "Jam berlinez", Kenedi i thuri një himn madhështor Berlinit të ardhshëm të Europës së Bashkuar, të etur për liri dhe paqe.

Vërtet që ky fjalim i konsideruar si më emblematiku i Luftës së Ftohtë kishte vetëm 700 fjalë, por me karizmën e tij të rrallë, presidenti i 35 i SHBA-ve i dha zjarr aspiratës gjermane të ribashkimit. Ai tronditi nga themelet jo vetëm Murin e Berlinit, por edhe muret e tjerë ndarës.

Ashtu si mund të shihet në fjalimin e plotë të shpëruar më poshtë, Kenedi foli edhe për gjermanolindorët kur theksoi se, "nuk mund të ketë paqe të vërtetë dhe të qëndrueshme në Europë, për sa kohë që një ndër 4 gjermanëve u mohohet e drejta elementare e njeriut të lirë, zgjedhja e tij e lirë".

Fjala e Kenedit ishte dhe një pretendencë e fuqishme origjinale ndaj sistemit komunist. Atyre që kishin iluzione për komunizmin, ai iu drejtua ironikisht, *qartë dhe thjeshtë*: "Le të vijmë ta shohim në Berlin!".

Vërtet që disa muaj më vonë vranë Kenedin, por jo vizionin, ëndrën dhe premtimin e tij si "berlinez". Atë e mbajtën dhe përcollën më tej pasardhësit e tij, sidomos Presidenti Regan kur më 12 qershor 1987, nga portat e mbyllura të Brandenburgut i lëshoi thirrjen kushtërisht Gorbaçovit për ta shembur atë mur dhe për t'i hapur ato porta. Në vijmë, me hapat dhe vendimet e tyre epokale ishin "të mëdhenjtë" e botës - Bush, Thatcher, Kohl, Mitteran dhe Gorbaçov, që më 9 nëntor 1989 udhëhoqën shembjen e murit famëqë me të gjitha rrjedhojat e tij të njohura historike.

Por, edhe Berlini e mbajti premtimin që i bëri atë ditë Kenedit me prritjen e tij madhështore. Gjithçka më pas është histori suksesi. Pasi shembi murin dhe iu bashkëngjiti pjesës tjetër dhe gjithë Evropës, bashkë me Washingtonin, Parisin, Londrën, Romën etj., Berlini ndihmoi dhe mbështeti në



mënyrë të gjithanshme vendet dhe popujt e tjerë që lëngonin nën sundime arbitrare. Efektet sizmike të shembjes së Murit të Berlinit u ndjenë dhe u pasqyruan edhe në Shqipëri, ku bashkë me qindra mijërat e bunkerëve fizikë dhe politikë u shemb edhe sistemi monist.

Ndërsa 19 vjet më parë, *Berlini mbështeti dhe mori pjesë aktive në ndërhyrjen ushtarake ndërkombëtare në Kosovë; më tej, bashkë me SHBA-të, shumicën dërrmuese të vendeve të BE-së e të NATO-s dhe të shumë vendeve të tjera*, Berlinit ishte në rreshtin e parë të njohësve dhe mbështetësve të pavarësive së shtetit më të ri të Kosovës. Po ashtu, ai ka mbështetur ndër të parët integrimin evropian të vendeve të rajonit dhe posaçërisht të Shqipërisë deri në Procesin e Berlinit të lançuar gati pesë vite më parë nga Kancelaria evropianiste, Angela Merkel.

Plot 55 vjet pas fjalimit madhështor të Kenedit, Berlinit po ndez, edhe pse jo pa vështirësi, dritën jeshile për negociatat tona të anëtarësimit në BE. Në këtë përvjetor shohim me keqardhje dhe shqetësim se sërish kudo, madje edhe në Gjermani po tentohet të ngrihen mure të tjerë ndarës dhe izolues - fizikë, ideologjikë, fetarë, azili, rajonalë, gjinorë, etj. Ndaj, "Jam berlinez" tingëllon shumë aktual si një apel madhor politik dhe qytetar për t'u ngritur në këmbë, për t'i zëvendësuar muret ndarës me ura lidhëse dhe për të mbrojtur e forcuar me çdo kusht Evropën e bashkuar. Ja pse ia vlen shumë t'i referohemi sërish fjalës monumentale të "berlinezit" legjendar Kenedi.

## "Jam berlinez"

Fjala e J.F. Kenedy në Sheshin "Rudolf Wilde Platz" (pas vdekjes mori emrin e tij) në Berlinin Perëndimor, më 26 qershor 1963

"Jam krenar që vij në këtë

qytet, i ftuar i kryebashkiakut tuaj të shquar, i cili simbolizon në të gjithë botën shpirtin luftarak të Berlinit Perëndimor. Jam gjithashtu krenar që vizitohet RFGJ-në bashkë me Kancelarin tuaj të nderuar, i cili për shumë vite në krye të Gjermanisë, i është përkushtuar lirisë dhe përparimit. Jam i lumtur që vij këtu i shoqëruar nga bashkëqytetari im amerikan, Gjeneral Clay, i cili ka qenë në këtë qytet në momentet e mëdha të krizës dhe do të vijë sërish kur të jetë e nevojshme.

2000 vjet më parë, krenaria më e madhe ishte të thoshe 'Jam romak!', ndërsa sot, në botën e lirisë, krenaria më e madhe është të thuash "Jam berlinez".

Në botë ka shumë njerëz, të cilët në të vërtetë nuk e kuptojnë, ose thonë se nuk e kuptojnë dallimin më të madh ndërmjet botës së lirë dhe asaj komuniste. *Le të vijmë ta shohim në Berlin!* Ka disa që thonë se komunizmi është vala e së ardhmes. Le të vijmë ta shohim në Berlin! Por, ka edhe të tjerë që thonë se *në Europë dhe gjetkë ne mund të punojmë me komunistët. Le të vijmë ta shohim në Berlin!* Ka madje syresh që thonë se vërtet *komunizmi është një sistem i keq, por ai lejon që të kemi përparim ekonomik. Le të vijmë ta shohim në Berlin!*

Liria ka shumë vështirësi dhe demokracia nuk është e përkryer. Por, në kurrë s'kemi menduar të ngremë mure për t'i mbajtur njerëzit brenda tyre apo për t'i penguar që të largohen prej nesh. Në emër të bashkardhëtarëve të mi që jetojnë mijëra kilometra në anën tjetër të Atlantikut, me lejon t'u them se për ta është krenaria më e madhe që kanë mundur të ndajnë bashkë me ju, edhe pse nga larg, historinë e 18 viteve të fundit. *Unë, nuk njoh qytet tjetër; të vogël apo të madh, që edhe pse i rrethuar për 18 vjet rresht, jeton ende me vitalitet dhe me forcë, me shpresë dhe vendosmëri, si Berlinit Perëndimor. Ndonëse muri është shfaqja më e qartë dhe e gjallë e dështimeve të*

regjimit komunist që e sheh gjithë bota, në kjo nuk na gëzon, sepse, siç e tha edhe kryebashkiaku juaj, ai përbën një sulm jo vetëm ndaj historisë, por edhe ndaj njerëzimit; pasi ndan familjet, burrat dhe gratë, motrat dhe vëllezërit nga njëri-tjetri.

E vërteta e këtij qyteti i takon të gjithë Gjermanisë, sepse pagja e vërtetë dhe e përhershme në Europë nuk mund të jetë e sigurt, për aq kohë sa *dhe qoftë një qytetari të vetëm i mohohet e drejta më elementare, ajo e njeriut të lirë dhe që të zgjedhë lirisht me vullnetin e vet*. Në këto 18 vite paqje dhe mirëbesimi, ky brez gjermanësh ka fituar të drejtën për të qenë i lirë, duke përfshirë edhe të drejtën e bashkimit familjar dhe kombëtar, për të jetuar në paqe të përhershme, me vullnetin e mirë për të gjithë. Ju jetoni në një ishull të mbrojtur të lirisë, por jeta juaj është pjesë e të gjithë vendit. Prandaj, në mbyllje të fjalës sime, më lejoni t'u ftoj që të hidhni sytë dhe vështrimin përtej rreziqeve të sotme, të shpresat e së nesërme, tej lirisë vetëm të qytetit të Berlinit Perëndimor ose vetëm të vendit tuaj, Gjermanisë, drejt përparimit e lirisë kudo, tej murit, në ditët e paqes dhe drejtësisë, tej vetes suaj dhe vetes sonë, drejt mbarë njerëzimit. *Liria është e pandashme edhe kur qoftë edhe një njeri është i skllavëruar; të gjithë ne të tjerët nuk jemi të lirë. Kur të gjithë të jenë të lirë, atëherë ne do të mund të hedhim vështrimin tonë përpara, drejt asaj dite kur ky qytet, ky vend dhe kontinent i madh i Europës do të bashkohen në një glob plot paqjeje dhe shpresë.*

Kur të vijë më në fund ajo ditë, atëherë populli i Berlinit Perëndimor mund të gëzohet me të drejtë me faktin se për edhe një dekadë, ai ishte në vijën e parë të frontit. *Të gjithë njerëzit e lirë, kudo që jetojnë, janë qytetarë të Berlinit; ndaj si njeri i lirë, edhe unë sot them me krenari "Jam berlinez!"*

## HOROSKOPI

### DASHI

Me Uranin që grindet me Hënën, do të ishte mirë të mos dilni në konkluzione të menjëhershme për ato që do t'ju thonë. Dëgjojin argumentet e të tjerëve, edhe pse brenda jush keni një ndjenjë të fortë rebelimi, që ju shtyn t'ju kundërviheni.

### DEMI

Me Plutonin që ndikon, sjellja jo e duhur mund të konsolidohet në vend që të jetë diçka e rastit. Pyesni veten, nëse e dini, si do të reagoje partneri. Mos u përzieni me gjëra që nuk ju takojnë dhe në lidhje me këtë bëni një sqarim.

### BINJAKET

Me favorizimin e Jupiterit, nëse jeni në kërkim të një pune, dijeni se fati mund t'ju trokasë në derë. Mos rrii duarkryq. Sot mund të hapni një kapitull të ri në lidhje tuaja dashurore me personin e zemrës.

### GAFORJA

Do të gaboni me kokëfortësi për mbrojtur qetësinë tuaj, por partneri, duke e kuptuar, do t'ju falë. Me pak fjalë do të jeni edhe më të bashkuar se më parë. Mos jini koprac kur vjen puna për të treguar dashurinë tuaj. Njerëzit që ju rrinë në krah e meritojnë plotësisht.

### LUANI

Hëna pozicionohet me Venusin dhe Marsin. Do të keni fërkime me një familjar që këmbëngul që gjithçka shkon mirë, ndërsa në realitet ka tensione të fshehura. Kush jeton në çift duhet të bëjë kujdes që të mos ndërlikojë atë që është e thjeshtë dhe e drejtpërdrejtë.

### VIRGJERESHA

Me Venusin, Marsin dhe Uranin kundër paralajmërojnë një ngritje të menjëhershme tensionesh, si edhe ndonjë vendim që mund të merret në mënyrë të pakontrolluar. Nguliteni mirë në mendje se gjaknxehtësia dhe paragjykimet mund të ndikojnë që të bëni shumë sesa një gabim.

### PESHORJA

Me ndikimin e Hënës, priten ulje dhe ngritje të humorit në lidhje me sqarime familjare, por jo përballje zënkash. Çitrohuni nga të tjerët. Veproni sipas mendjes së juaj një çdo mjesdri, po u dashur fare t'i përshatani ritmeve të të tjerëve.

### AKREPI

Do të jeni nisëmatar, në këtë ditë bukur, i iniciativave të bukura në grup. Do të arëgotheni jashtë mase, duke harruar çdo shqetësim. Aftësisia juaj për të dëgjuar kërkesat e partnerit dhe t'i plotësoni dëshirat do të forcojë lidhjen.

### SHIGJETARI

Hëna nuk ka shumë gjëra për t'ju thënë. Nga ana tjetër Merkurit dhe Venusit ju mbikëqyrin dhe i bëjnë gjatë më të thjeshta. Me mbështetjen e vyer të planetit të dashurisë, do të tejkaloni kequmtimet të rastit me partnerin.

### BRICJAPI

Të jeni më të dashur nuk ju bën veçse mirë. Padyshim, do të lehtësonte ndjeshëm raportet me personin që keni në krah. Mos e harroni! Ndërhyrja e një familjari në punët tuaja do t'ju nevojzojë disa, por nuk keni çfarë bëni.

### UJORI

Me Jupiterin që ju mbështet, nëse keni ndonjë ditë të bukur që ju shkon ndërmend, vëreni në veprim. Do t'ia dilni të gjeni edhe aleatë. Nëse do të ketë fërkime brenda familjes, largojuni duke e kaluar me sportivitet.

### PESHQIT

Një person ju tërhoq se tepërmi e për rrethojë do të bëni në kurthin e dashurisë, duke u ushqyer me iluzione dhe ëndërra. Por ndërkajë e keni vetë në dorë nëse kjo dashuri do të materializohet. E rëndësime është të tregoheni në çdo çast vetja juaj.

GRUPI E



Brazili eliminon Serbinë.  
Kalon edhe Zvicra

Brazili dhe Zvicra luanin një ndeshje pa kompromis mes tyre, për shkak se të dyja donin kualifikimin që kalonte nga 90-minutëshi i Moskës. Brazilianët, me një pikë më shumë se serbët, kishin dy rezultate në favor, ndërsa të besuarit e Krstajiç ishin të detyruar të fitonin, nëse donin

të kalonin më tej. Por ndryshe nga sa pritej, ata që e nisnin ndeshjen në sulm dhe me vrull janë pentakampionët, të cilët i afrohen golit në shumë momente, sidomos me Neymar, që në minutën e 25-të e ndal në mënyrë të shkëlqyer Stojković. Serbia do të kërcënojë për herë të parë kuadratin e

Alision në të 34'-ën, ndërsa Brazili kundërpërgjigjet shpejt dhe me gol. Kutimjo vertikalizon në mënyrë të shkëlqyer për Paulinjon, që devijon një kohë përpara se Stojković të arrijë te topi, duke shënuar golin e parë të ndeshjes, që e lejon Brazilin të shkojë në dhomat e zhveshjes në epërsi.

Edhe në pjesën e dytë janë lojtarët e "Seleçaos" ata që sulmojnë dhe krijojnë volum loje dhe raste të mira shënimi, ndërsa në minutën e 57-të Neymar sheh Stojkovićin t'i ndalë një gol të sigurt. Serbia, që nuk ka se ç'të humbasë më, nis të mësyjë dhe në minutën e 61-të do të shpërdorojë barazimin me Mitroviçit, që nuk është gati në momentin e mbërritjes së topit. Pas tentativave të Serbisë, Brazili merr edhe njëherë kontrollin e lojës, ndërsa do të

dyfishojë rezultatin në minutën e 68-të, kur Tiago Silva me kokë mposht Stojkovićin pas këndores së harkuar nga Neymar. 2-0 dhe ndeshja praktikisht ka përfunduar këtu, ndonëse të dyja ekipet kërkojnë të shënojnë gola të tjerë. Brazili e mbyll i pari grupin E me 7 pikë, i ndjekur nga Zvicra me 5 pikë. Në turin pasardhës, "Seleçao" do të ndeshet me Meksikën, ndërsa helvetët me Suedinë.

Koreja e Jugut është fatale për "Pancerat". 0-2 dhe pretendetët shkojnë në shtëpi



Jeton Selimi

Tronditje kampionësh!  
Mallkimi godet Gjermaninë

S'kalojnë turin e parë për herë të parë nga viti 1938



Mallkimi i kampionit të botës godet sërish! Pas Francës në vitin 2002, Italisë në vitin 2010 dhe Spanjës në vitin 2014, Gjermania në këtë Botëror nuk kalon grupin, duke u larguar me turp, në një grup që e nisi keq me humbjen ndaj Meksikës, por që arriti të rikthehej pas fitores kundër Suedisë. Ndaj Koresë së Jugut dukej gjithçka kaq në rregull për "Pancerat", një nga ato fitore që cilësohen shpesh si të sigurta, një trepikësh i lehtë për të besuarit e Lëvit. Ndaj edhe ndeshja nis me një siguri absolute, një siguri e tepruar që më pas u kthye në ngërç për kampionët e botës. Pjesa e parë e ndeshjes do të jetë një monolog i gjatë i "Pancerave" me zonën e Hjun Uo Ço, ndërsa Koreja e Jugut do të kërkojë të përkohë më kundërsulmin, madje edhe mund të kishte bërë dëm në dy momente me Son, që provon me çdo kusht të shënojë. Verner dhe Humels nga ana tjetër kishin të gjitha mundësitë për ta çuar Gjermaninë në avantazh në pushim të ndeshjes, por kjo nuk do të ndodhë. Pjesa e dytë do të jetë një rrethim i vërtetë. Gjermania shpërdor-

on shumë, madje edhe raste të shkëlqyera shënimi si ai i Goreckës në minutën e 48-të apo si gjuajtja e Vernerit, që fluturon jashtë kuadratin. Në minutën e 65-të Koreja pretendon penallti, por kryesori Geiger ndëshkon Son për simulim. Më pas nis bataveja gjermane. Të gjithë provojnë me radhë të shënojnë, ndërsa Koreja si gjithnjë në

këtë sfidë, ngacmon me kundërsulm. Minutat e fundit të ndeshjes janë plot emocion. Lëv ka hedhur të gjithë sulmuesit në kërkim të golit të kualifikimit, ndërsa Humels në të 88'-ën gabon në mënyrë të pabesueshme nga fare pranë portës. Totalisht në sulm dhe të shpërdoruar në mbrojtje, Gjermania pëson tronditjen e mad-

he. Koreja shënon me Kim, gol që fillimisht anulohet, por pas këshillimit me VAR-in, amerikani Geiger e akordon, duke sjellë një gëzim të pabesueshëm te koreanët dhe një gjëmë të madhe te gjermanët. Koha shtesë në "Kazan Arena" është e denjë për një tragjedi edipiane, kur Nojer ka braktisur portën në ndihmë të sulmit

dhe Son ka të gjithë shpërdoruar në dispozicion të tij për të shënuar golin e dytë. Nuk ka më kohë për Gjermaninë, Geiger vërshtëllën tri herë, i jep fund të paimagjinueshmes. Gjermania kampione bote jashtë, Gjermania që mundon të kalojë fazën e parë të një Botërori për herë të parë që prej vitit 1938!

FESTË NË  
JEKATERINBURG

Suedia shkatërron  
Meksikën, por  
kualifikohen të dyja

Suedia shpartallon Meksikën dhe merr vendin e parë në grupin F, duke bafasuar me lojë e rezultat, sidomos nëse kemi parasysh që pak ditë më parë u tronditën nga përmbysja in extremis, që pësuan nga dora e Gjermanisë. Vikingët do të shpërthojnë në pjesën e dytë. Fillimisht me Augustinsson, që shfrytëzon mjaft mirë krosin e Klaessonit dhe çel rezultatin e ndeshjes. Meksika shokohet dhe nuk arrin të orientohet në sulm, ndërsa Suedia godet sërish 12 minuta më pas, kur Andrea Grankuist ekzekuton saktë penalltinë e fituar nga Berg. Suedezyt i vënë kapak ndeshjes në minutën e 74-të me autogolin e Alvarez. Do të mbyllet 3-0 në "Jekaterinburg Arena" për Suedinë, të cilët sigurojnë vendin e parë në grupin F, ndërsa Meksika, pavarësisht humbjes së thellë, mbetet e dyta dhe kalon më tej për në fazën e 1/8-ave.

BOTERORI RUSI 2018

Grupi F

Gjermania - Kore e Jugut	0	-	2
Suedi - Meksikë	3	-	0

Renditja

Skuadra	N	P
Suedia	3	6
Meksika	3	6
Koreja e Jugut	3	3
Gjermania	3	3

PRAGNDESHJE

Japonia, për fitore dhe kualifikim ndaj Polonisë

Japonia luan përballë Polonisë së eliminuar, ndërsa trajneri Akira Nishino beson se do t'u dhurojë tifozëve kualifikimin e ëndërruar. "Polonia ia doli në eliminoret e vështira europiane dhe është një ekip i fortë. Gjithsesi, ata nuk janë të pamposhtshëm dhe nëse ne luajmë ashtu siç dimë, do të arrijmë të sigurojmë kualifikimin". Ndërkohë, trajneri i Polonisë, Adam Nawalka është i trishtuar për mënyrën sesi ka shkuar ky Botëror për ta. "E kishim menduar ndryshe, nuk e besonim se do ishim të eliminuar pas dy ndeshjeve të para, gjithsesi do të kërkojmë të fitojmë ndeshjen e fundit për veten tonë dhe për tifozët".

GRUPI H

Senegal-Kolumbia, ndeshje për brenda ose jashtë

Ndeshja më e fortë e grupit H është padyshim ajo mes Senegalit dhe Kolumbisë. Afrikanët janë të parët në grup së bashku me Japoninë në kuotën e 4 pikëve, ndërsa Kolumbia është e treta me tri pikë. Ndërsa Aliu Sise ka besim te Senegali i tij. "Senegali është një ekip i vështirë për t'u mposhtur. Ne e njohim mirë Kolumbinë dhe natyrisht ia njohim forcën. Ne jemi të parët në grupin tonë, ndaj u leverdis atyre të na mposhtin. Nga kjo ne duhet të përfitojmë". Edhe Pekerman e di këtë gjë. Kolumbia ka nevojë për fitoren për të qenë 100% e sigurt në kalimin e turit. "Do të bëjmë çdo gjë që të qëndrojmë në Botëror dhe jemi optimistë. Është një ndeshje e rëndësishme për ne dhe fitorja do të sigurojë kualifikimin tonë. Skuadra është në gjendje të mirë dhe kjo më pëlqen".

GRUPI G

Anglia dhe Belgjika, një përballje luksi

Në grupin G verdiktet janë ndarë sa u takon biletave për në fazën e 1/8-ave, por ende mbetet për t'u përcaktuar koka e grupit, me Belgjikën dhe Anglinë që do të luftojnë për këtë, ndërsa Geri Suthgejt hedh dorashkën e sfidës. "Jemi të fokusuar për ndeshjen tonë, ndonëse jemi të qetë, sepse e kemi kaluar grupin. Po ndërtojmë një ekip që çdo njeri në Angli po e sheh sesa me pasion luan dhe se kemi dëshirë të fitojmë në çdo ndeshje". Roberto Martinez e merr më lehtë sfidën e ndaj "tre luanëve", ndërsa mendon që tani për përballjet në fazën e eliminimit. "Prioriteti ynë nuk është të fitojmë ndaj Anglisë. Jemi kualifikuar për në 1/8-at dhe kjo është e rëndësishme. Nuk do të rrezikojmë lojtarët me kartonë dhe as lojtarët e dëmtuar. Synojmë të jemi në formë ndeshjen tjetër".





[www.gsh.al](http://www.gsh.al)

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)

# GAZETA SHQIPTARE

# GSH.AL



- Na merrni!
- Na shkruani!
- Na lexoni!

# GSH

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)



## Tashmë edhe lundroni!

